



EUROPEAN COURT OF HUMAN RIGHTS
COUR EUROPÉENNE DES DROITS DE L'HOMME

Udhëzues për Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Mbrojtja e pronës

Azhurnuar më 31 dhjetor 2019

Publikuesit ose organizatat që dëshirojnë ta përkthejnë dhe/ose riprodhojnë këtë Udhëzues, apo ndonjë pjesë të tij, qoftë në formë të shtypur apo si publikim elektronik, ftohen që ta kontaktojnë adresën publishing@echr.coe.int për informata mbi procedurën e autorizimit për këtë qëllim.

Nëse doni të dini cilat përkthime të Udhëzuesve të Praktikës Gjyqësore janë duke u përgatitur aktualisht, ju lutemi t'i qaseni faqes [Përkthimet në përgatitje e sipër](#).

Ky Udhëzues është përgatitur nën autoritetin e Jurisconsult dhe nuk përbën dokument obligativ për Gjykatën. I njëjti mund t'i nënshtrohet rishikimeve redaktoriale.

Ky Udhëzues është hartuar në gjuhën angleze. I njëjti azhurnohet rregullisht, ndërsa azhurnimi i fundit është kryer më 31 dhjetor 2019.

Udhëzuesi mbi praktikën gjyqësore në gjuhën angleze mund të shkarkohet në faqen www.echr.coe.int (duke ndjekur kategoritë: *Case-law – Case-law analysis – Caselaw guides*). Për informatat më të reja lidhur me publikimet, ju lutemi ta ndiqni llogarinë e Gjykatës në Twitter - <https://twitter.com/echrpublication>.

© Këshilli i Evropës/Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut 2019

Përmbajtja

Shënim për lexuesit	5
I. Hyrje	6
II. Çështje të përgjithshme	7
A. Zbatimi i Nenit 1 të Protokollit 1 – “pronat”	7
1. Koncepti i “pronave”	7
a. Kuptimi autonom	7
b. “Pronat” e mbrojtura.....	8
i. Pritjet legjitime	9
c. Llojet e ndryshme të “pronave” dhe interesave pronësorë tjerë.....	10
i. Kërkesat dhe borxhet e gjykimit	10
ii. Aksionet në kompani dhe instrumentet tjera financiare.....	11
iii. Klientela profesionale	12
iv. Licencat afariste	12
v. Të hyrat e ardhshme.....	12
vi. Prona intelektuale.....	13
vii. Qiraja në prona dhe të drejtat banesore	13
viii. Përfitimet e sigurimit social/pensionet.....	13
ix. Shkatërrimi i pronës në situatë të konfliktit të armatosur ndërkombëtar apo të brendshëm – niveli i kërkuar i të provuarit.....	15
x. Embrionet njerëzore	16
B. Ndërhyrja me të drejtën për gezim paqësor të pronës	16
1. Qasja “tri rregullat”	16
a. Privimi i pronës	19
b. Kontrolli i shfrytëzimit	20
c. Rregulli i përgjithshëm	21
2. Parimi i ligjshmërisë	21
3. Interesi publik ose i përgjithshëm.....	23
4. Proporcionaliteti dhe çështjet e ndërlidhura (balanci i drejtë, kompensimi, margjina e vlerësimit)	25
a. Faktorët proceduralë	25
b. Përzgjedhja e masave	26
c. Çështje substanciale relevante për testin e balancit të drejtë	27
d. Aspekte të ndërlidhura me parashtruesin e kërkesës.....	28
e. Kompensimi për ndërhyrje si element i balancit të drejtë.....	28
C. Obligimet pozitive të shteteve anëtare.....	31
1. Efektet horizontale – ndërhyrjet nga personat privatë	33
2. Masat korrigjuese.....	34
3. Procedurat përmbartimore	34
D. Marrëdhënia mes Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 dhe neneve tjera të Konventës	37
1. Neni 2	37
2. Neni 3	37
3. Neni 4	38
4. Neni 6	38
5. Neni 7	40
6. Neni 8	40
7. Neni 10	42
8. Neni 11	43

9. Neni 13	43
10. Neni 14	43
III. Çështjet specifike	45
A. Qirambajtësit dhe kontrolli i qirasë	45
B. Rastet e mirëqenies sociale	48
C. Rastet bankare	52
D. Tatimimi	54
E. Planifikimi hapësinor	56
F. Konfiskimi i pasurisë së fituar nga veprat penale.....	57
G. Restitucioni i pronës	59
H. Ndërmarrjet shtetërore	62
I. Masat kursyese.....	64
J. E drejta e Bashkimit Evropian	65
Lista e rasteve të cituara	66

Shënim për lexuesit

Ky Udhëzues është pjesë e një serie të Udhëzuesve të Praktikës Gjyqësore të publikuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm “Gjykata”, “Gjykata Evropiane” ose “Gjykata e Strasburgut”) për t’i informuarit praktikuesit në fushën e drejtësisë mbi aktgjykimet dhe vendimet kryesore të nxjerra nga Gjykata e Strasburgut. Ky Udhëzues analizon dhe përmbledhë praktikën gjyqësore që ndërlidhet me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm “Konventa” ose “Konventa Evropiane”). Në këtë punim, lexuesit do të gjejnë parimet kryesore të fushës që rregullon neni në fjalë dhe precedentët relevantë kryesorë që ndërlidhen me të.

Praktika gjyqësore e cituar është përzgjedhur në mesin e aktgjytimeve dhe vendimeve kryesore, më të shquara dhe/ose më të fundit.* *

Aktgjykimet dhe vendimet e Gjykatës u shërbejnë jo vetëm lëndëve që vendosen para Gjykatës por edhe publikut në përgjithësi, duke zbërthyer, mbrojtur dhe zhvilluar më tej rregullat e vëna nga Konventa, e duke i kontribuar kështu edhe respektimit të obligimeve të marra nga Shtetet si Palë Kontraktuese (Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 154, dhe, më rishtas, Jeronovičs kundër Letonisë [GC], § 109).

Rrjedhimisht, është mision i sistemit të krijuar nga Konventa që të përkufizojë, në interes të përgjithshëm, çështje që ndërlidhen me politikat publike, duke ngritur kështu standardet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe duke zgjeruar dhe avancuar jurisprudencën që lidhet me drejtat e njeriut në të gjitha Shtetet që i nënshtrohen Konventës (Konstantin Markin kundër Rusisë [GC], 30078/06, § 89, ECHR 2012). Në fakt, Gjykata ka theksuar rolin e Konventës si “instrument kushtetues për rendin publik evropian” nga fusha e të drejtave të njeriut (*Bosphorus Hava Yolları Turizm ve Ticaret Anonim Şirketi kundër Irlandës* [GC], § 156).

Ky Udhëzues përmban referenca për fjalët kyçe nga të gjitha nenet e cituara të Konventës dhe Protokollit Shtesë të saj. Çështjet juridike të cilat i trajtojnë lëndët janë të përmbledhura në [Listën e fjalëve kyçe](#), të përzgjedhur nga fjalorthi i temave të trajtuara (në shumicën e rasteve) drejtpërdrejt nga teksti i Konventës dhe Protokolleve të saj.

[Databaza HUDOC](#) e praktikës gjyqësore të Gjykatës mundëson kërkimin sipas fjalëve kyçe. Kërkimi me fjalë kyçe mundëson gjetjen e më shumë dokumenteve me përmbajtje të ngjashme juridike (arsyetimi dhe konkluzionet e Gjykatës për secilin rast përmbledhen me fjalë kyçe). Fjalët kyçe për lëndët individuale mund të gjenden duke e hapur etiketën *Detajet e lëndës* në HUDOC. Për më shumë informata mbi databazën HUDOC dhe fjalët kyçe, konsultohuni me [Doracakun e përdoruesve të HUDOC](#).

** Praktika gjyqësore e cituar mund të jetë në njërin apo dy gjuhët zyrtare të Gjykatës dhe Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut (anglisht ose frëngjisht). Përveç nëse bëhet e ditur ndryshe, të gjitha referencat ndërlidhen me aktgjykimet mbi meritat të cilat i ka shqiptuar Dhoma e Madhe apo nga Gjykata. Shkurtesa “(vendim)” tregon se citati ndërlidhet me një vendim të Gjykatës, ndërsa “[GC]” se lënda është shqyrtuar nga Dhoma e Madhe. Aktgjykimet e Dhomës të cilat nuk janë të formës së prerë në momentin e azhurnimit të këtij publikimi janë shënuar me një asterisk (*).

I. Hyrje

Neni 1 i Protokollit Nr. 1 – E drejta në pronë

“1. Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

2. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.”

Fjalët kyçe në HUDOC

Obligimet pozitive (P1-1)

Pronat (P1-1-1) – Gëzimi paqësor i pronave (P1-1-1) – Ndërhyrja (P1-1-1) – Privimi nga prona (P1-1-1): Interesi publik (P1-1-1) – Përshkruar në ligj (P1-1-1): Qasshmëria (P1-1-1); Parashikueshmëria (P1-1-1); Mbrojtja nga abuzimi (P1-1-1) – Parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare (P1-1-1)

Kontrolli i shfrytëzimit të pronës (P1-1-2): Interesi i përgjithshëm (P1-1-2) – Sigurimi i pagesës së taksave (P1-1-2) – Sigurimi i pagesës së kontributeve dhe gjobave (P1-1-2)

1. Ky udhëzues mëton t’u ofrojë juristëve informata lidhur me aktgjykimet më të rëndësishme të kësaj sfere të cilat janë nxjerrë nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“Gjykata”) që nga themelimi i saj e deri sot. Në të sqarohen parimet kryesore të zhvilluara nga praktika gjyqësore e Gjykatës, krahas precedentëve relevantë. Praktika gjyqësore e cituar është e kufizuar dhe ka përzgjedhur aktgjykimet dhe vendimet më të rëndësishme dhe më të fundit.

2. Në fakt, aktgjykimet e Gjykatës së Strasburgut u shërbejnë jo vetëm rasteve të trajtuara nga Gjykata por edhe në përgjithësi për të sqaruar, mbrojtur dhe zhvilluar rregullat e vendosura nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“Konventa”), duke i kontribuar kështu respektimit të zotimeve të marra përsipër nga Shtetet si Palë Kontraktuese (*Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 154). Andaj, është mision i sistemit të Konventës që të përkufizojë çështje që ndërlidhen me politikat publike dhe interesin e përgjithshëm, duke ngritur kështu standardin e përgjithshëm të respektimit të të drejtave të njeriut dhe duke avancuar jurisprudencën nga fusha e të drejtave të njeriut në tërë komunitetin e Shteteve Anëtare të Konventës (*Konstantin Markin kundër Rusisë* [GC], § 89).

3. Neni 1 i Protokollit 1 garanton të drejtën në pronë. Në rastin *Marckx kundër Belgjikës*, §§ 63-64, Gjykata për herë të parë deklaroi se:

“...Duke nënkuptuar se të gjithë kanë të drejtë të gëzimit paqësor të pronës së vet, neni 1 në substancë garanton të drejtën në pronë. Kjo përshtypje qartësohet nga fjalët “prona” dhe “shfrytëzim i pronave” (në frëngjisht: “*biens*”, “*propriété*”, “*usage des biens*”); edhe procesi përgatitor i këtij Protokollit (“*travaux préparatoires*”) e konfirmon këtë qëllim pa kurrfarë dykuptimësie; hartuesit vazhdimisht kishin folur për “të drejtën në pronë” ose “të drejtën mbi pronat” për të sqaruar temën e trajtuar në draftet e ndryshme që ishin përgatitur nga hartuesit pararendës të këtij Neni 1. Në fakt, e drejta për të gëzuar pronën përbën një aspekt tradicional dhe fundamental të drejtës në pronë ...

Sidoqoftë, paragrafi i dytë i Nenit 1 e autorizon Shtetin Kontraktues që “të zbatojë ligjet që i konsideron të domosdoshme për të kontrolluar shfrytëzimin e pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm. Rrjedhimisht, ky paragraf i vendosë Shtetet Kontraktuese në rolin e gjyksesve të vetëm të “domosdoshmërisë” për një ligj të tillë... sa i përket “interesit të përgjithshëm” ai në raste të caktuara mund të nxitë ligjvënësit që të “kontrollojnë shfrytëzimin e pronës”...

II. Çështje të përgjithshme

A. Zbatimi i Nenit 1 të Protokollit 1 – “pronat”

Neni 1 i Protokollit Nr. 1 – E drejta në pronë

“1. Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. ...”

Fjalët kyçe në HUDOC

Pronat (P1-1-1) – Gëzimi paqësor i pronës (P1-1-1)

1. Koncepti i “pronave”

4. Koncepti i “pronave” në pjesën e parë të Nenit 1 të Protokollit 1 është autonom dhe mbulon edhe “pronat ekzistuese” dhe pasuritë, përfshirë kërkesat pasurore, lidhur me të cilat një parashtrues i kërkesës mund të ketë pasur së paku “pritje legjitime”. “Pronat” përfshijnë të drejtat “*in rem*” dhe “*in personam*”. Ky term përfshin patundshmëritë dhe pronat e luajtshme, si dhe interesat pronësorë tjerë.

a. Kuptimi autonom

5. Koncepti i “pronave” ka një kuptim autonom që është i pavarur nga klasifikimi formal në të drejtën kombëtare dhe nuk limitohet në pronësinë mbi mallrat fizike: edhe disa të drejta dhe interesa tjerë që përbëjnë prona mund të konsiderohen si të “drejta pronësore” e rrjedhimisht edhe si “prona” në kuptim të kësaj dispozite. Çështja që duhet të ekzaminohet në çdo rast është nëse rrethanat e rastit, të shqyrtuara në tërësi, i bartin parashtruesit të kërkesës pronësinë mbi një interes substancial të mbrojtur me Nenin 1 të Protokollit Nr.1 (*Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë* [GC], § 63; *Öneryıldız kundër Turqisë* [GC], § 124; *Broniowski kundër Polonisë* [GC], § 129; *Beyeler kundër Italisë* [GC], § 100; *Iatridis kundër Greqisë* [GC], § 54; *Centro Europa 7 S.R.L. dhe di Stefano kundër Italisë* [GC], § 171; *Fabris kundër Francës* [GC], §§ 49 dhe 51; *Parrillo kundër Italisë* [GC], § 211; *Béláné Nagy kundër Hungarisë* [GC], § 76).

6. Fakti që ligjet kombëtare të një Shteti nuk e njohin një interes të caktuar si të “të drejtë” ose edhe “të drejtë pronësore” jo domosdoshmërisht e parandalon interesin në fjalë, në disa rrethana të caktuara, që të njihet si “pronë” brenda të kuptuarit e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (*Depalle kundër Francës* [GC], § 68, në kuptim të një të drejte të revokueshme dhe jo shumë të bazuar për të zotëruar një pronë publike si rrjedhojë e kalimit të kohës; *Öneryıldız kundër Turqisë* [GC], § 129, në kuptim të interesit pronësor të parashtruesit të kërkesës mbi vendbanimin e tij të ndërtuar pa autorizim ligjor). Toleranca afatgjatë e autoriteteve ka rezultuar me bartjen e të drejtave pronësore parashtruesve të kërkesës edhe në raste të parcelave të kontestuara (*Kosmas dhe të tjerët kundër Greqisë*, §§ 68-71). Për më tepër, ligjet kombëtare që urdhërojnë shpronësimin e një parcele të tokës në disa rrethana, me të drejtë kompensimi, janë konsideruar se krijojnë interes pronësor (*Kutlu dhe të tjerët kundër Turqisë*, § 58).

7. Gjykata mund të merr parasysh ligjet kombëtare në fuqi në momentin e ndërhyrjes së pretenduar nëse nuk ka ndonjë faktor që sugjeron se ligji vepron në kundërshtim me rregullimin dhe qëllimin e Nenit 1 të Protokollit 1 (*Pressos Compania Naviera S.A. dhe të tjerët kundër Belgjikës*, § 31). Për shembull, ndërtimet e paligjshme në rrethana të caktuara mund të konsiderohen si “prona” (*Öneryıldız kundër Turqisë* [GC], § 127; *Depalle kundër Francës* [GC], § 85, shih paragrafin e mësipërm; *Brosset-Triboulet dhe të tjerët kundër Francës* [GC], § 71; *Keriman Tekin dhe të tjerët kundër Turqisë*, §§ 42-46), në veçanti nëse ligjet kombëtare pranojnë se ato i nënshtrohen të drejtës në pronë (*Ivanova dhe Cherkezov kundër Bullgarisë*, § 68). Rrjedhimisht, njohja e interesit pronësor nga gjykatat kombëtare është tejet relevante sipas vlerësimit të Gjykatës (*Broniowski kundër Polonisë* [GC], §§ 130-131), edhe pse nuk është fakt vendimtar.

8. Fakti që një e drejtë pronësore është e revokueshme në disa raste nuk e parandalon konsiderimin e saj si “pronë” të mbrojtur nga Neni 1, së paku deri në revokimin e saj (*Béláné Nagy kundër Hungarisë* [GC], § 75; *Krstić kundër Serbisë*, § 83; *Čakarević kundër Kroacisë*, § 52). Për shembull në rastin *Beyeler kundër Italisë* [GC], §§ 104-105, Gjykata ka konstatuar se ekziston interesi pronësor i mbrojtur nga Neni 1 i Protokollit Nr. 1, edhe pse kontrata e shitblerjes së një pikturë ishte konsideruar e pavlefshme dhe paligjshme nga autoritetet kombëtare, për arsye se parashtruesi i kërkesës kishte pasur në posedim pikturën për disa vite dhe ishte konsideruar nga autoritetet si bartës i interesit pronësor *de facto* dhe kishte marrë kompensim për të (shih gjithashtu më poshtë kapitullin mbi rastet e Mirëqenies Sociale).

9. Në rast të pasurisë jomateriale, Gjykata ka marrë në konsideratë në veçanti nëse pozita juridike në shqyrtim ka sajuar të drejta dhe interesa financiarë dhe rrjedhimisht nëse ajo ka bartur vlerë ekonomike. Për shembull, në këtë kuptim e ka shqyrtuar nëse prona intelektuale, siç janë markat tregtare dhe të drejtat autoriale (*Melnichuk kundër Ukrainës* (vendim); *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë* [GC], §§ 72, 76 dhe 78), ose licencat për përdorimin e pronës në një mënyrë të caktuar (siç janë licencat për shërbimin e pijeve alkoolike, apo të drejtat e peshkimit) *Tre Traktörer Aktiebolag kundër Suedisë*, § 53; *Alatulkkila dhe të tjerët kundër Finlandës*, § 66; *O’Sullivan McCarthy Mussel Development Ltd kundër Irlandës*, § 89) përbëjnë “prona”; siç ka bërë edhe lidhur me të drejtat ekskluzive për të shfrytëzuar domenet e internetit që janë regjistruar në emër të një kompanie (*Paeffgen GmbH kundër Gjermanisë* (vendim)).

b. “Pronat” e mbrojtura

10. Neni 1 i Protokollit Nr. 1 aplikohet vetëm mbi “pronat” ekzistuese të një personi (*Marckx kundër Belgjikës*, § 50; *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë* [GC], § 64).

11. Rrjedhimisht, një parashtrues i kërkesës mund të pretendojë shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 vetëm nëse vendimet dëmtuese kanë të bëjnë me “pronat” e tij brenda të kuptimit të kësaj dispozite. “Pronat” mund të jenë ose “pronat ekzistuese” ose pasuritë, përfshirë pretendimet pasurore, mbi të cilat parashtruesi i kërkesës mund të argumentojë se ka gëzuar të drejta efektive pronësore ose së paku ka pasur “pritje legjitime” për të gëzuar ato (*Pressos Compania Naviera S.A. dhe të tjerët kundër Belgjikës*, § 31; *J.A. Pye (Oxford) Ltd dhe J.A. Pye (Oxford) Land Ltd kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], § 61; *Von Maltzan dhe të tjerët kundër Gjermanisë* (vendim) [GC], § 74 (c); *Kopecký kundër Sllovakisë* [GC], § 35 (c)).

12. E në të kundërtën, shpresa e njohjes së një të drejte pronësore e cila nuk ka mundur të gëzohet efektivisht nuk mund të konsiderohet “pronë” brenda kuptimit të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, siç nuk mundet as ndonjë pretendim pronësor i kushtëzuar i cili skadon si rezultat i mosplotësimit të kushteve (*Princi Hans-Adam II i Lihenshtajnit kundër Gjermanisë* [GC], §§ 82-83; *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke* (vendim) [GC], § 69; *Kopecký kundër Sllovakisë* [GC], § 35(c); *Malhous kundër Republikës Çeke* (vendim) [GC]; *Nerva dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 43; *Stretch kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 32; *Centro Europa 7 S.R.L. dhe di Stefano kundër Italisë* [GC], § 172) (shih më poshtë kontekstin specifik të restitucionit të pronës së shpronësuar).

13. Një person që ankohet për shkelje pronësore të tij apo saj duhet së pari të dëshmojë se një e drejtë e tillë ka ekzistuar (*Pištárová kundër Republikës Çeke*, § 38; *Des Fours Walderode kundër Republikës Çeke* (vendim); *Zhigalev kundër Rusisë*, § 131). Fillimisht, i përket të drejtës kombëtare që të përshkruajë dhe identifikojë të drejtat kombëtare dhe është barrë e parashtruesit të kërkesës që të përkufizojë natyrën e saktë të së drejtës përkatëse sipas ligjeve kombëtare dhe formën se si ai e gëzon të drejtën në fjalë. Një aktgjykim me të cilin Gjykata Kushtetuese ka shpallur një ligj jokushtetues, dhe e ka shtyrë zbatimin e tij, nuk ka krijuar një pritje legjitime në periudhën para që të bëhet i zbatueshëm aktgjykimi (*Dobrowolski dhe të tjerët kundër Polonisë* (vendim), § 28).

14. Në rastet kur ka kontest lidhur me atë nëse një parashtrues i kërkesës ka interes pronësor i cili mund të mbrohet në bazë të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, Gjykata ka kërkuar që të përcaktohet statusi juridik i parashtruesit të kërkesës (*J.A. Pye (Oxford) Ltd dhe J.A. Pye (Oxford) Land Ltd kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], § 61). Gjykata nuk ka gjetur interes pronësor të mjaftueshëm për të përbërë

“pronë” në një rast kur likuidimi i pasurisë trashëgimore të babait të parashtrueses së kërkesës kishte ndodhur shumë para se të përcaktohej atësia e tij mbi parashtruesen e kërkesës (Wysowska kundër Polonisë (vendim), §§ 51-52).

15. Në anën tjetër, kur gjykatat kombëtare kanë validuar trashëgiminë e bashkëshortit të parashtrueses së kërkesës, ajo ka pranuar trashëgiminë nga bashkëshortit përmes një akti noterial dhe më pas e ka regjistruar pronën që i është transferuar në regjistrin e tokave, Gjykata ka konsideruar se interesi pronësor i trashëguar nga bashkëshorti i saj ka qenë për nga natyra i mjaftueshëm për tu njohur dhe konsideruar “pronë” (*Molla Sali kundër Greqisë* [GC], §§ 128-132).

i. Pritjet legjitime

16. Në disa raste, “pritja legjitime” për marrjen e një pasurie gjithashtu mund të gëzojë mbrojtje sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (*Pressos Compania Naviera S.A. dhe të tjerët kundër Belgjikës*, § 31; *a contrario Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke* (vendim) [GC], § 73).

17. Në mënyrë që një “pritje” të jetë “legjitime” ajo duhet të jetë e një natyre më konkrete se vetëm shpresë dhe të jetë e bazuar në një dispozitë ligjore apo akt ligjor, çfarë është vendimi gjyqësor lidhur me interesin pronësor në fjalë (*Kopecký kundër Sllovakisë* [GC], §§ 49-50; *Centro Europa 7 S.R.L. dhe di Stefano kundër Italisë* [GC], § 173; *Saghinadze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*, § 103; *Ceni kundër Italisë*, § 39; *Bélné Nagy kundër Hungarisë* [GC], § 75).

18. Koncepti i “pritjes legjitime” në kontekst të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 së pari është zhvilluar nga Gjykata në rastin *Pine Valley Developments Ltd dhe të tjerët kundër Irlandës*, § 51. Në këtë lëndë, Gjykata ka vendosur që “pritja legjitime” është shfaqur kur është dhënë leja e planifikimit kornizë, bazuar mbi të cilën kompanitë parashtruese të kërkesës e kanë blerë tokën me qëllim të ndërtimit mbi të. Leja e planit, e cila nuk ka mundur të revokohet nga autoritetet planifikuese, ishte “komponent kyç i pronës së kompanive parashtruese të kërkesës” (*po aty*, § 51; *Stretch kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 35, në kuptim të ushtrimit të opsionit për të ripërtërirë një kontratë afatgjatë të qirasë; dhe *Ceni kundër Italisë*, § 43, në kuptim të një parakontrate të nënshkruar për blerjen e një apartamenti, pagesës së çmimit të plotë dhe marrjes së posedimit nga parashtruesi i kërkesës). Në këtë kategori të rasteve, “pritja legjitime” bazohet rrjedhimisht në bazimin e arsyeshëm mbi një akt juridik që ka bazë të qëndrueshme ligjore dhe që trajton të drejtat pronësore (*Kopecký kundër Sllovakisë* [GC], § 47).

19. Një tjetër aspekt i nocionit “pritje legjitime” ilustron në rastin *Pressos Compania Naviera S.A. dhe të tjerët kundër Belgjikës*, § 31. Në bazë të një sërë vendimesh të Gjykatës së Kasacionit, Gjykata kishte konstatuar se parashtruesit e kërkesës mund të argumentonin se kanë pasur “pritje legjitime” se kërkesat e tyre lidhur me aksidentet gjatë transportimit të mallrave do të trajtoheshin sipas ligjit të përgjithshëm kontraktual, sipas të cilit pretendimet e tilla shfaqen në momentin e shkakimit të dëmit. “Pritja legjitime” e identifikuar këtu në vete nuk përbënte interes pronësor; ajo kishte të bëjë me mënyrën në të cilën pretendimi i kualifikuar si “pasuri” do të trajtohej në legjislacionin kombëtar (*Draon kundër Francës* [GC], § 70; *Maurice kundër Francës* [GC], §§ 67-69). Ngjashëm, në rastin *Uzan dhe të tjerët kundër Turqisë*, § 193, Gjykata gjeti se parashtruesit e kërkesës që ishin nën moshën madhore kanë pasur pritje legjitime sipas konceptit të “pronës”, duke qenë se gjykata vendore ua kishte njohur kapacitetin për të fituar të drejta të caktuara përmes trashëgimisë dhe donacionit.

20. Edhe e kundërta është e zbatueshme, nuk mund të thuhet se është shfaqur ndonjë pritje legjitime kur ka mospajtime lidhur me interpretimin dhe aplikimin e saktë të ligjeve kombëtare dhe kur parashtruesat pranë gjykatave kombëtare të parashtruesit të kërkesës janë refuzuar nga to (*Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë* [GC], § 65; *Centro Europa 7 S.R.L. dhe di Stefano kundër Italisë* [GC], § 173; *Bélné Nagy kundër Hungarisë* [GC], § 75; *Karachalios kundër Greqisë* (vendim), § 46; *Radomilja dhe të tjerët kundër Kroacisë* [GC], § 149).

21. Nuk shfaqet pritje legjitime në situatat kur parashtruesi i kërkesës bazohet vetëm në faktin se anëtarët e Qeverisë së paditur kanë bërë deklarata politike të favorshme lidhur me pretendimet për restitucion të parashtruesit të kërkesës (*Bata kundër Republikës Çeke* (vendim), § 77), ose në ndonjë

deklaratë programatike në një statut, që i referohet një statuti të ardhshëm i cili përfundimisht nuk është miratuar (*Zamoyski-Brisson kundër Polonisë* (vendim), § 78).

22. Në kërkesat lidhur me pretendimet që s'kanë të bëjnë me "prona" ekzistuese, kërkesa që rrethanat e rastit, të shqyrtuara në tërësi, t'ia bartin parashtruesi të kërkesës pronësinë mbi një interes thelbësor është ekzaminuar në forma të ndryshme në praktikën gjyqësore të Gjykatës (*Bélané Nagy kundër Hungarisë* [GC], § 76). Për shembull, në disa raste Gjykata ka shqyrtuar nëse parashtruesit e kërkesave përkatësisht kanë pasur "kërkesa të cilat është konfirmuar mjaftueshëm se janë të zbatueshme" (*Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke* (vendim) [GC], § 74); nëse e kanë demonstruar ekzistimin e "një të drejte të dhënë nga ligjet vendore për përfitime të mirëqenies sociale" (*Stec dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim) [GC], § 51); ose nëse personat në fjalë i kanë plotësuar "kushtet ligjore të përkufizuara në ligjin kombëtar për akordimin e çfarëdo forme të caktuar të përfitimeve" (*Richardson kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim), § 17).

23. Praktika gjyqësore e Gjykatës nuk parasheh ekzistimin e një "kontesti të vërtetë" apo një "kërkese të argumentueshme" si kriter për përcaktimin nëse ekziston "pritja legjitime" e mbrojtur nga Neni 1 i Protokollit Nr. 1, jo sikur në kontekst të përcaktimit të zbatueshmërisë së Nenit 6 të Konventës nën anën civile të procedurave të një rasti (*Kopecký kundër Sllovakisë* [GC], §§ 50 dhe 52; (*Draon kundër Francës* [GC], § 68). Prandaj nuk ka ndonjë ndërlidhje të domosdoshme mes ekzistimit të pretendimit të mbuluar me nocionin e "pronave" brenda kuptimit të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 dhe zbatueshmërisë së Nenit 6 § 1 mbi procedurat e ankimuar. Fakti që parashtruesit e kërkesës nuk kanë pasur pritje legjitime që pronat e tyre do t'u kthehen në bazë të dispozitave substanciale të ligjeve kombëtare ka qenë i mjaftueshëm për të përjashtuar zbatimin e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës në rrethanat e rastit. Njëkohësisht, nuk ka mjaftuar që të përjashtohet konkluzioni se pas shfaqjes së një kontesti të vërtetë dhe serioz lidhur me ekzistimin e të drejtave pronësore, garancitë e nenit 6 § 1 do të bëhen të zbatueshme (*Kopecký kundër Sllovakisë* [GC], § 52; *J.S. dhe A.S. kundër Polonisë*, § 51).

24. Në përmbledhje, pa marrë parasysh diversitetin e shprehjeve në praktikën gjyqësore me të cilat i referohet kërkesës që baza ligjore kombëtare të krijojë një interes pronësor, fryma e përgjithshme e tyre mund të përmbledhet si në vijim: në mënyrë që "pritja legjitime" të konsistojë në "pronë", parashtruesi i kërkesës duhet të ketë një të drejtë të konstatuar e cila, duke aplikuar parimin e theksuar në paragrafin 52 të aktgjykimit të rastit *Kopecký kundër Sllovakisë* [GC] (shih kapitullin vijues mbi Kërkesat dhe borxhet e gjykimit), nuk guxon të mos përmbushë statusin e interesit pronësor mjaftueshëm të përcaktuar dhe substantiv sipas legjislacionit kombëtar (*Bélané Nagy kundër Hungarisë* [GC], § 79).

c. Llojet e ndryshme të "pronave" dhe interesave pronësorë tjerë

i. Kërkesat dhe borxhet e gjykimit

25. Në mënyrë që një kërkesë të mund të konsiderohet "pasuri" brenda fushëveprimit të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, parashtruesi i kërkesës duhet të vërtetojë se ka bazë të mjaftueshme për këtë në legjislacionin kombëtar, për shembull në rastet kur ka praktikë gjyqësore të krijuar dhe konfirmuar nga gjykatat vendore (*Kopecký kundër Sllovakisë* [GC], § 52; *Plechanow kundër Polonisë*, § 83; *Vilho Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës* [GC], § 94; *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë* [GC], § 65; *Haupt kundër Austrisë* (vendim), § 47; *Radomilja dhe të tjerët kundër Kroacisë* [GC], § 142). Në rastet kur konfirmohet ky fakt mund të hyjë në përdorim "pritja legjitime" (*Draon kundër Francës* [GC], § 65).

26. Sa u përket kërkesave koncepti i "pritjes legjitime" ndërlidhet edhe me mënyrën në të cilën kërkesa e cila kualifikohet si "pasuri" do të trajtohet nga legjislacioni vendor dhe posaçërisht varet nga mënyra se si praktika gjyqësore e krijuar nga gjykatat kombëtare e ka aplikuar dhe mëton të vazhdojë ta aplikojë atë koncept (*Kopecký kundër Sllovakisë* [GC], § 48).

27. Edhe e kundërta është e vërtetë sepse Gjykata ka përjashtuar zbatueshmërinë e nocionit të "pritjes legjitime" në rastin e një kërkesë e cila nuk mund të jetë e suksesshme si rrjedhojë e intervenimit legjislativ të parashikueshëm në të ardhmen (*National & Provincial Building Society, Leeds Permanent Building Society dhe Yorkshire Building Society kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 69).

28. Një kërkesë e kushtëzuar e cila skadon si rezultat i mosplotësimit të kushteve nuk përbën pronë për qëllime të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (*Kopecký kundër Sllovakisë* [GC], § 35; *Princi Hans-Adam II i Lihtenshtajnit kundër Gjermanisë* [GC], § 83; *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër the Republikës Çeke* (vendim) [GC], § 69).

29. Borxhet gjyqësore që janë konstatuar mjaftueshëm si të zbatueshme përbëjnë “pronë” (*Stran Greek Refineries dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë*, § 59; *Burdov kundër Rosisë*, § 40; *Gerasimov dhe të tjerët kundër Rosisë*, § 179; *Yuriy Nikolayevich Ivanov kundër Ukrainës*, § 45; *Streltsov dhe rastet “Novocherkassk military pensioners” kundër Rosisë*, § 58). Në kontrast me këtë, një borxh gjyqësor që nuk është i formës së prerë dhe rrjedhimisht nuk është i pagueshëm menjëherë nuk mund të konsiderohet se “është konstatuar mjaftueshëm i zbatueshëm” dhe rrjedhimisht nuk përbën “pronë”.

30. Një shkelje e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 në ndërlidhje me nenin 14 të Konventës mund të shfaqet kur kushti është diskriminues (*Zeibek kundër Greqisë*, §§ 45-46). Kërkesat lidhur me trashëgimi dhe suksesion që përshkohen me dallime në trajtim janë konsideruar si “prona” (*Marckx kundër Belgjikës*, §§ 52-55; *Fabris kundër Francës* [GC], §§ 52-55).

ii. Aksionet në kompani dhe instrumentet tjera financiare

31. Në përgjithësi, aksionet në një kompani me vlerë ekonomike si dhe të drejtat tjera të ndërlidhura me aksionet të cilat aksionarëve u japin pushtet mbi kompaninë mund të konsiderohen “prona” (*Olczak kundër Polonisë* (vendim), § 60; *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, § 91; *Shesti Mai Engineering OOD dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, § 77). Kjo përfshin gjithashtu edhe kërkesat e tërthorta mbi asetet e kompanisë, përfshirë të drejtën mbi aksione në rast të mbylljes së kompanisë, por edhe të drejtat tjera korresponduese, përfshirë të drejtat e votimit dhe ndikimit mbi sjelljen dhe politikat e kompanisë (*Company S. dhe T. kundër Suedisë*, Vendim i komisionit; *Reisner kundër Turqisë*, § 45; *Marini kundër Shqipërisë*, § 165).

32. Në disa rrethana, pronari i vetëm i një kompanie mund të pretendojë të jetë viktimë brenda kuptimit të nenit 34 të Konventës për sa i përket masave të kundërshtuara të marra lidhur me kompaninë e tij apo saj (*Ankarcona kundër Suedisë* (vendim); *Glas Nadezhda EOOD dhe Anatoliy Elenkov kundër Bullgarisë*, § 40). Megjithatë, kur kjo nuk ndodhë, mosmarrja parasysh e personalitetit juridik të kompanisë mund të justifikohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, në veçanti kur veç është përcaktuar qartë se për kompaninë është e pamundshme që të paraqitet para institucioneve të Konventës përmes organeve të krijuara në bazë të statutit të saj ose, në rast të likuidimit, përmes likuiduesve të saj (*Agrotexim dhe të tjerët kundër Greqisë*, § 66; *Lekić kundër Sllovenisë* [GC], § 111; *CDI Holding Aktiengesellschaft dhe të tjerët kundër Sllovakisë* (vendim)); *Meltex Ltd dhe Movsesyan kundër Armenisë*, § 66; *Veselá dhe Loyka kundër Sllovakisë* (vendim)) ose kurdo që aktet apo vendimet e ankmuara kanë të bëjnë me vendimet e personave siç janë likuiduesit që veprojnë në emër të kompanisë (*G.J. kundër Luksemburgut*, § 24).

33. Në rastin *Lekić kundër Sllovenisë* [GC], § 111, Gjykata ka sqaruar se *testi Agrotexim* është aplikuar në disa raste kur janë trajtuar kërkesat e aksionarëve që të identifikohen me kompanitë përkatëse me qëllim të fitimit të statusit të “viktimit”, do të thotë “nga brenda” sipas kuptimit të dhënë nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GJND). Praktika gjyqësore e ndërlidhur me rastin *Agrotexim* nuk mund të transpozohet direkt në rastet që kanë të bëjnë me heqjen e vellos korporative nga shoqëritë me përgjegjësi të kufizuara në interes të kreditorëve të saj, ose “nga jashtë” sipas kuptimit të dhënë nga GJND. Në situatat kur një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara është shfrytëzuar vetëm si fasadë për veprime mashtruese nga pronarët apo drejtuesit e saj, heqja e vellos korporative mund të jetë zgjidhja e duhur për të mbrojtur të drejtat e kreditorëve të saj, përfshirë edhe Shtetin dhe ky veprim nuk mund të konsiderohet i gabueshëm si i tillë (*Khodorkovskiy dhe Lebedev kundër Rosisë*, § 877). Për më tepër, në rastet e paraqitura nga kreditorët e shoqërive me përgjegjësi të kufizuara ose bankave në pronë të Shtetit, Gjykata ka gjetur shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 për shkak të refuzimit të Shtetit të paditur për t’ia paguar borxhin e kompanisë apo bankës së gjetur në gabim, duke u fshehur prapa vellos korporative (*Ališić dhe të tjerët kundër Bosnjë e Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë, Sllovenisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* [GC], §§ 114-15). Në këtë drejtim, Gjykata është bazuar në faktorët

në vijim: nëse Shteti i ka thithur fondet korporative duke ia përkeqësuar kompanisë dhe aksionarëve të saj pozitën, nëse ka dështuar të qëndrojë larg menaxhimit të drejtpërdrejtë të kompanisë apo ka vepruar në forma tjera duke abuzuar formën korporative të saj (*po aty*).

34. Përfundimisht, Neni 1 i Protokollit Nr. 1 shtrihet edhe mbi letrat me vlerë, të cilat janë të negociueshme në tregun e kapitalit, transferohen nga një bartës tek një tjetër dhe vlera e së cilave mund të lëkundet varësisht nga shumë faktorë të jashtëm (*Mamatas dhe të tjerët kundër Greqisë*, § 90). Megjithatë, është konsideruar se bonot e thesarit të Shtetit me “qëllime të veçanta” ose për “mallra bazike” të cilat fillimisht garantojnë të drejtën e përfitimit në natyrë e kësajsoj edhe rregullohen me legjislacion kornizë dhe janë lëshuar në periudhën menjëherë pas ratifikimi të Konventës, nuk përbën të drejtë për të përfituar pronë (*Grishchenko kundër Rusisë* (vendim)).

iii. Klientela profesionale

35. Gjykata ka pranuar se të drejta të ngjashme me të drejtat pronësore kanë ekzistuar në rastet që kanë të bëjnë me praktika profesionale në të cilat përmes punës së tyre parashtruesit e kërkesave kishin ndërtuar klientelën e cila kishte, në shumë aspekte, natyrën e të drejtës private dhe përbënte një pasuri e rrjedhimisht edhe një pronë që bie brenda kuptimit të fjalisë së parë të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (*Lederer kundër Gjermanisë* (vendim); *Buzescu kundër Rumanisë*, § 81; *Wendenburg dhe të tjerët kundër Gjermanisë* (vendim); *Olbertz kundër Gjermanisë* (vendim); *Döring kundër Gjermanisë* (vendim); *Iatridis kundër Greqisë* [GC], § 54; *Van Marle dhe të tjerët kundër Holandës*, § 41; *Malik kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 89; *Rola kundër Sllovenisë*, Nr. 12096/14 dhe 39335/16; § 71; për një përmbledhje gjithëpërfshirëse të praktikës gjyqësore, shih *Könyv-Tár Kft dhe të tjerët kundër Hungarisë*, §§ 31-32).

iv. Licencat afariste

36. Licenca për të zhvilluar një afarizëm përbën pronë; revokimi i saj është ndërhyrje mbi të drejtat e garantuara me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (*Megadat.com SRL kundër Moldavisë*, §§ 62-63; *Bimer S.A. kundër Moldavisë*, § 49; *Rosenzweig dhe Bonded Warehouses Ltd. kundër Polonisë*, § 49; *Capital Bank AD kundër Bullgarisë*, § 130; *Tre Traktörer Aktiebolag kundër Suedisë*, § 53; *Vékony kundër Hungarisë*, § 29; *Fredin kundër Suedisë*, § 40; *Malik kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 90).

37. Licenca bankare është konsideruar “pronë” në rastet kur revokimi i saj automatikisht e vendosë bankën në likuidim të detyrueshëm, (*Capital Bank AD kundër Bullgarisë*, § 130).

38. Për më tepër, licenca për transmetim tokësor mbarëkombëtar televiziv pa alokim të frekuencave të transmetimit është privuar nga substanca e saj (*Centro Europa 7 S.R.L. dhe di Stefano kundër Italisë* [GC], § 177).

39. Ngjashëm, një autorizim për peshkim të farës së midhjeve, që lidhej me sjelljen e zakonshme të biznesit të akuakulturës të parashtruesit të kërkesës, u konsiderua “pronë” dhe ndalimi i përkohshëm i peshkimit të kësaj fare të midhjes u konsiderua kufizim i vendosur mbi këtë pronë (*O’Sullivan McCarthy Mussel Development Ltd kundër Irlandës*, § 89).

v. Të hyrat e ardhshme

40. Neni 1 i Protokollit Nr. 1 nuk krijon të drejtën për të fituar prona (*Denisov kundër Ukrainës* [GC], § 137). Të hyrat e ardhshme përbëjnë “pronë” vetëm nëse të hyrat janë fituar ose kur ekzistojnë kërkesa të zbatueshme (*Ian Edgar (Liverpool) Ltd kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim); *Wendenburg dhe të tjerët kundër Gjermanisë* (vendim); *Levänen dhe të tjerët kundër Finlandës* (vendim); *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë* [GC], § 64; *Denisov kundër Ukrainës* [GC], § 137).

41. Në anën tjetër, vëllimi i biznesit të gëzuar nga një profesion liberal, pa të hyra fikse dhe qarkullim të garantuar, të cilat rrezikohen nga veprimtaria ekonomike, nuk përbëjnë “pronë” (*Federata greke e punonjësve të Doganës, Gialouris dhe të tjerët kundër Greqisë*, Vendim i Komisionit).

vi. Prona intelektuale

42. Neni 1 i Protokollit Nr. 1 aplikohet edhe mbi pronat intelektuale si të tilla (*Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë* [GC], § 72).

43. Kjo është e aplikueshme edhe mbi kërkesat për regjistrimin e markave tregtare madje edhe para regjistrimit të saj (*Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë* [GC], § 78) si dhe markave tregtare *a fortiori* (*Kamoy Radyo Televizyon Yayincilik ve Organizasyon A.S. kundër Turqisë*, § 37), patentave (*Smith Kline dhe French Laboratories Ltd kundër Holandës* (vendim); *Lenzing AG kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Vendim i Komisionit), të drejtës autoriale (*Melnichuk kundër Ukrainës* (vendim). Bartësit e të drejtës autoriale mbrohen nga Neni 1 i Protokollit Nr. 1 (*Neij dhe Sunde Kolmisoppi kundër Suedisë* (vendim); *SIA AKKA/LAA kundër Letonisë*, § 41). E drejta për të publikuar një përkthim të një romani mbulohet nga dispozitat e kësaj dispozite (*SC Editura Orizonturi SRL kundër Rumanisë*, § 70), si edhe e drejta për vepra muzikore dhe interesat ekonomike që rrjedhin nga to, edhe përmes marrëveshjes së licencës (*SIA AKKA/LAA kundër Letonisë*, § 55).

vii. Qiraja në prona dhe të drejtat banesore

44. Në disa raste, Gjykata ka konsideruar qiranë si interes pronësor që nxitë mbrojtje nën Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (*Stretch kundër Mbretërisë së Bashkuar*, §§ 32-35; *Bruncrona kundër Finlandës*, § 79; *Bosphorus Hava Yolları Turizm ve Ticaret Anonim Şirketi kundër Irlandës* [GC], § 140). Në rastin *Di Marco kundër Italisë*, §§ 48-53, Gjykata ka konsideruar se pritja legjitime e parashtruesit të kërkesës që ndërlidhet me interesat pronësorë siç janë shfrytëzimi i tokës dhe aktivitetet komerciale që lidhen me të ishin mjaftueshëm të rëndësishme për të përbërë “pronë” nën kuptimin e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1

45. Shpesh paraqitet pyetja nëse Neni 1 i Protokollit Nr. 1 është i zbatueshëm edhe në fushën e banimit (shih edhe “Shkatërrimi i pronës në situata të konfliktit të armatosur ndërkombëtar apo të brendshëm”).

46. Në rastin *S. kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim) të Komisionit, parashtruesja e kërkesës kishte bashkëjetuar shumë vite në marrëdhënie me një person të të njëjtës gjini (me një grua tjetër), që ishte banuese e një shtëpie pronë e një autoriteti lokal. Vetë parashtruesja e kërkesës nuk kishte të drejta banimi apo të drejta tjera ligjore mbi shtëpinë në fjalë. Pas vdekjes së partneres së saj, autoriteti lokal filloi procedurën ndaj parashtrueses së kërkesës dhe morri urdhrin e gjykatës për dëbimin e saj. Komisioni konstatoi se nuk pa pasur lidhje kontraktuale mes parashtrueses së kërkesës dhe autoritetit lokal dhe se fakti që parashtruesja e kërkesës ka jetuar në këtë shtëpi për një periudhë të caktuar kohore pa të drejta pronësore mbi të nuk përbën “pronë” brenda kuptimit të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

47. Lidhur me ekzistimin e “pronave”, vendimi i Komisionit në rastin *Durini kundër Italisë* kishte të bëjë me pretendimet e një nëne dhe vajzave të saj se ato do duhej të kishin të drejtë të vazhdojnë të jetojnë në kështjellën familjare (pronë e një fondacioni), përkundër dëshirës dhe testamentit të paraardhësit të bashkëshortit dhe babait të ndjerë të tyre nga viti 1918 me të cilin theksohej se kjo e drejtë duhet t'i bartet si trashëgimi pasardhësit më të vjetër të gjinisë mashkullore. Komisioni konstatoi se e drejta e një individi për të jetuar në një kështjellë mbi të cilën nuk gëzon pronësinë nuk përbën “pronë” sipas kuptimit të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 dhe se kjo dispozitë, rrjedhimisht, nuk është e zbatueshme në këtë rast.

48. Përfundimisht, natyra e të drejtës së parashtruesit të kërkesës për një “qira sociale” nuk përbën “pronë” sipas kuptimit të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (*Tchokontio Happi kundër Francës*, § 60) pasi që sipas aktgjykimit vendor, parashtruesi i kërkesës do të gëzonte të drejtën e shfrytëzimit të një banese e jo të drejtën e fitimit të një banese.

viii. Përfitimet e sigurimit social/pensionet

49. Në praktikën gjyqësore më të vjetër të organeve të Konventës, dhënia e kontributeve të obligueshme në skemat e sigurimit social të çfarëdo lloji konsiderohej e drejtë e mbrojtur sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 vetëm kur ekzistonte lidhja direkte mes nivelit të kontributeve të paguara dhe përfitimeve të ndara (*Müller kundër Austrisë*, vendim i Komisionit, f. 49). Përndryshe, parashtruesi i kërkesës nuk kishte në asnjë moment të caktuar një pjesë të fondit të cilën mund ta identifikonte dhe kërkonte si të tillë (*G.*

kundër Austrisë, vendim i Komisionit, f. 86; *Kleine Staarman kundër Holandës*, Vendim i Komisionit, f. 166).

50. Megjithatë, në disa raste të mëvonshme, Gjykata në mënyrë konsistente ka konstatuar se edhe beneficinet sociale në skema jokontribuese mund të përbëjnë pronë për qëllime të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (*Bucheň kundër Republikës Çeke*, § 46; *Koua Poirrez kundër Francës*, § 37; *Wessels-Bergervoet kundër the Netherlands* (vendim); *Van den Bouwhuijsen dhe Schuring kundër Holandës* (vendim)).

51. Pasiguria lidhur me zbatueshmërinë e kësaj dispozite në raste të beneficioneve të sigurimit pensional përfundimisht është qartësuar në rastin *Stec dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim) [GC], §§ 47-56. Gjykata theksoi se në shumicën e Shteteve ekzistonte një gamë e gjerë e beneficioneve të sigurimit social të cilat ishin dizajnuar për të bartur përfitime që shfaqen si të drejta. Beneficinet e tilla financohen në mënyra të ndryshme: disa paguhen përmes kontributeve në fonde specifike, disa varen nga kontributet e vet parashtruesit të kërkesës; shumica paguhen nga taksat e përgjithshme në bazë të statusit të parapërcaktuar. Marrë parasysh metodat e shumta të financimit, dhe natyrën e ndërlidhur të përfitimeve nën shumicën e sistemeve të mirëqenies sociale, nuk mund të justifikohet më tej vlerësimi që vetëm beneficinet e paguara përmes kontributeve në një fond të posaçëm të trajtohen nga fushëveprimi i Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Më tej, përjashtimi i beneficioneve të paguara nga tatimet e përgjithshme do të mos merrte parasysh faktin se parashtruesit e kërkesave lidhur me këtë sistem kontribuojnë në këto fonde përmes pagesës së tatimeve.

52. Në Shtete moderne, demokratike, shumë individë përgjatë tërë jetës së tyre, ose së paku për një pjesë të saj, janë tërësisht të varur nga sigurimi social dhe beneficinet sociale. Shumë sisteme juridike nacionale e kuptojnë se individët e tillë duhet të gëzojnë një shkallë të sigurisë dhe sigurimit, dhe i konsiderojnë beneficinet që duhet paguar, natyrisht në rast të plotësimit të kushteve ligjore, si të drejtë. Në rastet kur një individ gëzon një të drejtë mbi një beneficion të tillë sipas ligjeve kombëtare, rëndësia e interesit të tillë duhet të pasqyrohet edhe përmes zbatimit të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (*Stec dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim) [GC], § 51; *Moskal kundër Polonisë*, § 39; *Andrejeva kundër Letonisë* [GC], § 77).

53. Neni 1 i Protokollit Nr. 1 nuk imponon kufizime mbi lirinë e Shteteve Kontraktuese për të vlerësuar nëse do të vendosin çfarëdo forme të skemës së sigurimit social, apo për të përzgjedhur formën apo vlerën e beneficioneve që ofrohen nën cilëndo skemë (*Sukhanov dhe Ilchenko kundër Ukrainës*, § 36; *Kolesnyk kundër Ukrainës* (vendim), §§ 89 dhe 91; *Fakas kundër Ukrainës* (vendim), §§ 34, 37-43, 48; *Fedulov kundër Rusisë*, § 66). Megjithatë, nëse Shteti Kontraktues ka në fuqi legjislacion që rregullon pagesën e caktuar si të drejtë të beneficinet, qoftë ai i kushtëzuar me pagesën e kontributeve paraprakisht apo jo, ky ligj duhet të konsiderohet se gjeneron interes pronësor që bie nën ombrellën e Nenit 1 të Protokollit nr. 1 për personat që i plotësojnë kushtet e caktuara nga i njëjti (*Stec dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim) [GC], § 54).

54. Legjislacioni që kushtëzon pagesën e pensionit të moshës, qoftë i kushtëzuar me pagesën e kontributeve apo jo, gjeneron interes pronësor që bie nën ombrellën e këtij Neni për të gjithë ata që i plotësojnë kushtet e caktuara nga i njëjti (*Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], § 64).

55. Kur personi në fjalë nuk i plotëson kushtet e caktuara (*Bellet, Huertas dhe Vialatte kundër Francës* (vendim), § 5), apo nuk i plotëson më tej ato, nuk ka ndërhyrje me të drejtat e përcaktuara nën Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (*Rasmussen kundër Polonisë*, § 71), kur kushtet kanë ndryshuar para se parashtruesi i kërkesës së fitonte të drejtën për një beneficion specifik (*Richardson kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim), § 17). Kur pezullimi apo zvogëlimi i një pensioni nuk ka ndodhur për shkak të ndryshimit të rrethanave të vet parashtruesit të kërkesës por për shkak të ndryshimeve të ligjit apo zbatimit të tij, kjo mund të rezultojë me shkelje të të drejtave të rregulluara me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (*Bélané Nagy kundër Hungarisë* [GC], § 86). Aq më shumë, Neni 1 i Protokollit Nr. 1 është konsideruar i zbatueshëm në një rast kur parashtruesi i kërkesës është urdhëruar beneficinet e pranuar si shprehje e vullnetit të mirë, në bazë të një vendimi administrativ në të cilin autoritetet kishin bërë gabim (*Čakarević kundër Kroacisë*, §§ 54-65).

56. Në rastin *Gaygusuz kundër Austrisë*, § 41, Gjykata kishte konstatuar se e drejta në asistencë emergjente, një beneficion social i ndërlidhur me pagesën e kontributeve në fondin e sigurimit të papunësisë, ishte për aq sa rregullohej me ligj e drejtë e cila mund të gëzohet sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Në rastin *Klein kundër Austrisë*, § 57, ishte thënë se gëzimi i të drejtës në pension të pagueshëm nga skema pensionale e avokatëve, ishte i ndërlidhur me pagesën e kontributeve dhe kur kontributet e tilla ishin paguar pagesa nuk mund t'i mohohet personit në fjalë. Kontributet në fondin pensional, si rrjedhojë, në disa raste të caktuara dhe të rregulluara me të drejtën kombëtare mund të krijojnë një të drejtë pronësore (*Kjartan Ásmundsson kundër Islandës*, § 39; *Apostolakis kundër Greqisë*, §§ 28 dhe 35; *Bellet, Huertas dhe Vialatte kundër Francës* (vendim); *Skórkiewicz kundër Polonisë* (vendim)). Për më shumë detaje, shih kapitullin për rastet e sigurimit social më poshtë.

57. Në rastin *Fedulov kundër Rusisë*, §§ 70-72, Gjykata gjithashtu ka konstatuar se e drejta e një personi me aftësi të kufizuara për medikamente pa pagesë (barëra për kancer) përbënte “pritje legjitime” e prandaj edhe mund të zbatohej Neni 1 i Protokollit Nr. 1.

ix. Shkatërrimi i pronës në situatë të konfliktit të armatosur ndërkombëtar apo të brendshëm – niveli i kërkuar i të provuarit

58. Në rastet kur parashtruesit e kërkesës janë ankuar për shkatërrimin e shtëpive të tyre në kontekst të konflikteve të armatosura, Gjykata e ka pranuar pretendimin e pronësisë në bazë të ekstrakteve nga regjistri i të drejtave banesore të lëshuar nga administrata e qytetit pas sulmit të ndodhur (*Kerimova dhe të tjerët kundër Rusisë*, § 293). Në rastin *DaMajev kundër Rusisë*, §§ 108-111, u konsiderua se parashtruesi i kërkesës që ankohej për shkatërrimin e shtëpisë së vet do duhej të ofrojë së paku një përkshkrim të shkurtër të pronës në fjalë. Si shembuj tjerë të dëshmive prima facie të pronësisë mbi një pronë apo banimit në të, Gjykata ka pranuar dokumentet siç janë dokumentet pronësore të tokës apo pronës, ekstraktet nga regjistrat e tokës apo regjistrat tatimorë, dokumentet e autoriteteve vendore, planet, fotografitë dhe faturat e mirëmbajtjes si dhe provat e dërgesave postare, deklaratat e dëshmitarëve apo provat tjera relevante (*Prokopovich kundër Rusisë*, § 37; *Elsanova kundër Rusisë* (vendim)). Edhe të ashtuquajturat pasaporta teknike, të trajtuara si “dokumente teknike regjistruese” ishin konsideruar se përbëjnë prova të tërthorta të pronësisë mbi shtëpi e toka (*Chiragov dhe të tjerët kundër Armenisë* [GC], §§ 140-141). Në përgjithësi, nëse një parashtrues i kërkesës nuk paraqet asnjë provë të drejtave pronësore apo banesore mbi pronën, ankesa e tij apo saj lidhur me shkatërrimin e saj do të dështojë pasi që Gjykata mund të mos jetë e bindur se ka prova të mjaftueshme për të pranuar se prona në fjalë ka ekzistuar dhe se bie nën ombrellën e “pronave” të parashtruesit të kërkesës (*Sargsyan kundër Azerbajxhanit* [GC], § 183; *Lisnyy dhe të tjerët kundër Ukrainës dhe Rusisë* (vendim), §§ 26-27).

59. Në rastin *Doğan dhe të tjerët kundër Turqisë*, i cili kishte të bënte me dëbimin e detyruar të fshatarëve në një rajon në juglindje të Turqisë si rrjedhojë e shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme dhe refuzimit të lejitimit të kthimit të tyre për disa vite, Qeveria e paditur kundërshtoi padinë duke thënë se disa parashtrues të kërkesës nuk i kanë paraqitur dokumentet e pronësisë për të vërtetuar se kanë pasur prona në fshat. Gjykata konsideroi se nuk ishte e domosdoshme të vendoset nëse në mungesë të dokumenteve pronësore parashtruesit e kërkesës gëzonin të drejta pronësore sipas ligjit kombëtar. Në fakt, pyetja që parashtrohej ishte nëse aktivitetet e gjithmbarshme ekonomike të ndërmarra nga parashtruesit e kërkesës përbënin “pronë” që do të binte nën fushëveprimin e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Pasi iu përgjigj pozitivisht kësaj pyetjeje, Gjykata theksoi se ishte e pakontestueshme që parashtruesit e kërkesës të gjithë kishin jetuar në fshatin Boydaş deri në vitin 1994. Edhe pse ata nuk kishin prona të regjistruara, ata shtëpitë ose i kishin ndërtuar në tokat e paraardhësve të tyre ose kishin jetuar në shtëpi që ishin pronë e baballarëve të tyre dhe kishin kultivuar tokën që u përkiste atyre; ata kishin të drejta të pakontestueshme mbi tokat e përbashkëta në fshat, siç ishin kullosat, zabelet dhe tokat pyjore, dhe kishin siguruar jetesën nga blegtoria dhe prerja e druve. Të gjitha këto burime ekonomike dhe të hyra të parashtruesve të kërkesës i kualifikonin ato si “prona” që i nënshtrohen Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (*po aty*, § 139).

60. Për ta përmbledhur çështjen, parashtuesit e kërkesës duhet të ofrojnë prova *prima facie* për ta përkrahur ankesën e tyre sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës lidhur me shkatërrimin e pronës në kontekst të konfliktit të armatosur.

x. Embrionet njerëzore

61. Marrë parasysh fushëveprimin ekonomik dhe monetar të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, embrionet njerëzore nuk mund të konsiderohen thjeshtë “prona” sipas kuptimit të kësaj dispozite (*Parrillo kundër Italisë* [GC], § 215).

B. Ndërhyrja me të drejtën për gëzim paqësor të pronës

1. Qasja “tri rregullat”

62. Pasi që të ketë konstatuar se Neni 1 i Protokollit Nr. 1 është i zbatueshëm në rrethanat e një rasti, Gjykata i qaset analizës substanciale të rrethanave të ankimuara.

63. Neni 1 i Protokollit Nr. 1 përbëhet nga tri rregulla të ndara. Rregulli i parë, të cilin e përmban fjalia e parë e paragrafit, është i natyrës së përgjithshme dhe përcakton parimin e gëzimit paqësor të pronës. Rregulli i dytë, i cili përkufizohet në fjalinë e dytë të paragrafit të parë, mbulon vetëm privimin e “pronave” dhe e kushtëzon atë me plotësimin e disa kushteve. Rregulli i tretë, i vendosur në paragrafin e dytë, ua njeh Shteteve Anëtare të drejtën që, mes tjerash, të kontrollojë shfrytëzimin e pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm (*Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë*, § 61; *Iatridis kundër Greqisë* [GC], § 55; *J.A. Pye (Oxford) Ltd dhe J.A. Pye (Oxford) Land Ltd kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], § 52; *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë* [GC], § 62; *Ališić dhe të tjerët kundër Bosnjë e Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* [GC], § 98; *Immobiliare Saffi kundër Italisë* [GC], § 44; *Broniowski kundër Polonisë* [GC], § 134; dhe *Vistiņš dhe Perepjolkins kundër Letonisë* [GC], § 93).

64. Këto tri rregulla nuk janë “të ndryshme” në kuptim të të mos qenit të lidhura: rregulli i dytë dhe i tretë rregullojnë instanca të caktuara të ndërhyrjes me të drejtën për gëzim paqësor të pronës dhe rrjedhimisht duhet të kuptohen nën frymën e parimit të përgjithshëm të theksuar në fjalinë e parë (*Ish Mbreti i Greqisë dhe të tjerët kundër Greqisë* [GC], § 50; *Bruncrona kundër Finlandës*, § 65; *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë* [GC], § 62) (për më shumë detaje, shih nënkapitujt për Privimin e Pronës, Kontrollin e shfrytëzimit apo Rregullin e përgjithshëm).

65. Për tu konsideruar në pajtim me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1, ndërhyrja duhet të plotësojë disa kritere të caktuara: duhet t’i përmbahet parimit të ligjshmërisë dhe ndjekjes së qëllimeve legjitime përmes mjeteve arsyeshëm proporcionale me qëllimin e mëtuar që të arrihet (*Beyeler kundër Italisë* [GC], §§ 108-114).

66. Kjo qasje e strukturon metodën e ekzaminimit të Gjykatës në rastet kur bindet se Neni 1 i Protokollit Nr. 1 është i zbatueshëm (shih kapitullin mbi Zbatueshmërinë e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1). Ajo përbëhet nga disa hapa të njëpasnjëshëm me të cilët adresohen pyetjet në vijim: A ka pasur ndërhyrje mbi të drejtën e parashtuesit të kërkesës për ta gëzuar “pronën” e tij/saj në mënyrë paqësore? Nëse po, a përbën ndërhyrja në fjalë privim të pronës? Nëse jo, a është kontrolluar shfrytëzimi i pronës në fjalë? Nëse masa e cila ka ndikuar mbi të drejtat e parashtuesit të kërkesës nuk mund të kualifikohet as si provim i pronës as si kontroll i shfrytëzimit të saj, a mund të interpretohen faktet e rastit nga Gjykata në frymën e parimit të përgjithshëm të respektimit të gëzimit paqësor të “pronave”?

67. Në shumicën dërmuese të rasteve, nëse vërtetohet nga Gjykata se ndërhyrja nuk është bërë në pajtim me ligjin ose nuk ka qenë në interes publik, ajo konsideron se ka pasur shkelje të Konventës si rrjedhojë e kësaj dhe nuk e konsideron të domosdoshme që t’i hyjë analizës së proporcionalitetit të masave kundër të ankimuara (*Simonyan kundër Armenisë*, §§ 25-26; *Vijatović kundër Kroacisë*, § 58; *Gubiyev kundër Rusisë*, § 83; *Dimitrovi kundër Bullgarisë*, §§ 52-56; dhe *Bock dhe Palade kundër*

Rumanisë, §§ 58-65) (për më shumë detaje, shih nënkapitujt e Parimit të ligjshmërisë dhe Interesit publik apo të përgjithshëm).

68. Megjithatë, në raste të rralla, Gjykata e lë një nga këto pyetje të hapura dhe vazhdon të ekzaminojë rastin nën prizmin e proporcionalitetit (*Megadat.com SRL kundër Moldovisë*, § 67, dhe *Ünspeid Paket Servisi SaN. Ve TiC. A.Ş. kundër Bullgarisë*, § 43) (për më shumë detaje, shih nënkapitullin e Proporcionalitetit dhe çështjeve të ndërlidhura (bilanci i drejtë kompensimi, margjina e vlerësimit)).

69. Pasi që Gjykata të jetë bindur se ka pasur ndërhyrje me të drejtat e parashtruesit të kërkesës, ajo vlerëson çdo rast për të parë në cilën kategori bie ndërhyrja e ankimuar. Nëse pronësia e parashtruesit të kërkesës është cenuar në bazë të dispozitave të ligjit kombëtar, ajo do të ekzaminojë rastin nën fjalinë e dytë të paragrafit të parë, do të thotë si privim i “pronave”. Privimi i “pronave” mbulon një gamë të gjerë situatash, pa marrë parasysh se si ato janë kualifikuar sipas ligjeve vendore, në rastet kur vet substanca e një të drejte individuale është cenuar.

70. Masat më pak ndërhyrëse se sa shpronësimi mund të kualifikohen nga Gjykata si “kontroll i shfrytëzimit të pronës”. Në disa raste, duhet të tërhiqet një vijë e hollë mes masave të cilat kualifikohen si kontroll i shfrytëzimit të pronës dhe atyre që përbëjnë privim të pronës. E njëjta është e zbatueshme edhe lidhur me dallimin që duhet bërë mes shfrytëzimit të pronës dhe masave të ekzaminuara nga Gjykata nën parimin e parë të gëzimit paqësor të “pronës”. Në përgjithësi, sa më pak ndërhyrëse të jetë masa, aq më shumë i nënshtrohet analizës sipas parimit të parë e jo sipas atij të kontrollit të shfrytëzimit.

71. Masat e ngjashme mund të kualifikohen ndryshe nga Gjykata (p.sh. në rastin *Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë*, §§ 62-64, një urdhër shpronësimi i kombinuar me ndalimin e ndërtimit për një periudhë të konsiderueshme kohore është analizuar si trajtë e kontrollit të shfrytëzimit të pronës, ndërsa masa të ngjashme janë analizuar nën parimin e përgjithshëm në rastet *Phocas kundër Francës*, § 52; *Iatridis kundër Greqisë* [GC], § 55; *Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë*, § 40; *Pialopoulos dhe të tjerët kundër Greqisë*, § 53. Ngjashëm, në rastin *Pressos Compania Naviera S.A. dhe të tjerët kundër Belgjikës*, § 34, ndalimi i kërkesave për kompensim përmes intervenimit legjislativ është ekzaminuar si privim i pronës, ndërsa në rastin *Stran Greek Refineries dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë* Gjykata e ka ekzaminuar të njëjtin lloj mase nën prizmin e rregullit të parë të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

72. Në disa raste është më e vështirë për Gjykatën të kualifikojë një masë apo një sërë masash si privim apo kontroll të shfrytëzimit të pronës sepse në thelb ato nuk mund të asimilohen lehtë në masa të kualifikueshme sipas praktikës gjyqësore ekzistuese ose për shkak se masat në fjalë përbëhen nga vendime të ndryshme që preken nga degë të ndryshme të ligjeve kombëtare. Në raste të tilla, zakonisht Gjykata analizon rrethanat e rastit nën parimet e përgjithshme të fjalisë së parë të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Kjo do të aplikohet në veçanti në situata të cilat nuk kanë të bëjnë me vetëm një vendim por me një kombinim të masave/vendimeve të ndryshme që kanë pasur ndikim mbi pronën e parashtruesit të kërkesës (*Dokić kundër Bosnjë e Hercegovinës*, §§ 55-56 – një kontratë e blerjes të një banese ligjërisht e vlefshme, parashtruesi i kërkesës i regjistruar si pronar por i paaftë për ta rikthyer banesën; dhe *Matos e Silva, Lda., dhe të tjerët kundër Portugalisë*, § 85 – në mungesë të një vendimi formal të shpronësimit, kufizimi i të drejtës pronësore rridhte nga aftësia e reduktuar për ta shfrytëzuar atë nga dëmet e shkaktuara prej faktit që ishte paramenduar shpronësimi i saj; por parashtruesit e kërkesës vazhdonin të punojnë tokën). Në një rast kur parashtruesit e kërkesës ishin ankuar se të drejtat e tyre ishin shkelur si rrjedhojë e mospërputhjes mes vlerësimit të vlerës së tregut të pronës së shpronësuar për qëllime të vlerësimit të kompensimit dhe për qëllime të përcaktimit të tatimit në trashëgimi për pronën e njëjtë, duke qenë se shpronësimi dhe tatimimi ishin ekzaminuar ndaras dhe nuk ishte gjetur asnjë shkelje. Megjithatë, efekti i kombinuar i të dy masave ishte ekzaminuar nën prizmin e rregullit të parë dhe kishte rezultuar në gjetjen e një shkeljeje (*Jokela kundër Finlandës*, §§ 61-65).

73. Në raste të tilla edhe pse masat nuk kanë pasur të njëjtin efekt juridik dhe kanë pasur qëllime të ndryshme, Gjykata normalisht konsideron se ato duhet të shqyrtohen së bashku nën parimin themelor të respektimit të gëzimit paqësor të “pronave” (*Matos e Silva, Lda., dhe të tjerët kundër Portugalisë*, §§ 84-85).

74. Vështirësia e kualifikimit të masës si kontroll i shfrytëzimit apo si masë që bie nën parimin e përgjithshëm gjithashtu pasqyrohet në faktin se në disa raste Gjykata nuk tregon shprehimisht se cilën pjesë të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 e ka aplikuar në të (*Papamichalopoulos kundër Greqisë*, § 46) ose shprehimisht lë këtë pyetje të hapur (*Lavrechov kundër Republikës Çeke*, § 43; *Denisova dhe Moiseyeva kundër Rusisë*, § 55; *Ünsper Paket Servisi SaN. Ve TiC. A.Ş. kundër Bullgarisë*, §§ 39-40).

75. Në çdo rast, Gjykata do të aplikojë të njëjtat kritere të vlerësimit, pa marrë parasysh klasifikimin e ndërhyrjes. Në të gjitha rastet, ajo duhet t'i shërbejë interesit publik (shih kapitullin mbi Ndërhyrjen në interes publik më poshtë), duhet t'u përmbahet kushteve të përshkruara në ligj (shih kapitullin mbi Ndërhyrjen në bazë të kushteve të përcaktuara me ligj më poshtë) dhe të kalojë testin e balancimit të drejtë (shih kapitullin mbi Proporcionalitetin dhe çështjet e ndërlidhura më poshtë).

76. Procedurat lidhur me kontestet nga e drejta civile mes palëve private nuk sjellin si të tilla përgjegjësi të Shtetit sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës (*Ruiz Mateos kundër the Mbretërisë së Bashkuar*, Vendim i Komisionit, f. 268 dhe f. 275; *Gustafsson kundër Suedisë* [GC], § 60; *Skowroński kundër Polonisë* (vendim); *Kranz kundër Polonisë* (vendim); *Eskelinen kundër Finlandës* (vendim); *Tormala kundër Finlandës* (vendim); *Rustavi 2 Broadcasting Company Ltd dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë**, § 310). Vetë fakti se Shteti, përmes sistemit gjyqësor të tij, ofron një forum për zgjidhjen e kontesteve të drejtës private nuk shkakton shfaqjen e ndërhyrjes së një Shteti mbi të drejtat pronësore sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (*Kuchař dhe Štis kundër Republikës Çeke*, Vendim i Komisionit), edhe nëse rezultati substancial i aktgjykimit të nxjerrë nga gjykatat civile rezulton me humbjen e disa “pronave”. Megjithatë, është pjesë e detyrave të Shteteve sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 që së paku të krijojnë kornizën ligjore dhe themelojnë një forum të duhur për t'u mundësuar atyre që pretendojnë se të drejtat e tyre janë shkelur që të kërkojnë të drejtat e tyre në mënyrë efektive dhe t'i realizojnë ato. Në rast të dështimit për të bërë këtë, Shtetet seriozisht shkelin obligimin e tyre për të mbrojtur sundimin e ligjit dhe për të parandaluar arbitraritetin (*Kotov kundër Rusisë* [GC], § 117).

77. Juridiksioni i Gjykatës për të vërtetuar se ligjet vendore janë interpretuar në formë të saktë dhe janë zbatuar përkitazi është i kufizuar dhe nuk është pjesë e funksionit të saj që të zë vendin e gjykatave vendore. Në fakt, roli i saj është që të sigurojë që vendimet e këtyre gjykatave nuk janë arbitrare apo ndryshe dukshëm të paarsyeshme (*Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë* [GC], § 83). Shteti mund të konsiderohet përgjegjës për humbjet e shkaktuara nga vendimet në fjalë vetëm nëse vendimet e gjykatës nuk janë në pajtim me ligjet e vendit apo nëse janë me defekte të shkaktuara nga arbitrariteti apo paarsyeshmëria e dukshme e tyre, në kundërshtim me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1, ose një person është privuar nga prona e tij/saj në dobi të tjetrit në mënyrë të padrejtë dhe arbitrare (*Bramelid dhe Malmström kundër Suedisë*, Vendim i Komisionit, f. 82-83; *Dabić kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* (vendim); *Vulakh dhe të tjerët kundër Rusisë*, § 44).

78. Në shumë pak raste Gjykata përjashtimisht ka konsideruar një aktgjykim të gjykatës civile si ndërhyrje për shkak të modaliteteve të ekzekutimit të saj kanë qenë aq jofleksibile sa që kanë vendosur barrë shtesë mbi njërin palë (*Milhau kundër Francës*, §§ 48-53). Kjo ndodhi edhe në një rast kur një banesë e blerë nga parashtruesi i kërkesës mbi bazën e dokumenteve të falsifikuara që shfaqnin blerjen si pjesë të skemës së privatizimit e që më pas u morr nga komuna, ndërsa gjykata kishte konsideruar se lënda e trajtuar në këtë rast dhe dispozitat substanciale të zbatueshme përbënin elemente të theksuara të së drejtës publike dhe implikonin Shtetin në kapacitetin rregullator të tij (*Gladysheva kundër Rusisë*, §§ 52-59). Ngjashëm, në rastin *Zhidov dhe të tjerët kundër Rusisë*, §§ 94-95, Gjykata kishte konsideruar se vendimet kufizuese gjyqësore të nxjerra në procedurë mes palëve private kishin përbërë “ndërhyrje” sepse ndiqnin interesin publik. Në rastin *SIA AKKA/LAA kundër Letonisë*, §§ 58-59, një aktgjykim i nxjerrë në procedurat lidhur me mbrojtjen e pronës intelektuale të autorëve që ia kishin besuar organizatës së parashtruesit të kërkesës menaxhimin e të drejtës tregtare mbi veprat muzikore të tyre ishte konsideruar se përbën ndërhyrje sepse kufizonte të drejtën e organizatës së parashtruesit të kërkesës për të hyrë lirshëm në kontrata lidhur me emetimin e muzikës.

a. Privimi i pronës

79. Në rastet kur të drejtat e parashtruesit e kërkesës janë dalluar nga ligji, Gjykata do të ekzaminojë ankesat e parashtruesit të kërkesës nën rregullin e dytë, që është privimi i pronës.

80. Në rastin *Manastiret e shenjtja kundër Greqisë*, §§ 60-61, Gjykata ka konstatuar se një dispozitë statutore e cila automatikisht ia bartë shfrytëzimin dhe posedimin e një prone të caktuar Shtetit kishte për efekt transferimin e pronësisë së plotë mbi tokën në fjalë tek Shteti dhe përbën privim të “posedimit”.

81. Privimi i “pronave” mund të shfaqet edhe në situata kur nuk ka pasur vendim formal që dallon të drejtat individuale, por ndikimi i masave të ndryshme të aplikuara nga autoritetet shtetërore mbi “pronat” e parashtruesit të kërkesës është aq i theksuar sa që i bën ato të pandashme nga shpronësimi. Në mënyrë që të përcaktohet nëse ka pasur privim të “pronave”, Gjykata duhet të mos kufizohet në ekzaminimin nëse ka pasur privim posedimi apo shpronësim formal; Gjykata duhet të vlerësojë përtej pamjes së parë dhe të hetojë realitetet e situatës së ankumuar. Pasi që Konventa ka për qëllim të garantojë të drejtat të cilat janë “praktike dhe efektive”, sepse duhet të vlerësohet nëse situata ka përbërë shpronësim de facto (mes autoriteteve tjera *Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë*, § 63; *Vasilescu kundër Rumanisë*, § 51; *Schembri dhe të tjerët kundër Maltës*, § 29; *Brumărescu kundër Rumanisë* [GC], § 76; *Depalle kundër Francës* [GC], § 78). Në fakt, varësisht nga nenet e ndryshme të Konventës, praktika gjyqësore e Gjykatës tregon se mund të jetë e domosdoshme që të ekzaminohet përtej pamjes dhe gjuhës së shfrytëzuar dhe të koncentrohet në realitetin e situatës (për shembull *Apap Bologna kundër Maltës*, § 83).

82. Për shembull, në një rast kur marina kishte marrë në posedim tokën e parashtruesve të kërkesës dhe kishte ndërtuar në të një bazë marine dhe parashtruesit e kërkesës rrjedhimisht nuk kanë pasur më qasje në pronën e tyre dhe nuk kanë mundur ta shesin, zotojnë, hipotekojnë apo dhurojnë atë, dhe nuk kanë gëzuar asnjë kapacitet ligjor pronësor mbi tokën, krahas përpjekjeve për të rregulluar situatën, e kjo ka krijuar *de facto* pasoja serioze për parashtruesit e kërkesave të mjaftueshme për Gjykatën për të konsideruar se të njëjtat janë shpronësuar edhe në mungesë të një vendimi formal të shpronësimit (*Papamichalopoulos kundër Greqisë*, §§ 44-46).

83. Në një rast që kishte të bëjë me vazhdimin e mbajtjes së monedhave të arta të konfiskuara para hyrjes në fuqi të Protokollit Nr. 1, në të cilin aktgjykimi që urdhëronte kthimin e monedhave tek parashtruesi i kërkesës u shfuqizua, Gjykata theksoi se pengesat praktike mund të përbëjnë shkelje të Konventës në të njëjtën masë me shkeljet ligjore. Humbja e aftësisë për të disponuar me pronën e shqyrtuar krahas dështimit të përpjekjeve të bëra për të rregulluar situatën përbënin pasoja mjaftueshëm serioze për parashtruesin e kërkesës për t’u konsideruar nga Gjykata si *de facto* konfiskim (*Vasilescu kundër Rumanisë*, §§ 51-54).

84. Në një rast tjetër, një komuna kishte nxjerrë një urdhër, nën procedurë të përshpejtuar, për posedimin e tokës së kompanisë së parashtruesit të kërkesës, morri në posedim fizik tokën në fjalë dhe filloi ndërtimin e rrugës, ndërsa aktgjykimi që pasoi autorizoi në retrospektivë posedimin e paligjshëm nga autoritetet publike dhe e privoi kompaninë e parashtruesit të kërkesës nga mundësia e përfitimit të restitucionit për tokën e saj. Efekti i aktgjykimit në këtë rast përbënte privim të “pronave” (*Belvedere Alberghiera S.r.l. kundër Italisë*, § 54). Humbja e 40 për qind dhe 100 për qind të vlerës së parcelave të tokës, kombinuar me humbjen e pjesshme të qasjes fizike mbi to si rezultat i ndërtimit të një pende, gjithashtu u konsiderua se përbën *de facto* shpronësim (*Aygun kundër Turqisë*, § 39). Një konkluzion i ngjashëm ishte nxjerrë edhe sa i përket rrënimit të paligjshëm të një ndërtese (*Zammit dhe Vassallo kundër Maltës*, § 54).

85. Nëse Gjykata konsideron një masë apo një set masash si shpronësim, kjo normalisht përbën obligim për Shtetin që të sigurojë kompensim për pronarin e prekur (shih nënkapitullin mbi kompensimin për Ndërhyrje në pronë sie element i balancimit të drejtë).

b. Kontrolli i shfrytëzimit

86. Masat e kualifikuara nga Gjykata si kontroll i shfrytëzimit në bazë të rregullit të tretë mbulojnë një gamë të gjerë situatash, përfshirë, për shembull: revokimin ose ndryshimin e kushteve të licencave që ndikojnë në afarizëm (*Tre Traktörer Aktiebolag kundër Suedisë*, § 55; *Rosenzweig dhe Bonded Warehouses Ltd. kundër Polonisë*, § 49; *Bimer S.A. kundër Moldavisë*, §§ 49 dhe 51; *Megadat.com SRL kundër Moldavisë*, § 65); themelimi i monopolit të Shtetit mbi tregun e librave shkollorë (*Könyv-Tár Kft dhe të tjerët kundër Hungarisë*, §§ 43 dhe 59); sistemet e kontrollit të qirasë (*Mellacher dhe të tjerët kundër Austrisë*, § 44); *Hutten-Czapska kundër Polonisë* [GC], § 160; *Anthony Aquilina kundër Maltës*, § 54; *Bittó dhe të tjerët kundër Sllovakisë*, § 101); pezullimin statutor të zbatimit të urdhrave të riposedimit kundrejt banorëve që kishin pushuar së paguari qira (*Immobiliare Saffi kundër Italisë* [GC], § 46); kufizimet e imponuara me ligj në nivel të qirasë që pronarët e pronës mund të kërkonin nga qiramarrësit dhe vazhdimi i pakufizuar kohor i një kontrate të qirasë me kushte të njëjta, përderisa pronarët kishin vazhduar të pranojnë qiratë sipas kushteve për të cilat lirshëm ishin marrë vesh në momentin e nënshkrimit të kontratës dhe kanë pasur mundësinë e lirë të shitjes së tokës me gjithë faktin se shitja në fjalë ka mundur të bëhet duke iu përmbajtur kontratës së qirasë e cila ishte e zbatueshme për tokën (*Lindheim dhe të tjerët kundër Norvegjisë*, § 75-78); humbja e disa të drejtave ekskluzive mbi tokën (*Chassagnou dhe të tjerët kundër Francës* [GC], § 74 – obligimi që të tolerohet gjuetia në tokën e parashtresve të kërkesave; *Herrmann kundër Gjermanisë* [GC], § 72); refuzimi i lëshimit të regjistrimit të veturës (*Yaroslavtsev kundër Rusisë*, § 32; *Sildedzis kundër Polonisë*, § 45); imponimi i obligimeve pozitive mbi pronarët e tokave (p.sh. pyllëzimi i obliguar – *Denev kundër Suedisë*, Vendim i Komisionit); pse imponimi i kualifikimit ligjor si tokë pyjore, me obligime të kujdesit të imponuara mbi pronarin e saj (*Ansay dhe të tjerët kundër Turqisë* (vendim)).

87. Demolimi i ndërtesave të cilat janë ndërtuar në mënyrë të paligjshme zakonisht konsiderohet si kontroll i shfrytëzimit të pronës (*Ivanova dhe Cherkezov kundër Bullgarisë*, § 69). Në rastin *Saliba kundër Maltës*, § 46, Gjykata ka konsideruar se efekti i urdhërimit të demolimit të një ndërtese tërësisht të paligjshme ishte që gjendja të kthehet në situatën e cila do të ekzistonte nëse nuk do të ishin anashkaluar kërkesat ligjore. Megjithatë, në disa raste, masat e demolimit përbëjnë ndëshkim dhe rrjedhimisht janë trajtuar nën prizmin penal të Nenit 6 të Konventës, edhe pse nuk ka pasur dënim penal (*Hamer kundër Belgjikës*, §§ 59-60). Ngjashëm, në rastin *Sud Fondi srl dhe të tjerët kundër Italisë* (vendim), Gjykata konstatoi se Neni 7 aplikohet në konfiskimin e tokës mbi të cilën është ndërtuar paligjshëm që ka rezultuar me demolimin e mëpasshëm të ndërtesës së ngritur mbi të.

88. Konfiskimi dhe sekuestrimi zakonisht nga Gjykata trajtohen si kontroll i shfrytëzimit të pronës, që duhet shqyrtuar në bazë të paragrafit të dytë të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, përkundër faktit të dukshëm se ngërthejnë në vete privim të “pronës” (*AGOSI kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 51; *Raimondo kundër Italisë*, § 29; *Honecker dhe të tjerët kundër Gjermanisë* (vendim); *Riela dhe të tjerët kundër Italisë* (vendim)). Prandaj, qasja konstante e Gjykatës ka qenë që masa e konfiskimit përbën kontroll të shfrytëzimit të Pronës (*Air Canada kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 34; *Silickienė kundër Lituanisë*, § 62). Në rastin *S.A. Bio d’Ardenne kundër Belgjikës*, §§ 47-49, therja e detyruar e disa kafshëve të infektuara me brucelozë për shkak të disa shkeljeve të rregulloreve mbi shëndetin e kafshëve përbënte kontroll të shfrytëzimit.

89. Megjithatë, kur konfiskimi i një instrumenti të krimit ka të bëjë me prona të palëve të treta dhe përbën masë permanente, Gjykata i ka analizuar ndërhyrjes nga këndvështrimi i privimit të pronës (*Andonoski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, § 36 – konfiskimi i përhershëm i një veture të shfrytëzuar nga një palë e tretë për kontrabandimin e emigrantëve në rastin; *B.K.M. Lojistik Tasimacilik Ticaret Limited Sirketi kundër Sllovenisë*, § 48 - konfiskimi i përhershëm i maunës së kompanisë të shfrytëzuar nga një palë e tretë për trafikim të narkotikëve; *Yaşar kundër Rumanisë*, § 49 – konfiskimi i përhershëm i anijes së parashtresit të kërkesës i shfrytëzuar nga një person i tretë për peshkim të jashtëligjshëm).

90. Edhe masat e konfiskimit preventiv të shqiptuara në mungesë të dënimit penal si të tilla nuk përbëjnë shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. Funksionimi i prezumimit se prona e një personi të dyshuar se i përket një organizate kriminale përbën fitim nga aktivitetet joligjore, nëse procedurat relevante i ofrojnë

pronarit një mundësi të arsyeshme për ta vënë rastin në shqyrtim të autoriteteve, nuk është i ndaluar si i tillë, veçanërisht nëse gjykatat përmbahen nga bazimi i vendimeve të tyre thjeshtë në dyshime (*Arcuri dhe të tjerët kundër Italisë* (vendim)).

c. Rregulli i përgjithshëm

91. Rregulli i parë është i natyrës së përgjithshme. Nëse ndërhyrja në të drejtat pronësore nuk mund të kualifikohet nën rregullin e dytë ose të tretë, aplikohet rregulli i parë (e ashtuquajtur formula “gjithëkapëse”)

92. Në rastin *Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë*, §§ 64-65, Gjykata konstatoi se lejet e shpronësimit ishin hapi i parë në një procedurë që shpinte në privim të “pronës” dhe i ekzaminoi ato nën prizmin e fjalisë së parë të paragrafit të parë.

93. Në rastin *Stran Greek Refineries dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë*, §§ 62 dhe 68, Gjykata ekzaminoi ndërhyrjen legislative duke shpallur vendimin e arbitrazhit të pavlefshëm dhe pazbatueshëm në bazë të rregullit të përgjithshëm dhe gjeti shkelje të të drejtave pronësore të parashtruesit të kërkesës.

94. Rasti *Loizidou kundër Turqisë* (§§ 61-64) kishte të bëjë me qasjen e parashtruesit të kërkesës në pronën e vet në Qipron Veriore. Gjykata konstatoi se ankesa e parashtruesit të kërkesës nuk ishte e kufizuar vetëm në të drejtën e lirisë së lëvizjes dhe se Neni 1 i Protokollit Nr. 1 gjithashtu duhej zbatuar. Parashtruesi i kërkesës mbeti pronar ligjor i tokës. Mohimi i vazhdueshëm i qasjes nga forcat turke u konsiderua si ndërhyrje dhe shkelje e të drejtës së parashtruesit të kërkesës në pronë sipas rregullit të përgjithshëm.

95. Masat si procedurat e komasacionit (*Prötsch kundër Austrisë*, § 42), politikat e planifikimit urban (*Phocas kundër Francës*, § 52), dëbimit administrativ (*Iatridis kundër Greqisë* [GC], § 55), miratimit të planit të shfrytëzimit të tokës (*Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë*, § 40), dhe masat e planifikimit apo ngrirjes së ndërtimit mbi pronat e parashtruesve të kërkesave (*Pialopoulos dhe të tjerët kundër Greqisë*, § 56) janë ekzaminuar nën prizmin e primit të përgjithshëm.

2. Parimi i ligjshmërisë

96. Çdo ndërhyrje mbi të drejtat e mbrojtura nga Neni 1 i Protokollit Nr. 1 duhet të plotësojë kushtin e ligjshmërisë (*Vistiņš dhe Perepjolkins kundër Letonisë* [GC], § 95; *Béláné Nagy kundër Hungarisë* [GC], § 112). Faza “në bazë të kushteve të përcaktuara me ligj” që ndërlidhet me të gjitha ndërhyrjet mbi të drejtën e gëzimit paqësor të “pronave” duhet të interpretohet në të njëjtën mënyrë si fraza “në pajtim me ligjin” në Nenin 8 me të cilin rregullohet ndërhyrja mbi të drejtat e mbrojtura me këtë dispozitë apo të “përkshuara në ligj” në rast të ndërhyrjeve mbi të drejtat e mbrojtura me nenet 9, 10 dhe 11 të Konventës.

97. Parimi i ligjshmërisë përbën kërkesën e parë dhe më të rëndësishme të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Fjala e dytë e paragrafit të parë autorizon privimin e “pronës” në “bazë të kushteve të përcaktuara me ligj” ndërsa paragrafi i dytë ua njeh Shteteve të drejtën e kontrollimit të shfrytëzimit të pronave përmes zbatimit të “ligjeve”. Për më tepër, sundimi i ligjit, si një nga parimet themelore të çdo shoqërie demokratike, është i mishëruar në të gjitha nenet e Konventës (*Iatridis kundër Greqisë* [GC], § 58; *Ish-Mbreti i Greqisë dhe të tjerët kundër Greqisë* [GC], § 79; *Broniowski kundër Polonisë* [GC], § 147).

98. Ekzistimi i bazës ligjore në të drejtën vendore nuk mjafton si i tillë për të arrirë parimin e ligjshmërisë. Përveç kësaj, baza ligjore duhet të jetë e një cilësie të caktuar, do të thotë të jetë në pajtim me sundimin e ligjit dhe të ofrojë garanci kundër arbitraritetit. Në lidhje me këtë duhet të theksohet se kur flitet për “ligj”, Neni 1 i Paragrafit Nr. 1 i aludon të njëjtit koncept të cilit Konventa i referohet vendeve tjera kurdo që shfrytëzon këtë term, një koncepti që përfshin ligjet e shkruara dhe praktikën ligjore (*Špaček, s.r.o., kundër Republikës Çeke*, § 54; *Vistiņš dhe Perepjolkins kundër Letonisë* [GC], § 96).

99. Kushti i “ligjshmërisë” brenda kuptimit të Konventës gjithashtu kërkon pajtueshmëri me sundimin e ligjit që përfshin mbrojtjen nga arbitrariteti (*East West Alliance Limited kundër Ukrainës*, § 167; *Ünspeid*

Paket Servisi SaN. Ve TiC. A.Ş. kundër Bullgarisë, § 37). Divergjencat në praktikë juridike mund të krijojnë pasiguri juridike, e cila nuk është në përputhshmëri me kërkesat e sundimit të ligjit (*Molla Sali kundër Greqisë* [GC], § 153).

100. Parimi i ligjshmërisë gjithashtu parasupozon se dispozitat e zbatueshme të së drejtës kombëtare janë mjaftueshëm të qasshme, precize dhe të parashikueshme në aplikim (*Beyeler kundër Italisë* [GC], § 109; *Hentrich kundër Francës*, § 42; *Lithgow dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 110; *Ališić dhe të tjerët kundër Bosnjë e Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* [GC], § 103; *Centro Europa 7 S.R.L. dhe di Stefano kundër Italisë* [GC], § 187; *Hutten-Czapska kundër Polonisë* [GC], § 163).

101. Sa i përket qasshmërisë në ligj, nocioni “ligj” duhet të kuptohet në formë substanciale dhe jo në atë formale. Prandaj, fakti që disa rregullore të caktuara që prekin ushtrimin e të drejtave të mbrojtura me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 nuk ishin publikuar në gazetata zyrtare në formën e përshtuar me ligjet për shpalljen e instrumenteve legjislative apo rregullative që janë obligative për qytetarët dhe subjektet juridike në përgjithësi nuk ua pamundësojnë rregulloreve në fjalë që të konsiderohen si ligj i zbatueshëm nëse Gjykata bindet se ato i janë bërë të ditura opinionit publik në forma tjera (*Špaček, s.r.o., kundër Republikës Çeke*, §§ 57-60).

102. Norma është e “parashikueshme” kur ofron masë të mbrojtjes nga ndërhyrjet arbitrare të autoriteteve publike (*Centro Europa 7 S.r.l. dhe Di Stefano kundër Italisë* [GC], § 143). Çdo ndërhyrje ndaj gëzimit paqësor të pronave duhet të përcillet me garanci procedurale të cilat i ofrojnë individit apo subjektit në fjalë mundësi të arsyeshme për ta parashtruar rastin e tyre tek autoritetet përgjegjëse me qëllim që të sfidojnë masat ndërhyrëse ndaj të drejtave të tyre të garantuara me këtë dispozitë. Gjatë vlerësimit nëse kushtet janë plotësuar, duhet të merren në parasysh në formë gjithëpërfshirëse të gjitha procedurat e zbatueshme gjyqësore dhe administrative (*Lekić kundër Sllovenisë* [GC], § 95; *Jokela kundër Finlandës*, § 45; *Capital Bank AD kundër Bullgarisë*, § 134; dhe *Stolyarova kundër Rusisë*, § 43). Një ligj mund të plotësojë kushtet e parashikueshmërisë edhe nëse personi në fjalë duhet të marrë këshilla ligjore adekuate për të vlerësuar pasojat që mund t’i bartë çdo veprim i caktuar. Kjo është në veçanti e saktë kur kemi të bëjmë me persona që kryejnë një veprimtari profesionale apo komerciale të cilët janë të mësuar të veprojnë me dozë të lartë kujdesi gjatë ushtrimit të profesionit të tyre. Në këto situata, ata mund të pritët të ushtrojnë kujdes të veçantë gjatë vlerësimit të rreziqeve që veprimtaria e tillë ngërthen (*Lekić kundër Sllovenisë* [GC], § 97).

103. Në kontekst të Nenit 6 të Konventës, parimi i sundimit të ligjit dhe nocioni i gjykimit të drejtë parandalojnë, përveç rasteve që janë qartë në interes publik, ndërhyrjen apo ndikimin e legjislaturës mbi vlerësimin gjyqësor të një kontesti (*Stran Greek Refineries dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë*, § 49; *National & Provincial Building Society, Leeds Permanent Building Society dhe Yorkshire Building Society kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 112; *Zielinski dhe Pradal dhe Gonzalez dhe të tjerët kundër Francës* [GC], § 57; *Azienda Agricola Silverfunghi S.a.s. dhe të tjerët kundër Italisë*, § 76). Megjithatë, kur ekzaminohen nën prizmin e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, ligjet me efekt retrospektiv të cilët janë konsideruar se përbëjnë ndërhyrje legjislative u janë përmbajtur kërkesave të ligjshmërisë sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (*Maggio dhe të tjerët kundër Italisë*, § 60, *Arras dhe të tjerët kundër Italisë*, § 81; *Azienda Agricola Silverfunghi S.a.s. dhe të tjerët kundër Italisë*, § 104). Masat e kontrollit të shfrytëzimit që janë zbatuar në bazë të ligjeve të nxjerra pas fakteve që kanë nxitur shfaqjen e ndërhyrjes nuk janë si të tilla të paligjshme (*Saliba kundër Maltës*, §§ 39-40), nëse këto ligje nuk janë nxjerrë specifikisht me qëllim të ndikimit në rezultatin e një rasti individual. As Konventa e as protokollet e veta nuk ia ndalojnë legjislaturës ndërhyrjen mbi kontratat ekzistuese me efekt retroaktiv (*Mellacher dhe të tjerët kundër Austrisë*, § 50; *Bäck kundër Finlandës*, § 68).

104. Megjithatë, në disa rrethana, aplikimi retrospektiv i legjislacionit efektet e së cilit janë që ta privojnë dikë nga një “pasuri” paraekzistuese që ka qenë pjesë e “pronave” të tij apo saj mund të përbëjë ndërhyrje që çrregullon balancin e drejtë mes kërkesave të interesit të përgjithshëm në njërën anë dhe mbrojtjes së të drejtës për gëzim paqësor të “pronave” në anën tjetër (*Maurice kundër Francës* [GC], §§ 90 dhe 93). Kjo është e zbatueshme gjithashtu në rastet në të cilat kontesti zhvillohet mes individëve

privatë dhe në të cilat Shteti nuk është vet palë në procedurë (*Kamoy Radyo Televizyon Yayincilik ve Organizasyon A.S. kundër Turqisë*, § 40).

105. Parimi i ligjshmërisë gjithashtu nënkupton obligimin e Shtetit apo autoritetit publik tjetër që t'u përmbahet urdhrave gjyqësorë apo vendimeve kundër tyre (*Belvedere Alberghiera S.r.l. kundër Italisë*, § 56; shih kapitullin mbi Procedurat përmbartuese më poshtë).

3. Interesi publik ose i përgjithshëm

106. Çdo ndërhyrje nga një autoritet publik në gëzimin paqësor të “pronave” mund të justifikohet vetëm nëse i shërben një interes publik (ose të përgjithshëm) legjitim (*Bélané Nagy kundër Hungarisë* [GC], § 113; (*Lekić kundër Sllovenisë* [GC], § 105).

107. Qëllimet në vijim janë konsideruar nga Gjykata se bien nën nocionin e interesit publik brenda kuptimit të kësaj dispozite: eliminimi i padrejtësive sociale në sektorin e banimit (*James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 45); nacionalizimi i industrive specifike (*Lithgow dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, §§ 9 dhe 109); miratimi i planeve zhvillimore të tokës dhe qyteteve (*Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë*, § 69); *Cooperativa La Laurentina kundër Italisë*, § 94; sigurimi i tokës për implementimin e planeve zhvillimore lokale (*Skibińscy kundër Polonisë*, § 86); parandalimi i evazionit tatimor (*Hentrich kundër Francës*, § 39); masat për luftimin e trafikimit dhe kontrabandimit të narkotikëve (*Butler kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim); masat për kufizimin e konsumit të alkoolit (*Tre Traktörer AB kundër Suedisë*, § 62); mbrojtja e moralit (*Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 62); kontrolli i origjinës legjitime të veturave të vëna në qarkullim (*Sildedzis kundër Polonisë*, § 50); konfiskimi i parave të fituara në mënyrë të paligjshme (*Honecker dhe të tjerët kundër Gjermanisë* (vendim); tranzicioni nga ekonomia socialiste në atë të tregut të lirë (*Lekić kundër Sllovenisë* [GC], §§ 103 dhe 105); dhe operimi i papenguar i sistemit të drejtësisë, me referenca të mëtejme ndaj rëndësisë së administrimit të drejtësisë pa vonesa që mund të rrezikojnë efektivitetin dhe kredibilitetin e saj (*Konstantin Stefanov kundër Bullgarisë*, § 64).

108. Mbrojtja e mjedisit gjithashtu konsiderohet se është në interes publik (*G.I.E.M. S.R.L. dhe të tjerët kundër Italisë* (merita) [GC], § 295; *Bahia Nova S.A. kundër Spanjës* (vendim); *Chapman kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], § 82). Në rastin *Hamer kundër Belgjikës* (§ 79) Gjykata theksoi se përderisa asnjë nen i Konventës nuk është specifikisht i dizajnuar për të ofruar mbrojtje të mjedisit si i tillë (*Kyrtatos kundër Greqisë*, § 52), “në shoqërinë e sotme, mbrojtja e mjedisit paraqet një çështje çdo herë e më të rëndësishme” dhe “faktorët ekonomikë e madje edhe disa të drejta themelore siç janë e drejta në pronë nuk duhet të konsiderohen më të rëndësishme se sa mbrojtja e mjedisit, në veçanti kur shtetet kanë miratuar legjislacion që rregullon këtë.” Në fund, është konsideruar se zhvillimi projekteve banesore, edhe për qëllime komerciale private edhe në interes publik, nuk ngërthen nivel të interesit publik të cilin e gëzon mbrojtja e mjedisit (*Svitlana Ilchenko kundër Ukrainës*, § 70).

109. Rasti *S.A. Bio d'Ardennes kundër Belgjikës*, §§ 55-57, kishte të bëjë me therjen e detyruar të një numri të madh të kafshëve të infektuara me brucelozë dhe Gjykata theksoi rëndësinë që ka parandalimi i sëmundjeve të kafshëve nga Shteti dhe margjina e vlerësimit që atyre u përket në këtë drejtim.

110. Korrigjimi i gabimeve të bëra nga Shtetet në kontekst të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 gjithashtu bën pjesë nën nocionin e interesit publik (*Albergas dhe Arlauskas kundër Lituanisë*, § 57; *Pyramtjen kundër Lituanisë*, §§ 44-48; *Bečvář dhe Bečvářová kundër Republikës Çeke*, § 67); përfshirë situatat kur beneficinet e sigurimit sociale janë përfituar në mënyrë të vlefshme nga individë në bazë të vendimeve individuale të cilat më pas u vërtetua të jenë të gabueshme (*Moskal kundër Polonisë*, § 63). Më gjerësisht, ndërprerja e përfitimeve pensionale të konsideruara si të panevojshme apo të fituara në mënyrë të padrejtë, përmes ndërhyrjeve legjislative me qëllim të sigurimit të një niveli më të lartë të drejtësisë në sistemin pensional (*Cichopek dhe të tjerët kundër Polonisë* (vendim), § 144) gjithashtu është konsideruar veprim në interes publik.

111. Masa të ndryshme rregullative të aplikuara nga Shteti në fushën e banimit, siç janë kontrolli i qirasë apo qiramarrjet e mbrojtura, shpesh janë pranuar nga Gjykata si masa në interes publik që u

shërbejnë mbrojtjes sociale të qirambajtësve (*Anthony Aquilina kundër Maltës*, § 57; *Velosa Barreto kundër Portugalisë*, § 25; *Hutten-Czapska kundër Polonisë* [GC], § 178; *Amato Gauci kundër Maltës*, § 55).

112. Ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe, kurdo që është i mundshëm, shfrytëzimi i qëndrueshëm i saj, kanë për qëllim ruajtjen e rrënjëve historike, kulturore dhe artistike të një rajoni dhe banorëve të saj, përveç ruajtjes së një cilësie të caktuar të jetesës. Prandaj, ajo përbën vlerë thelbësore, mbrojtja dhe promovimi i së cilës janë barrë e autoriteteve publike (*Beyeler kundër Italisë* [GC], § 112; *SCEA Ferme de Fresnoy kundër Francës* (vendim); *Debelianovi kundër Bullgarisë*, § 54; *Kozacioğlu kundër Turqisë* [GC], § 54).

113. Lista e qëllimeve për të cilat ndërhyrja mund të konsiderohet se i shërben interesit publik është e gjerë dhe mund të përfshijë qëllime të ndryshme të cilat trajtohen nga politikat publike në kontekste të ndryshme faktike. Në veçanti kjo përfshin vendimet për nxjerrjen e ligjeve për shpronësimin e pronave (*Ish-Mbreti i Greqisë dhe të tjerët kundër Greqisë* [GC], § 87; *Vistiņš dhe Perepjolkins kundër Letonisë* [GC], § 106) ose që kanë të bëjnë me beneficione të sigurimit social e të cilat shpesh ngërthejnë shumë aspekte politike, ekonomike e sociale. Gjykata do të respektojë gjykimin e legjislaturës lidhur me çfarë bie nën domenin e “interesit publik” përveç nëse aktgjykimi është në mënyrë evidente pa bazë të arsyeshme (*Béláné Nagy v. Hungarisë* [GC], § 113).

114. Nën sistemin e mbrojtjes që është themeluar nga Konventa, u mbetet autoriteteve nacionale që të bëjnë vlerësimin fillestar lidhur me ekzistimin e një problemi që përbën brengë publike e për të cilin duhet ndërmarrë pasha të privimit të pronës ose ndërhyrjes në gëzimin paqësor të “pronave”. Këtu, siç ndodhë në fushat tjera të cilat i mbron Konventa, autoritetet nacionale gëzojnë një margjinë të gjerë të vlerësimit. Për shembull, margjina e vlerësimit që është në dispozicion të legjislaturës gjatë implementimit të politikave sociale dhe ekonomike do të jetë e gjerë dhe Gjykata do të respektojë gjykimin e legjislaturës nacionale lidhur me atë që është “në interes publik” përveç nëse ai është në mënyrë evidente pa bazë të arsyeshme (*Béláné Nagy kundër Hungarisë* [GC], § 113). Për më tepër, nocioni i “interesit publik” është domosdoshmërisht i gjerë (*Vistiņš dhe Perepjolkins kundër Letonisë* [GC], § 106; *R.Sz. kundër Hungarisë*, § 44; *Grudić kundër Serbisë*, § 75). Gjykata normalisht tregon respekt për argumentet e Shteteve Kontraktuese se ndërhyrja që shqyrtohet ka qenë në interes publik dhe intensiteti i rishqyrtimit që ia bën kësaj çështjeje është i ulët. Prandaj, argumenti i parashtruesit të kërkesës që një masë e caktuar i ka shërbyer në realitet një qëllimi tjetër e jo atij të pretenduar nga Pala Kontraktuese në kontekst të rastit të paraqitur para Gjykatës shumë rrallë ka gjasa të të qenit i suksesshëm. Sidoqoftë, mjafton për Gjykatën që ndërhyrja t’i ketë shërbyer interesit publik, edhe nëse ai është tjetër nga interesi publik i përcaktuar nga Qeveria në procedurën para Gjykatës. Në disa raste, Gjykata madje vetë e identifikon qëllimin e mocionit të vet (*Ambruosi kundër Italisë*, § 28; *Marija Božić kundër Kroacisë*, § 58).

115. Margjina e vlerësimit do të jetë veçanërisht e gjerë kur, për shembull, ligjet miratohen në kontekst të ndryshimit të regjimit politik dhe ekonomik (*Valkov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, § 91); politikat miratohen për të mbrojtur arkën publike (*N.K.M. kundër Hungarisë*, §§ 49 dhe 61); ose fondet rialokohen (*Savickas dhe të tjerët kundër Lituanisë* (vendim)); ose në kontekst të masave të kursimit të nxitura nga një krizë ekonomike madhore (*Koufaki dhe Adedy kundër Greqisë* (vendim), §§ 37 dhe 39; dhe *Da Conceição Mateus dhe Santos Januário kundër Portugalisë* (vendim), § 22; *Da Silva Carvalho Rico kundër Portugalisë* (vendim), § 37).

116. Si rezultat i këtij respektimi të vlerësimit të autoriteteve vendore, shembujt kur Gjykata nuk ka gjetur interes publik që justifikon ndërhyrjen janë të rrallë (*S.A. Dangeville kundër Francës*, §§ 47 dhe 53-58 – dështimi për t’i kompensuar mbipagesën tatimore; *Rosenzweig dhe Bonded Warehouses Ltd. kundër Polonisë*, § 56) – anulimi i licencës për veprimtarinë afariste të parashtruesit të kërkesës pa përcaktim të interesit publik në vendimet relevante të autoriteteve; *Vassallo kundër Maltës*, § 43 – kalimi i njëzetetete viteve nga data e marrjes së pronës pa e shfrytëzuar fare për qëllimin për të cilin është marrë fillimisht që ngritë çështje nën prizmin e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 në kuptim të domosdoshmërisë së interesit publik; dhe *Megadat.com SRL kundër Moldavisë*, § 79 – ku Gjykata nuk është bindur se autoritetet kanë ndjekur një politikë origjinale dhe konsistente gjatë shpalljes së licencës së kompanisë së parashtruesit të kërkesës si të pavlefshme).

4. Proporcionaliteti dhe çështjet e ndërlidhura (balanci i drejtë, kompensimi, margjina e vlerësimit)

117. Për të qenë në pajtim me rregullin e përgjithshëm të përcaktuar në fjalinë e parë të paragrafit të parë të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, ndërhyrja në të drejtën e gëzimit paqësor të “pronave”, përveç që duhet të jetë e përshkruar në ligj dhe në interes publik, duhet të rezultojë me “balanc të drejtë” mes kërkesave të interesit publik të komunitetit dhe kërkesave për të mbrojtur të drejtat themelore të individit (*Beyeler kundër Italisë* [GC], § 107; *Ališić dhe të tjerët kundër Bosnjë e Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* [GC], § 108).

118. Me fjalë tjera, në rastet që përfshijnë shkelje të pretenduar të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, Gjykata duhet të vlerësojë nëse për arsye të veprimit apo mosveprimit të Shtetit personi në fjalë është dashur të bartë një barrë joproporcionale dhe të tepërt. Gjatë vlerësimit të pajtueshmërisë me këtë kërkesë, Gjykata duhet të bëjë një ekzaminim të gjithmbarshëm të interesave të ndryshëm në këtë çështje, duke mbajtur në mend se Konventa ka për qëllim të mbrojë të drejtat të cilat janë “praktike dhe efektive”. Në këtë kontekst, duhet theksuar se pasiguria, qoftë legjislative, administrative apo që lind nga praktikat e aplikuara nga autoritetet, është faktor që merret parasysh gjatë vlerësimit të sjelljes së një Shteti (*Broniowski kundër Polonisë* [GC], § 151).

119. Kërkimi i këtij balanci është i mishëruar në tërë Konventën dhe gjithashtu reflektohet në strukturën e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (*Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë*, § 69; *Brumărescu kundër Rumanisë* [GC], § 78; *Saliba kundër Maltës*, § 36; *Bistrović kundër Kroacisë*, § 34).

120. Çështja nëse balanci i drejtë është gjetur bëhet relevante vetëm pasi të jetë konstatuar se ndërhyrja në fjalë i ka shërbyer interesit publik, e ka plotësuar kërkesën e ligjshmërisë dhe nuk ka qenë arbitrare (*Iatridis kundër Greqisë* [GC], § 58; *Beyeler kundër Italisë* [GC], § 107).

121. Kjo çështje është më së shpeshti vendimtare për përcaktimin nëse ka pasur apo jo shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Gjykata zakonisht kryen një analizë të thellë të kërkesës së proporcionalitetit, jo sikur shqyrtimi shumë më i kufizuar i asaj nëse ndërhyrja ka ndodhur në kërkim të një interesi publik (shih kapitullin mbi Ndërhyrjen në interes publik, më lartë).

122. Qëllimi i testit të proporcionalitetit është të vërtetojë së pari si dhe deri në ç’masë parashtuesit të kërkesës i është kufizuar ushtrimi i të drejtave të prekura nga ndërhyrja e ankimuar dhe cilat ishin pasojat negative të kufizimit të imponuar mbi ushtrimin e të drejtës së parashtuesit të kërkesës në situatën e tij/saj. Si rrjedhojë, ky ndikim balanohet kundrejt rëndësisë së interesit publik të cilit ndërhyrja i ka shërbyer.

123. Gjatë këtij ekzaminimi, Gjykata merr parasysh faktorë të shumtë, megjithëse nuk ekziston një listë fikse e faktorëve në fjalë. Ata ndryshojnë nga rasti në rast, varësisht nga faktet e rastit dhe natyra e ndërhyrjes në fjalë.

124. Në përgjithësi, kur kemi të bëjmë me vlerësim të interesit publik, u mbetet autoriteteve publike që të veprojnë në kohë të duhur dhe në mënyrë të duhur dhe konsistente (*Fener Rum Erkek Lisesi Vakfı kundër Turqisë*, § 46; *Novoseletskiy kundër Ukrainës*, § 102). Gjykata merr parasysh sjelljen e palëve në procedurë në përgjithësi, përfshirë hapat e ndërmarrë nga Shtetet (*Beyeler kundër Italisë* [GC], § 114; *Bistrović kundër Kroacisë*, § 35).

125. Disa faktorë tipikë për testimin e balancit të drejtë në kontekst të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 janë shtjelluar në vijim.

a. Faktorët proceduralë

126. Edhe pse Neni 1 i Protokollit Nr. 1 nuk përmban kërkesa shprehimore procedurale, i njëjti është interpretuar se nënkupton që personat e prekur nga masa e cila ndërhyrja mbi “pronat” e tyre duhet të ketë mundësi të arsyeshme për ta trajtuar rastin e tyre para autoriteteve përgjegjëse me qëllim të sfidimit efektiv të masave në fjalë, duke pretenduar mungesën e ligjshmërisë apo sjelljen arbitrare dhe të paarsyeshme (*G.I.E.M. S.R.L. dhe të tjerët kundër Italisë* (merita) [GC], § 302; *Yildirim kundër Italisë* (vendim); *AGOSI kundër Mbretërisë së Bashkuar*, §§ 55 dhe 58-60; *Air Canada kundër Mbretërisë së*

Bashkuar, § 46; *Arcuri dhe të tjerët kundër Italisë* (vendim); *Riela dhe të tjerët kundër Italisë* (vendim)). Këto garanci procedurale janë të mishëruara në parimin e ligjshmërisë *Lekić kundër Sllovenisë* [GC], § 95) (shih nënkapitullin mbi parimin e ligjshmërisë më sipër).

127. Gjatë vlerësimit nëse ky kusht është përmbushur, Gjykata duhet të bëjë vlerësim gjithëpërfshirës të procedurave të zbatueshme (*AGOSI kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 55; *Bowler International Unit kundër Francës*, §§ 44-45; *Jokela kundër Finlandës*, § 45; *Denisova dhe Moiseyeva kundër Rusisë*, § 59; *Microintellect OOD kundër Bullgarisë*, § 44).

128. Në rastet kur parashtruesit e kërkesës nuk kanë pasur mundësi që efektivisht të sfidojnë masat, Gjykata ka konstatuar se ata kanë bartur barrë të tepruar (*Hentrich kundër Francës*, § 49; *Könyv-Tár Kft dhe të tjerët kundër Hungarisë*, § 59; dhe *Uzan dhe të tjerët kundër Turqisë*, § 215). Gjykata kontrollon nëse procedura e zbatuar i ka ofruar parashtruesit të kërkesës mundësi të drejtë për të mbrojtur interesat e vet (*Bäck kundër Finlandës*, § 63). Një shkelje është gjetur në refuzimin e një unioni kreditor që t'i japë qasje drejtorëve mbi dokumentet kontabile të unionit me çka do të bindeshin se i njëjti ishte financiarisht i qëndrueshëm (*Družstevni Záložna Pria dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, §§ 94-95). Është gjithashtu relevant fakti që argumentet e rëndësishme të paraqitura nga parashtruesit e kërkesave ishin ekzaminuar me kujdes nga autoritetet (*Megadat.com SRL kundër Moldavisë*, § 74; *Novoseletskiy kundër Ukrainës*, § 111; *Bistrović kundër Kroacisë*, § 37). Funkcionimi i parasupozimeve të pasfidueshme të përfitimeve që rezultojnë nga shpronësimi (*Papachelas kundër Greqisë* [GC], §§ 53-54), dhe parasupozimeve të shfrytëzuara në kontekst të kalkulimit të shpronësimit (*Katikaridis dhe të tjerët kundër Greqisë*, § 49; *Efstathiou dhe Michailidis & Co. Motel Amerika kundër Greqisë*, § 33) ishin shfrytëzuar si argumente kundër Qeverive.

129. Dështimi i autoriteteve për të balancuar mes interesave privatë të përshtirë në rast dhe interesit publik mund të shfrytëzohet gjithashtu si argument kundër Qeverive (*Megadat.com SRL kundër Moldavisë*, § 74). Shkelja ishte konstatuar në një rast ku të gjitha kursimet jetësore të grumbulluara gjatë punësimit ishin konfiskuar nga një person që kishte fituar të drejtën e punësimit duke shfrytëzuar një pasaportë të falsifikuar. Gjykatat vendore nuk kishin ekzaminuar nëse urdhri i konfiskimit kishte ruajtur balancin e drejtë mes të drejtave pronësore dhe interesit publik. Rrjedhimisht, dështimi i gjykatës vendore që të kryejë analizën e proporcionalitetit mund të rezultojë me shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (*Paulet kundër Mbretërisë së Bashkuar*, §§ 68-69). Ngjashëm, një masë automatike, e përgjithshme dhe jofleksibile me kohëzgjatje të papërcaktuar qartë mund të konsiderohet shkelje (*Uzan dhe të tjerët kundër Turqisë*, § 193).

130. Kohëzgjatja e sfidimit të masave që kufizojnë të drejtat e parashtruesit të kërkesës gjithashtu merret parasysh. Për shembull, në rastin *Luordo kundër Italisë*, § 70, nuk kishte justifikim për kufizimin e të drejtave të parashtruesit të kërkesës për tërë kohëzgjatjen e procesit të falimentimit. Përderisa në parim është e domosdoshme që i falimentuari të privohet nga e drejta për të administruar “pronat” e veta me qëllim të arritjes së qëllimit të këtyre procedurave, domosdoshmëria e kësaj do zvogëlohet me kalimin e kohës dhe me tejzgjatjen e procedurave të falimentimit. Në rastin *Uzan dhe të tjerët kundër Turqisë*, § 207, një nga faktorët e konsideruar si relevantë nga Gjykata ishte që kufizimet relevante mbi pronën e parashtruesit të kërkesës kishin zgjatur 10 apo më shumë vite.

b. Përzgjedhja e masave

131. Një nga elementet e testit të balancit të drejtë është të vlerësohet nëse autoritetet publike gjatë ndjekjes së interesit publik kanë mundur të shfrytëzojnë masa më pak ndërhyrëse. Megjithatë, ekzistimi i mundshëm i masave të tilla si i tillë nuk e bën të pajustificueshëm legjislacionin e kontestuar. Me kusht që legjislatura të qëndrojë brenda kornizave të veta të margjinës së vlerësimit, nuk është në domenin e Gjykatës që të vlerësojë nëse legjislacioni ka përfaqësuar zgjidhjen më të mirë për të trajtuar problemin ose nëse diskrecioni i legjislaturës do duhej ushtruar në një mënyrë tjetër (*James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 51; *Koufaki dhe Adedy kundër Greqisë* (vendim), § 48).

132. Mund të jetë gjithashtu relevante të shihet nëse ka qenë e mundshme të arrihet i njëjti qëllim përmes masave më pak ndërhyrëse mbi të drejtat e parashtruesit të kërkesës dhe nëse autoritetet e

kanë ekzaminuar mundësinë e aplikimit të këtyre zgjidhjeve më pak ndërhyrëse (*OAQ Neftyanaya Kompaniya Yukos kundër Rusisë*, §§ 651-654; *Vaskrsić kundër Sllovenisë*, § 83).

133. Edhe kur Qeveria nuk ka dhënë arsye specifike lidhur me atë se përse masa e caktuar ka qenë e vetmja masë e duhur për arritjen e qëllimeve të dëshiruara sociale dhe ekonomike, pa marrë parasysh nëse i ka marrë parasysh seriozisht mjetet tjera për arritjen e qëllimeve dhe nëse e ka vlerësuar proporcionalitetin e masës me qëllimin e mëtuar, Gjykata ka qenë e gatshme që të pranojë se arsyeja e përzgjedhjes së masës mund të ketë qenë e nënkuptuar që nga fillimi (*Zelenchuk dhe Tsytsyura kundër Ukrainës*, § 122). Gjykata gjithashtu ka marrë parasysh faktin se asnjë shtet tjetër anëtar i Këshillit të Evropës, përfshirë ata në pozitë të ngjashme, nuk ka pasur në zbatim masa të ngjashme (*po aty.*, § 127).

c. Çështje substanciale relevante për testin e balancit të drejtë

134. Në disa raste, testi i balancit të drejtë përfshin pyetjen nëse rrethanat e posaçme të rastit janë marrë mjaftueshëm parasysh nga Shteti, përfshirë nëse shpronësimi i një pjese të pronës ka ndikuar në vlerën apo karakteristikat e pjesës së pa shpronësuar të pronës së parashtruesit të kërkesës (*Azas kundër Greqisë*, §§ 51-53; *Interoliva ABEE kundër Greqisë*, §§ 31-33). Dështimi për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje mund të rezultojë me shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, në rastet kur natyra e ndërtimit në afërsi të pronës së parashtruesit të kërkesës i ka kontribuar në mënyrë evidente dhe drejtpërsëdrejti amortizimit substancial të vlerës së pronës së mbetur, për shembull, kur rrugët publike apo godina tjera janë ndërtuar në afërsi të tokës së mbetur (*Ouzounoglou kundër Greqisë*, § 30; *Bistrović kundër Kroacisë*, §§ 42-44).

135. Aplikimi i një supozimi të pafuzueshëm se vlera e pronës së mbetur të parashtruesit të kërkesës është shtuar si rezultat i shpronësimit dhe se parashtruesi i kërkesës ka përfituar nga ai është shfrytëzuar si argument kundër Shtetit në kontekst të ekzaminimit të proporcionalitetit (*Papachelas kundër Greqisë* [GC], §§ 53-54).

136. Gjatë vlerësimit të proporcionalitetit të një ndërhyrjeje mbi të drejtat e parashtruesit të kërkesës për gëzim paqësor të “pronave” gjendja e pasigurisë në të cilën parashtruesi i kërkesës mund të gjendet si rezultat i vonësive që i atribuohen autoriteteve është faktor që duhet marrë parasysh gjatë vlerësimit të sjelljes së Shtetit në procedurë (*Almeida Garrett, Mascarenhas Falcão dhe të tjerët kundër Portugalisë*, § 54; *Broniowski kundër Polonisë* [GC], §§ 151 dhe 185; *Barcza dhe të tjerët kundër Hungarisë*, § 47; *Frendo Randon dhe të tjerët kundër Maltës*, § 55; *Hunguest Zrt kundër Hungarisë*, §§ 25 dhe 27; *Zelenchuk dhe Tsytsyura kundër Ukrainës*, §§ 91 dhe 106).

137. Në rastet kur ndërhyrja nuk ka përbërë shpronësim, Gjykata gjithashtu do të ekzaminojë nëse ligjet kanë lejuar ndonjë formë të ankimit për ndërhyrjet që kanë zgjatur një periudhë të caktuar kohore (*a contrario*, *Skibiński kundër Polonisë*, §§ 93-95); nëse ndërhyrja ka qenë ndaluese ose represive (*Allianz-Slovenska-Poistovna, A.S. dhe të tjerët kundër Sllovakisë* (vendim); *Konstantin Stefanov kundër Bullgarisë*, § 67); nëse Shteti i është dhënë trajtim më preferencial në kontekst të procedurave civile, duke e vënë individin në disavantazh (*Zouboulidis kundër Greqisë (no. 2)*, §§ 32 dhe 35) – shkelje si rrjedhojë e periudhës më të shkurtër të përshkrimit në favor të Shtetit); nëse vlera e pronës është përcaktuar nën të njëjtat rregulla për qëllime tatimore dhe për qëllime të kompensimit të shpronësimit që duhet paguar nga Shteti (*Jokela kundër Finlandës*, §§ 62 dhe 65 – shkelje si rrjedhojë e përcaktimit të një norme shumë më të lartë për qëllime tatimore se sa për qëllime të shpronësimit).

138. Karakteri i përkohshëm i masave të ankimit zakonisht shkon në avantazh të Shtetit (*Da Conceição Mateus dhe Santos Januário kundër Portugalisë* (vendim), § 29; *Savickas dhe të tjerët kundër Lituanisë* (vendim), § 92).

139. Kur një ndërhyrje me të drejtën e gëzimit paqësor të “pronës” është shkaktuar në kontekst të përmirësimit të një gabimi të bërë nga autoritetet publike (i cili, siç është theksuar më parë, i shërben interesit publik), parimi i qeverisjes së mirë mund t'ua imponojë autoriteteve jo vetëm obligimin për të vepruar shpejt në korrigjimin e gabimit (*Moskal kundër Polonisë*, § 69; *Paplauskienė kundër Lituanisë*, § 49), në formë të duhur dhe me konsistencë maksimale (*Beyeler kundër Italisë* [GC], § 120; *Romeva kundër Maqedonisë së Veriut*, § 58), por gabimet e tilla nuk mund të korrigojnë në dëm të individit të prekur, veçanërisht kur nuk ka ndonjë interes tjetër privat në ekuacion (*Gashi kundër Kroacisë*, § 40; *Gladysheva*

kundër Ruisë, § 80; *Pyrantienë kundër Lituanisë*, § 70; *Moskal kundër Polonisë*, § 73; *Albergas dhe Arlauskas kundër Lituanisë*, § 74; *S.C. Antares Transport S.A dhe S.C. Transroby S.R.L. kundër Rumanisë*, § 48).

d. Aspekte të ndërlidhura me parashtruesin e kërkesës

140. Një nga faktorët më të rëndësishëm për testin e balancimit sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 është të shihet nëse parashtruesi i kërkesës është përpjekur që të shfrytëzojë ndonjë dobësi apo boshllëk në sistem (*National & Provincial Building Society, Leeds Permanent Building Society dhe Yorkshire Building Society kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 109; *OGIS-Institut Stanislas, OGEC Saint-Pie X dhe Blanche de Castille dhe të tjerët kundër Francës*, §§ 69 dhe 71). Ngjashëm, në rastin *G.I.E.M. S.R.L. dhe të tjerët kundër Italisë* (merita) [GC], § 301, Gjykata ka theksuar se shkalla e fajësisë apo neglizhencës së parashtruesit të kërkesës ose, së paku, marrëdhënia mes sjelljes së tyre dhe shkeljes në fjalë, mund të merret parasysh me qëllim të vlerësimit nëse konfiskimi ishte adekuat. Kualifikimi i një personi si kontabilist ishte një nga arsyet vendimtare për të vendosur se rimbursimi i kontributeve shtesë pa interes ishte proporcional (*Taşkaya kundër Turqisë* (vendim), §§ 49-50). Në disa raste, cenueshmëria personale e parashtruesit të kërkesës gjithashtu merret parasysh, si në rastin *Pyrantienë kundër Lituanisë*, § 62, në të cilin parashtruesi i kërkesës ishte në moshën e pensionimit dhe vuante nga paaftësia afatgjatë. Një obligim i imponuar mbi parashtruesin e kërkesës për t'i paguar beneficionet e marra në bazë të një vendimi administrativ, në mirëbesim dhe në rastet kur autoritetet kanë bërë gabim, nuk janë marrë parasysh për shëndetin dhe situatën financiare të saj, është konsideruar të jetë joproporcional (*Čakarević kundër Kroacisë*, §§ 82-90).

141. Gjykata gjithashtu mund të ekzaminojë nëse masa e ankimuar ka pasur për cak vetëm një grup individësh të cilët janë identifikuar apo ka qenë e zbatueshme në përgjithësi (*Hentrich kundër Francës*, § 47; *R.Sz. kundër Hungarisë*, § 60).

142. Është gjithashtu relevante të shihet nëse parashtruesi i kërkesës mund të ketë qenë arsyeshëm në dijeni për kufizimet ligjore mbi pronën e tij në situata kur atij i është pamundësuar, për shembull, ndërtimi i një shtëpie tjetër në pronën e tij apo ndryshimi i destinimit të saj, ose ka humbur “pronat” (*Allan Jacobsson kundër Suedisë (nr. 1)*, §§ 60-61; *Z.A.N.T.E. – Marathonisi A.E. kundër Greqisë*, § 53; dhe *Depalle kundër Francës* [GC], § 86 – për qëllime të përcaktimit nëse të drejtat e parashtruesit të kërkesës janë mbrojtur) dhe, në veçanti, nëse ia ka qenë i vetëdijshëm për kufizimet kur e ka blerë pronën në fjalë. Në disa raste, Gjykata ka pranuar mungesën e plotë të kompensimit kur pronari ka ditur ose është dashur të dijë ose ka arsye për të menduar se ai është dashur të dijë se ekziston mundësia për kufizime në të ardhmen. Në rastin *Fredin kundër Suedisë (nr. 1)*; §§ 12, 16 dhe 54, ligji mjedisor përcaktonte revokimin e licencave të mihjes pa kompensim pas skadimit të afatit prej dhjetë vitesh. Ajo veç kishte qenë në fuqi disa vite kur parashtruesi i kërkesës kishte filluar investimin. Në rastin *Łqcz kundër Polonisë* (vendim), fragmente të planit zhvillimor lokal lidhur me ndërtimin e rrugës i ishin bashkëngjitur kontratës së shitjes. Prandaj, Gjykata konkludoi se parashtruesit e kërkesës e kanë marrë pronën duke qenë tërësisht të vetëdijshëm për statusin juridik të saj dhe në rrethana të tilla Shteti nuk mund të konsiderohet përgjegjës për vështirësitë financiare të cilat janë hasur gjatë shitjes së pronës. E njëjta qasje është aplikuar edhe në kontekst të sigurimit social (*Mauriello kundër Italisë* (vendim)).

143. Në rastin *Uzan dhe të tjerët kundër Turqisë*, § 212, Gjykata mungesën e dëshmive e konsideroi si fakt që sugjeron sugjeruar se parashtruesit e kërkesës mund të kenë qenë të përfshirë në mashtrim.

e. Kompensimi për ndërhyrje si element i balancit të drejtë

144. Kushtet e kompensimit janë të rëndësishme materiale për vlerësimin e balancit të drejtë dhe vlerësimin nëse masa e kontestuar u imponon parashtruesve të kërkesës barrë joproporcionale (*Manastiret e shenjta kundër Greqisë*, § 71; *Platakou kundër Greqisë*, § 55). Megjithatë, rëndësia e kompensimit varet nga vlerësimi i Gjykatës varësisht nga rregullat e zbatueshme dhe të ankimuara.

145. Marrja e pronave në bazë të fjalisë së dytë të paragrafit të parë të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, pa pagesën e një shume arsyeshëm të lidhur me vlerën e saj, zakonisht përbën ndërhyrje joproporcionale dhe mungesë të plotë të kompensimit dhe mund të konsiderohet e justifikueshme vetëm në rrethana joproporcionale (*Ish-Mbreti i Greqisë dhe të tjerët kundër Greqisë* (vendim për kompensim) [GC], § 89). Megjithatë, në një situatë ku një masë që kontrollon shfrytëzimin e pronës është çështja e trajtuar, mungesa e kompensimit është faktor që duhet marrë në konsideratë gjatë përcaktimit nëse është arritur bilanci i drejtë (*Depalle kundër Francës* [GC], § 91). Konsiderata të ngjashme janë zbatuar edhe kur merret parasysh klauzola e përgjithshme (*Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë*, § 69; shih në fund të këtij nënkapitulli shtjellimin e mëtejshëm).

146. Në kuptim të privimit të pronës, ajo që është e arsyeshme varet nga rrethanat e secilit rast, por një marginë e gjerë e vlerësimit është e mundshme gjatë vlerësimit të shumës së kompensimit. Autoriteti i Gjykatës për rishikim kufizohet në vlerësimin nëse kushtet e kompensimit bien jashtë marginës së vlerësimit të Shtetit në këtë domen (*James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 54). Gjykata do të respektojë gjykimin e legjislaturës lidhur me kompensimin që duhet bërë për shpronësim përveç nëse ai është pa bazë të arsyeshme (*Lithgow dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 122).

147. Përderisa është e vërtetë se në shumë raste të shpronësimit ligjor vetëm kompensimi i plotë mund të konsiderohet si arsyeshëm i ndërlidhur me vlerën e pronës, edhe ky rregull i ka përjashtime e veta (*Ish-Mbreti i Greqisë dhe të tjerët kundër Greqisë* (vendim për kompensim) [GC], § 78; *Scordino kundër Italisë (nr. 1)* [GC], § 96). Prandaj, kjo dispozitë nuk garanton të drejtën e kompensimit të plotë në të gjitha rrethanat pasi që objektivat legjitime të “interetit publik” (siç janë realizimi i reformave ekonomike apo masat e dizajnuara për të arritur nivel më të lartë të drejtësisë sociale) mund të përcaktojnë vlerë më të ulët të rimbursimit se sa vlera e plotë e tregut (*James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 54; *Papachelas kundër Greqisë* [GC], § 48; *Manastiret e shenjta kundër Greqisë*, §§ 70-71; *J.A. Pye (Oxford) Ltd dhe J.A. Pye (Oxford) Land Ltd kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], § 54; *Urbárska Obec Trenčianske Biskupice kundër Sllovakisë*, § 115).

148. Balanci mes interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kushteve të mbrojtjes së të drejtave themelore individuale të përmendura më sipër arrihen kur kompensimi që i paguhet personit prona e të cilit është marrë është i ndërlidhur me vlerën e saj të “tregut”, e cila përcaktohet në momentin e shpronësimit (*Pincová dhe Pinc kundër Republikës Çeke*, § 53; *Gashi kundër Kroacisë*, § 41; *Vistiņš dhe Perepjolkins kundër Letonisë* [GC], § 111; *Guiso-Gallisay kundër Italisë* (vendim për kompensim) [GC], § 103; *Moreno Diaz Peña dhe të tjerët kundër Portugalisë*, § 76).

149. Përshtatshmëria e kompensimit do të ishte në nivel jo të duhur nëse do paguhej pa i bërë referencë rrethanave të ndryshme që ia kanë shtuar vlerën pronës, siç ndodhë për shembull kur prona nuk përbëhet vetëm nga toka por edhe nga një veprimtari afariste që zhvillohet në të, për shembull një gurëthyes, (*Werra Naturstein GmbH & Co Kg kundër Gjermanisë*, § 46; *Azas kundër Greqisë*, §§ 52-53; *Athanasiou dhe të tjerët kundër Greqisë*, § 24). Humbja e burimit kryesor të të hyrave nga shpronësimi mund të nënkuptojë që parashtruesi i kërkesës do të bartë një barrë të rëndë individuale nëse autoritetet nuk mbulojnë së paku humbjen aktuale të mjeteve të jetesës apo sigurimin e mjeteve të mjaftueshme për të blerë tokë ekuivalente brenda zonës në të cilën ai ka jetuar (*Osmanyan dhe Amiraghyan kundër Armenisë*, § 70).

150. Vonesat e paarsyeshme në realizim të kompensimit janë një tjetër faktor relevant (*Almeida Garrett, Mascarenhas Falcão dhe të tjerët kundër Portugalisë*, § 54; *Czajkowska dhe të tjerët kundër Polonisë*, § 60). Gjykata vendosi kundër Shtetit në një rast kur fakti që autoritetet publike që përcaktonin vlerën e kompensimit nuk morrën parasysh faktin se kishin kaluar mbi njëzet vite dhe parashtruesi i kërkesës nuk kishte marrë ende kurrfarë kompensimi (*Schembri dhe të tjerët kundër Maltës*, § 43). Vonesa shtatëdhjetepesë vjeçare në realizimin e pagesës së kompensimit ishte konsideruar shkelje sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 edhe në rastin *Malama kundër Greqisë*, § 51.

151. Vonesat abnormalisht të gjata në pagesën e kompensimit për shpronësim në kontekst të hiperinflacionit kishin rezultuar me humbje financiare për personin toka e së cilit ishte shpronësuar dhe

e kishin vënë atë në pozitë pasigurie (*Akkus kundër Turqisë*, § 29; *Aka kundër Turqisë*, § 49). Madje edhe nëse në kohën kur Gjykata e ka ekzaminuar rastin një pjesë e kompensimit veç është paguar, vonesa në pagesën e kompensimit të plotë mund të konsiderohet problematike (*Czajkowska dhe të tjerët kundër Polonisë*, § 62).

152. Situata personale dhe shoqërore e parashtruesit të kërkesës duhet të merret parasysh gjatë përcaktimit të kompensimit (*Pyranienë kundër Lituanisë*, § 62). Mosmarrja parasysh e faktit që parashtruesja e kërkesës e kishte blerë në mirëbesim pronën që më pas u shpronësua nga Shteti u konsiderua faktor rëndues për Shtetin (*po aty*, § 60).

153. Fakti që personat që do shpronësoheshin në të ardhmen vazhduan ta shfrytëzojnë pronën gjatë procedurave për caktimin e pagesës së kompensimit nuk e përjashtoi Shtetin nga obligimi për ta fiksuar kompensimin në një shumë arsyeshëm të lidhur me vlerën e saj (*Yetiş dhe të tjerët kundër Turqisë*, § 52).

154. Në situata të caktuara refuzimi për të dhënë dëmshpërblim të veçantë mund të përbëjë shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (*Azas kundër Greqisë*, §§ 52-53; *Athanasίου dhe të tjerët kundër Greqisë*, § 24). Për shembull, në raste të shpronësimit të pjesshëm, kur një autostradë po ndërtohej në afërsi të shtëpisë së parashtruesit të kërkesës, ndërhyrja në fjalë mund të bëjë të domosdoshëm kompensimin shtesë për shkak të kufizimit të shfrytëzimit të shtëpisë. Është evidente se natyra e ndërtimit të kryer në afërsi i ka kontribuar drejtpërsëdrejti zhvlerësimit substancial të vlerës së pronës së pashpronësuar (*Bistrović kundër Kroacisë*, §§ 40-42; *Ouzounoglou kundër Greqisë*, § 30).

155. Në rastet kur shpronësimi është rezultat i reformave më të gjera ekonomike ose masave që kanë për qëllim arritjen e një niveli më të lartë të drejtësisë sociale, margjina e vlerësimit e cila u lejohet Shteteve do të jetë e gjerë edhe në kuptim të përcaktimit të vlerës së kompensimit që do t'u ndahet parashtruesve të kërkesës. Vendimi për të miratuar legjislacion lidhur me nacionalizimin e një industrie të tërë zakonisht ngërthen konsiderimin e çështjeve të shumta për të cilat shoqëritë demokratike mund të ketë qëndrime të ndryshme. Për shkak të njohurisë direkte që ato kanë mbi shoqërinë e tyre dhe nevojat e resurset e saj, autoritetet kombëtare në parim janë në pozitë më të volitshme për ta bërë këtë vlerësim se sa një gjyqtar i huaj, e rrjedhimisht margjina e vlerësimit gjatë gjykimit nëse dikush duhet të privohet nga prona dhe përcaktimit të kushteve dhe konditave të kompensimit duhet të jetë më e gjerë (*Lithgow dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, §§ 121-22). Ngjashëm, në rastin *James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, §§ 68-9, çështja që trajtohej ishte nëse, në kontekst të reformës së legjislacionit të qirambajtjes, kushtet që fuqizonin qirambajtësit afatgjatë në kuptim të blerjes së pronave ishin të balancuara. Gjykatat konstatoi se ato ishin të balancuara duke e kuptuar kontekstin e reformës sociale dhe ekonomike në të cilin barra e bartur nga pronarët nuk ishte e paarsyeshme, edhe pse shumat e pranuar nga palët e interesuara ishin më të ulëta se sa vlera e gjithmbarshme e pronës në treg.

156. *A fortiori*, edhe kompensimi jo i plotë mund të konsiderohet i domosdoshëm kur pronat merren për qëllim të “ndryshimit thelbësor të sistemit kushtetues të një shteti, siç është tranzicioni nga monarkia në republikë” (*ish-Mbreti i Greqisë dhe të tjerët kundër Greqisë* [GC], § 87). Shteti gëzon margjinë të gjerë të vlerësimit gjatë miratimit të ligjeve në kontekst të ndryshimit të regjimit politik dhe ekonomik (*Kopecký kundër Sllovakisë* [GC], § 35). Ky parim u riafirmua në rastin *Broniowski kundër Polonisë* [GC], § 182, në kontekst të tranzicionit të vendit drejt një regjimi demokratik. Gjykata ka specifikuar se rregullat që përcaktojnë të marrëdhëniet pronësore brenda vendit “përfshirë një skemë legjislative gjithëpërfshirëse por kundërthënëse me ndikim të theksuar ekonomik për shtetin në tërësi” mund të ngërthejnë vendime që kufizojnë kompensimin në rastin e marrjes apo restitucionit të pronës në një nivel që është nën nivelin e vlerës së tregut (*Scordino kundër Italisë (Nr. 1)* [GC], § 98).

157. Gjykata gjithashtu ka ritheksuar këto parime lidhur me miratimin e ligjeve në “kontekstin e jashtëzakonshëm të unifikimit të Gjermanisë” (*Von Maltzan dhe të tjerët kundër Gjermanisë* (vendim) [GC], §§ 77 dhe 111-12) dhe në raste kur shpronësimi është kryer në bazë të legjislacionit në fuqi gjatë një periudhe tranzitore mes dy regjimeve e që është nxjerrë nga një parlament që nuk është zgjedhur në mënyrë demokratike (*Jahn dhe të tjerët kundër Gjermanisë* [GC], §§ 113 dhe 117). Në këtë të fundit, natyra unike e kontekstit të përgjithshëm politik dhe juridik të unifikimit të Gjermanisë ka justifikuar

mungesën e kompensimit. Bëhej dallim mes rasteve *Jahn dhe të tjerët* dhe *Vistiņš dhe Perepjolkins*, duke qenë se në këtë të fundit nuk kishim të bëjmë me një rast kur një situatë dukshëm e padrejtë e cila ka rrjedhë gjatë procesit të denacionalizimit është dashur të korrigjohet nga legjislatura ex post facto brenda një periudhe relativisht të shkurtër kohore, me qëllim të rivendosjes së drejtësisë sociale. Mungesa e kompensimit të mjaftueshëm rrjedhimisht është konstatuar se nuk është e justifikuar në rastin *Vistiņš and Perepjolkins kundër Letonisë*, §§ 123, 127-130).

158. Përveç kësaj, në rastet kur prona është marrë në mënyrë të paligjshme kompensimi duhet të ketë rol kompensues e jo ndëshkues apo zbindës *vis-à-vis* shtetit të paditur (*GuisoGallissay kundër Italisë* (vendim për kompensim) [GC], § 103).

159. Sipas qasjes së marrë nga Dhoma e Madhe në atë rast, për të reflektuar kalimin e kohës, vlera e tregut e pronës në momentin e marrjes duhet të konvertohet në vlerën aktuale, duke marrë parasysh efektet e inflacionit dhe interesin (e thjeshtë ligjor) që aplikohet për periudhën për të cilën parashtruesit të kërkesës i është privuar e drejta në pronë (*po aty*, § 105). Përveç kësaj, Dhoma e Madhe e ka vlerësuar humbjen e mundësive që parashtruesit e kërkesës e kanë vuajtur pas shpronësimit (*po aty*, § 107).

160. Për më tepër, kurdo që një masë që kontrollon shfrytëzimin e pronës shfaqet si problem, mungesa e kompensimit është një nga faktorët që merret parasysh gjatë përcaktimit nëse është arritur apo jo bilanci i drejtë, por në vete nuk është e mjaftueshme për tu konsideruar shkelje e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (*Anonymos Touristiki Etairia Xenodocheia Kritis kundër Greqisë*, §§ 44 dhe 45). Në rastin *Depalle kundër Francës* [GC], § 91, në të cilin parashtruesit e kërkesës banonin në shtëpitë e ndërtuara në tokë brenda kategorisë së pronës publike detare, duke marrë parasysh rregullat që qeverisin pronat publike dhe duke konsideruar se parashtruesi i kërkesës nuk ka mundur të mos dijë parimin që asnjë kompensim nuk do t'i paguhej për të Gjykata konstato qartë në çdo vendim se mungesa e kompensimit nuk mund të konsiderohet si masë joproporcionale me kontrollin e shfrytëzimit të pronës së parashtruesit të kërkesës që ushtrohet në ndjekje të interesit publik.

161. Në rastin *S.A. Bio d'Ardennes kundër Belgjikës*, §§ 47-49 dhe 51, në të cilin therja e detyruar e shumë kafshëve të infektuara me brucelozë përbënte kontroll të shfrytëzimit, Gjykata konstatoi se kompania parashtruese e kërkesës nuk është detyruar të bartë barrë individuale dhe të tepruar për shkak të refuzimit të kompensimit ndaj saj për therjen e kafshëve.

162. Gjithashtu, për ndërhyrjet me të drejtat e parashtruesve të kërkesave të cilat janë analizuar nën rregullin e përgjithshëm të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, Gjykata disi kishte ndjekur qasje të ngjashme me atë për rastet nga kategoria "kontrolli i shfrytëzimit" (*Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë*, §§ 42 dhe 47,48; *Pialopoulos dhe të tjerët kundër Greqisë*, §§ 57-61). Në rastin *Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë* (§ 69), Gjykata konstatoi se parashtruesit e kërkesës bartën një barrë individuale dhe të tepërt e cila ka mundur të jetë legjitime vetëm nëse do ta kishin mundësinë e kërkimit të zvogëlimit të kufizimeve kohore ose të kërkimit të kompensimit.

C. Obligimet pozitive të shteteve anëtare

162. Obligimi për të respektuar të drejtën në pronë sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 inkorporon edhe obligime juridike negative dhe pozitive.

163. Subjekt esencial i Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 është të mbrojë një person ndaj ndërhyrjes së pajustificuar të Shtetit në gëzimin paqësor të pronave të tij ose saj (obligim negativ). Megjithatë, sipas vetë Nenit 1 të Konventës, çdo Palë Kontraktuese "do të sigurojë se të gjithë brenda juridiksioni të tyre të drejtat dhe liritë e përkufizuara në Konventë." Jetësimi i kësaj detyre të përgjithshme mund të përfshijë obligime pozitive që kanë për qëllim sigurimin e ushtrimit efektiv të të drejtave të garantuara nga Konventa. Në kontekst të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, këto obligime pozitive mund ta obligojnë Shtetin që të ndërmarrë masat e domosdoshme për mbrojtjen e së drejtës në pronë (*Broniowski kundër Polonisë* [GC], § 143; *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, § 96; *Keegan kundër Irlandës*, § 49; *Kroon dhe të tjerët kundër Holandës*, § 31; *Ališić dhe të tjerët kundër Bosnjë e Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë, Sllovenisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* [GC], § 100; *Likvidējamā p/s Selga dhe Vasiļevska kundër Letonisë* (vendim), §§ 94-113).

164. Ushtrimi i vërtetë dhe efektiv i të drejtës së mbrojtur nga Nenit 1 i Protokollit Nr. 1 nuk varet vetëm nga detyra e Shtetit për të mos ndërhyrë, por mund të kërkojë edhe masa pozitive të mbrojtjes së saj, në veçanti kur ekziston lidhja direkte mes masave që një parashtrues i kërkesës mund të presë që të ndërmerren nga autoritetet dhe gëzimit efektiv të “pronave” të tij (*Öneryıldız kundër Turqisë* [GC], § 134), edhe në raste kur proceset zhvillohen mes personave dhe kompanive private (*Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, § 96).

165. Në rastin *Öneryıldız kundër Turqisë* [GC], §§ 135-136, i cili kishte të bënte me shkatërrimin e shumë shtëpive dhe vdekjen e disa personave si rezultat i aktiviteteve të rrezikshme të Shtetit (një eksplodim i gazit metan që ishte zhvilluar në një majë mbeturinash) në një vendbanim ilegal, Shteti konstatoi se autoritetet vendore nuk u ishin përmbajtur obligimeve të tyre pozitive sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 pasi që nuk kishin ndërmarrë çdo gjë në autoritetin e tyre për të mbrojtur interesat pronësorë të parashtruesit të kërkesës marrë parasysh rrezikun të cilin e kanë ditur ose është dashur ta dinë (*Kurşun kundër Turqisë*, § 115). Në veçanti, autoritetet kanë dështuar në informimin e banorëve mbi rrezikun që përbënte maja a vendbanimit, e cila ishte vlerësuar më parë në një raport të ekspertëve, por gjithashtu nuk kishin ndërmarrë masa praktike për ta shmangur atë rrezik, siç do të ishte vendosja e një sistemi për nxjerrjen e gazit me kohë.

166. Megjithatë, duhet bërë dallimi i qartë mes obligimeve pozitive sipas Nenit 2 të Konventës dhe atyre sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës. Përderisa rëndësia fundamentale e të drejtës në jetë kërkon që fushëveprimi i obligimeve pozitive sipas Nenit 2 të përfshijnë detyrimin për të bërë gjithçka që është në dorë të autoriteteve në sferën e masave mbrojtëse nga katastrofat për ta mbrojtur këtë drejtë, obligimi për të mbrojtur të drejtën në gëzim paqësor të pronave, që nuk është e drejtë absolute, nuk mund të shtrohet përtej asaj që është e arsyeshme në rrethanat të caktuara (*Budayeva dhe të tjerët kundër Rusisë*, § 175, për fatkeqësitë natyrore përtej kontrollit të njeriut; *Kurşun kundër Turqisë*, § 121, për dëmet e pronës që rezultojnë nga aktiviteti i rrezikshëm por që nuk përfshijnë lëndime/vdekje). Ngjashëm, nuk ka obligim pozitiv mbi Shtetin nën Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 në rast se Shteti nuk ka demonstruar neglizhencë, marrë parasysh përgjegjësinë e vet parashtruesit të kërkesës si ndërmarrës dhe specifikat e rrëshqitjes së dheut si fatkeqësi natyrore jashtë kontrollit të njeriut (*Vladimirov kundër Bullgarisë* (vendim), §§ 37 dhe 39-41).

167. Kufijtë mes obligimeve pozitive dhe negative të Shtetit nën Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 nuk mundësojnë një definim të saktë. Megjithatë, parimet e aplikueshme janë të ngjashme. Qoftë nëse rasti është analizuar në kuptim të detyrës pozitive të Shtetit apo në kuptim të ndërhyrjes nga një autoritet publik që duhet të justifikohet, kriteret që duhet të aplikohen nuk dallojnë në substancë. Në të dyja kontekstet, duhet t’i kushtohet kujdes i duhur baraspeshës mes interesave të individit dhe të komunitetit në përgjithësi. Gjithashtu qëndron se qëllimet e përmendura në këtë dispozitë mund të jenë relevante në vlerësimin nëse është gjetur baraspesha mes kërkesave të interesit publik të përfshirë dhe të drejtave thelbësore pronësore të parashtruesit të kërkesës. Në të dyja kontekstet, Shteti gëzon një margjinë të caktuar të vlerësimit në përcaktimin e hapave që duhet ndërmarrë për të siguruar pajtueshmëri me Konventën (*Broniowski kundër Polonisë* [GC], § 144; *Keegan kundër Irlandës*, § 49; *Hatton dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], §§ 98; *Ališić dhe të tjerët kundër Bosnjë e Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë, Sllovenisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* [GC], § 101; *Kotov kundër Rusisë* [GC], § 110).

168. Prandaj, në shumë raste, duke marrë në konsideratë rrethanat e tyre, Gjykata e konsideron jo të domosdoshme që të kategorizojë ekzaminimin e saj mbi rastin nën prizmin strikt të obligimeve pozitive apo negative të shteteve; në të kundërtën, ajo do të përcaktojë nëse sjellja e shtetit të paditur ka qenë e justifikueshme në kuptim të parimeve të ligjshmërisë, qëllimit legjitim dhe “balancit të drejtë”, pa marrë parasysh nëse sjellja në fjalë mund karakterizohet si ndërhyrje apo dështim për të vepruar apo kombinim të dyja këtyre (*Ališić dhe të tjerët kundër Bosnjë e Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë, Sllovenisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* [GC], § 101; *Kotov kundër Rusisë* [GC], § 102; *Broniowski kundër Polonisë* [GC], § 146; *Skórits kundër Hungarisë*, §§ 37-38).

169. Kjo kishte ndodhur në rastin *Ališić dhe të tjerët kundër Bosnjë e Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë, Sllovenisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* [GC], § 101, në të cilin parashtruesit e kërkesës

ishin ankuar për paaftësinë e tyre për të tërhequr depozitat nga llogaritë bankare të tyre të cilat ishin bërë të padisponueshme për shkak të mungesës së fondeve në bankat relevante, pas miratimit të një ligji për ngrirjen e llogarive dhe dështimit të autoriteteve kombëtare që të ndërmarrin masa për t'iu mundësuar depozituesve që të disponojnë me kursimet e tyre. Në këto rrethana, Gjykata konsideroi se është e domosdoshme që ekzaminimi të kategorizohet strikt ose nën prizmin e obligimeve pozitive ose nën ato negative të shteteve të paditura.

170. Në disa raste që kanë të bëjnë me obligimet pozitive që rrjedhin nga Neni 1 i Protokollit Nr. 1, Gjykata ka theksuar veçanërisht rëndësinë e parimit të qeverisjes së mirë. Ky parim kërkon që kurdo që një çështje të jetë e lidhur me interesin publik, në veçanti nëse prek të drejtat themelore të njeriut, përfshirë të drejtat pronësore, autoritetet publike duhet të veprojnë me shpejtësi dhe në mënyrë të duhur e mbi të gjitha konsistente (*Beyeler kundër Italisë* [GC], § 120; *Megadat.com SRL kundër Moldavisë*, § 72; *Rysovskyy kundër Ukrainës*, § 71; *Moskal kundër Polonisë*, § 72). Ky obligim është relevant edhe në kontekst të obligimeve negative dhe pozitive të cilat Neni 1 i Protokollit Nr. 1 i imponon mbi Shtetin. Parimi i qeverisjes së mirë nuk duhet, si rregull i përgjithshëm, t'i parandalojë autoritetet nga korrigjimi i gabimeve të bëra edhe nëse të njëjtat rezultojnë nga neglizhenca e shteteve. Megjithatë, nevoja për të korrigjuar një "gabim" të vjetër nuk duhet të ndërhyjë joproporcionalisht me të drejtën e re e cila është fituar nga një individ duke u bazuar në legjitimitetin e veprimeve të autoritetit publik në mirëbesim (*Beinarovič dhe të tjerët kundër Lituanisë*, § 140).

1. Efektet horizontale – ndërhyrjet nga personat privatë

171. "Masat pozitive të mbrojtjes" të cilave Gjykata u referohet u referohen jo vetëm ndërhyrjeve të Shtetit, por edhe të personave privatë, dhe mund të jenë të natyrës preventive dhe përmirësuese.

172. Në fakt, Gjykata ka konstatuar se edhe në marrëdhënie horizontale mund të ketë të përfshira çështje të interesit publik të cilat imponojnë obligime mbi Shtetin (*Zolotas kundër Greqisë (Nr. 2)*, § 39). Prandaj, disa masa të domosdoshme për të mbrojtur të drejtën pronësore mund të jenë të nevojshme edhe në raste të kontesteve mes individëve apo kompanive (*Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, § 96).

173. Megjithatë, në rastet që ndërlidhen me marrëdhëniet e rëndomta ekonomike mes palëve private obligimet pozitive të tilla janë më të kufizuara. Si rrjedhojë, Gjykata ka theksuar në shumë raste se Neni 1 i Protokollit Nr.1 të Konventës nuk mund të interpretohet si imponues i çfarëdo obligimi të përgjithshëm mbi Shtetet Kontraktuese që të mbulojë borxhet e subjekteve private (*Kotov kundër Rusisë* [GC], § 111; *Anokhin kundër Rusisë* (vendim)).

174. Veçanërisht kur një ndërhyrje me të drejtën e gëzimit paqësor të gëzimit të “pronave” është kryer nga një individ privat, obligimi pozitiv i Shtetit shfaqet në formë të detyrës për të siguruar se sistemi ligjor i vendit mbron me ligj të drejtat pronësore dhe për të mundësuar masa mbrojtëse adekuate përmes të cilave viktimat mund të kërkojnë realizimin e të drejtave të veta përfshirë, kurdo që është e mundur, përmes kërimit të kompensimit për humbjet e shkaktuara (*Kotov kundër Rusisë* [GC], § 113; *Blumberga kundër Letonisë*, § 67).

175. Nga kjo rrjedh që masat që nga Shteti mund të kërkojnë të ndërmerren në kontekste të tilla mund të jenë parandaluese apo korrigjuese (*Kotov kundër Rusisë* [GC], § 113).

176. Për shembull në rastin *Zolotas kundër Greqisë (Nr. 2)*, në të cilin parashtuesi i kërkesës nuk mund të kërkonte më depozitat në llogarinë bankare të tij pasi që për më gjatë se 20 vite nuk kishte bërë asnjë transaksion në të, Gjykata konstatoi se Shteti ka obligim pozitiv që të mbrojë qytetarët dhe të kërkojë që bankat të njoftojnë bartësit e llogarive të pashfrytëzuara mbi skadimin e mundshëm të afatit të përdorimit dhe që rrjedhimisht t’u japë mundësi që të pezullojnë skadimin e kësaj periudhe të përdorimit, marrë parasysh pasojat potencialisht negative të këtyre periudhave të skadimit për mirëqenien e qytetarëve. Mosvënia e një detyrimi për të ofruar informata të tilla përbën çrregullim të baraspeshës që duhet të arrihet kërkesave në interes të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesës për mbrojtje të të drejtave themelore të individit.

2. Masat korrigjuese

176. Duke iu referuar specifikisht masave korrigjuese të cilat shteti mund të kërkojë t’i ndërmarrë në rrethana të caktuara, Gjykata ka konstatuar se ato përfshijnë mekanizmat përkatës ligjorë që u mundësojnë palëve të pakënaqura që të realizojnë të drejtat e tyre efektivisht. Edhe pse Neni 1 i Protokollit Nr. 1 nuk përmban kushte procedurale shprehimore, ekzistimi i obligimeve pozitive të karakterit procedural nën këtë dispozitë është njohur nga Gjykata edhe në raste që përfshinin autoritete shtetërore (*Jokela kundër Finlandës*, § 45; *Zehentner kundër Austrisë*, § 73) edhe në raste mes palëve private.

177. Si rrjedhojë, në rastet që bien në kategorinë e fundit, Gjykata ka vlerësuar se Shtetet kanë për obligim që të sigurojnë procedura gjyqësore që ofrojnë garancitë e nevojshme procedurale dhe t’u mundësojnë gjykatave dhe tribunaleve vendore që të vendosin në mënyrë të drejtë dhe efektive mbi të gjitha kontestet mes personave privatë (*Kotov kundër Rusisë* [GC], § 114; *Sovtransavto Holding kundër Ukrainës*, § 96; *Anheuser-Busch Inc. kundër Portugalisë* [GC], § 83; *Freitag kundër Gjermanisë*, § 54; *Shesti Mai Engineering OOD dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, § 79; *Plechanow kundër Polonisë*, § 100; *Ukrainës-Tyumen kundër Ukrainës*, § 51). Në rastet kur dëmtimi i pronës është rezultat i një veprimi të rrezikshëm të një personi privat, Shteti ka për obligim të ofrojë mjete juridike penale, civile apo administrative (*Kurşun kundër Turqisë*, §§ 123-124).

178. Ky parim është edhe më i zbatueshëm kur vet Shteti është në kontest me një individ. Në rast se ka mangësi serioze në trajtimin e kontesteve të tilla, kjo mund të manifestohet si shkelje e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (*Plechanow kundër Polonisë*, § 100).

179. Përgjegjësia e Shtetit në rast të dështimit për të ofruar mjete adekuate korrigjuese është konstatuar në kontekst të përmbartimit të borxheve sipas aktgjykimit: restitucionit të pronës (*Păduraru kundër Rumanisë*, § 112); pagesës së kompensimit për shpronësim (*Almeida Garrett, Mascarenhas Falcão dhe të tjerët kundër Portugalisë*, §§ 109-111); përmbartimit të urdhrave gjyqësorë për dëbimin e qirambajtësve dhe kthimin e posedimit të vendbanimeve (*Immobiliare Saffi kundër Italisë* [GC], §§ 43-59; *Matheus kundër Francës*, §§ 69-71; *Lo Tufo kundër Italisë*, § 53; *Prodan kundër Moldavisë*, § 61).

3. Procedurat përmbartimore

180. Obligimet pozitive të Shtetit janë trajtuar shumë në kontekst të procedurave përmbartimore edhe kundër Shteteve edhe kundër debitorëve privatë. Kjo posaçërisht nënkupton që Shtetet kanë obligim pozitiv të organizojnë një sistem për përmbartimin e aktgjykimeve edhe me ligj edhe në praktikë për të

garantuar që realizimi i procedurave të përmbarimit të aktgjykimeve të formës së prerë të mishëruara në legjislacion të bëhet pa vonesa të paarsyeshme (*Fuklev kundër Ukrainës*, § 91). 181. Në rastet kur ankesat e parashtruesit të kërkesës ndërlidhen me pamundësinë për të përmbaruar një vendim gjyqësor në favor të tij apo saj, obligimet e Shtetit nën Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 dallojnë varësisht nëse debitor është Shteti apo ndonjë person privat (*Anokhin kundër Rusisë* (vendim); *Liseyitseva dhe Maslov kundër Rusisë*, § 183).

182. Kur Shteti është debitor, praktika gjyqësore e Gjykatës zakonisht ngulë këmbë që Shteti t'u përmbahet vendimeve gjyqësore në tërësi dhe pa vonesa (*Anokhin kundër Rusisë* (vendim); *Burdov kundër Rusisë*, §§ 33-42). Barra për të garantuar pajtueshmëri me një aktgjykim kundër një Shteti bartet kryesisht nga autoritetet e Shtetit, filluar nga data prej së cilës aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm dhe përmbarueshëm (*Burdov kundër Rusisë* (Nr. 2), § 69).

183. Dështimi për të siguruar zbatimin e një vendimi gjyqësor kundër Shtetit në një rast që ka të bëjë me kërkesa kompensimi zakonisht përbën shkelje të Nenit 6 dhe Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Neni 6 § 1 siguron që të gjithë të kenë të drejtë të paraqesin kërkesa lidhur me të drejtat dhe obligimet e tyre civile para një gjykate apo tribunali; kështu, ky paragraf mishëron “të drejtën për gjykim” një aspekt kyç i së cilës është e drejta e qasjes, do të thotë e drejta për të filluar procedurë para gjykatave të çështjeve civile. Megjithatë, kjo e drejtë do të ishte iluzore nëse sistemi juridik vendor i Shtetit Kontraktues do të lejonte që vendimet përfundimtare gjyqësore të mos zbatohen duke dëmtuar kështu një palë. Do të ishte e paimagjinueshme që Neni 6 § 1 të përshkruajë në detaje garancitë procedurale që u akordohen palëve në procedurë – procedurat që janë të drejta, publike dhe ekspeditive – pa mbrojtur zbatimin e vendimeve gjyqësore; të interpretojë Nenin 6 si nen që merret ekskluzivisht me qasjen në gjykatë dhe që të lejojë që realizimi i procedurave të shpie në situata të cilat nuk janë në pajtim me parimet e sundimit të ligjit të cilin Shtetet Anëtare janë zotuar ta respektojnë në momentin e ratifikimit të Konventës. Ekzekutimi i aktgjykimeve të nxjerra nga cilado gjykatë duhet të konsiderohet si pjesë integrale e “gjykimit” për qëllime të Nenit 6 të Konventës (*Hornsby kundër Greqisë*, § 40; *Burdov kundër Rusisë*, § 34).

184. Vonesa e paarsyeshme në përmbarim të aktgjykimeve përfundimtare mund të përbëjë shkelje të Konventës (*Immobiliare Saffi kundër Italisë* [GC], § 63; *Hornsby kundër Greqisë*, § 40; *De Luca kundër Italisë*, § 66; *Burdov kundër Rusisë* (Nr. 2), § 65). Për shembull, në kontekst të kompanive shtetërore, vonesa prej më pak se një viti në kuptim të pagesës së vendimeve gjyqësore me kompensim monetar është në parim në pajtim me Konventën, ndërsa vonesat më të gjata janë *prima facie* të paarsyeshme (*Kuzhelev dhe të tjerët kundër Rusisë*, §§ 109-110).

185. Nuk është justifikim i autoriteteve të Shtetit që mungesën e fondeve ta vendosin si arsye për mosrespektimin e borxhit sipas aktgjykimit. Vonesa në ekzekutimin e një aktgjykimi mund të justifikohet vetëm në disa rrethana të posaçme. Por, vonesa si e tillë nuk mund të dëmtojë esencën e së drejtës që mbrohet me Nenin 6 § 1 (*Immobiliare Saffi kundër Italisë* [GC], § 74). Ngjashëm, kompleksiteti i procedurës përmbarimore të vendit apo sistemit buxhetor të Shtetit nuk mund ta lirojnë Shtetin nga obligimi i vet sipas Konventës që t'u garantojë të gjithëve të drejtën e përmbarimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm kohor (*Burdov kundër Rusisë* (Nr. 2), § 70; *Süzer dhe Eksen Holding A.Ş. kundër Turqisë*, § 116).

186. Një person që ka marrë një aktgjykim përfundimtar kundër Shtetit nuk mund të pritët që të iniciojë procedurë përmbaruese të ndarë (*Metaxas kundër Greqisë*, § 19, dhe *Lizanets kundër Ukrainës*, § 43; *Ivanov kundër Ukrainës*, § 46). Në raste të tilla, autoriteti shtetëror i paditur që është njoftuar për aktgjykimin duhet të ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme për t'iu përmbajtur atij apo për t'ia dërguar autoritetit kompetent për përmbarim (*Burdov kundër Rusisë* (Nr. 2), § 69). Nga fituesi i procedurës mund të kërkojë që t'i ndërmarrë disa hapa proceduralë për të siguruar pagesën e borxhit, qoftë përmes përmbarimit vullnetar të aktgjykimit nga Shteti apo përmes përmbarimit me mjete detyruese (*Shvedov kundër Rusisë*, § 32). Kështu, nuk është e paarsyeshme që autoritetet të kërkojnë nga parashtruesi i kërkesës që të paraqesë dokumente të reja, siç janë llogaritë bankare, për ta mundësuar apo përshpejtuar përmbarimin e një aktgjykimi (*Kosmidis dhe Kosmidou kundër Greqisë*, § 24). Megjithatë, kërkesa që kreditori të bashkëpunojë nuk mund të shtrihet përtej asaj që është e

plotësisht e domosdoshme dhe në asnjë mënyrë nuk i liron autoritetet nga obligimi që kanë sipas Konventës që të ndërmarrin veprime të duhura dhe me kohë.

187. Për shembull, në rastin *Skórits kundër Hungarisë*, §§ 43-44, Gjykata konstatoi se autoritetet është dashur të ndërmarrin hapa praktikë për të siguruar që vendimet për kthimin e pronësisë të zbatoheshin dhe të mos kishte gabime në të dhënat në regjistrin e tokave, dhe se ka pasur shkelje të drejtave pronësore pasi që dhjetë vite kishin kaluar nga vendimi para se që parashtruesit të kërkesës përfundimisht iu mundësua posedimi i tokës. Në rastin *Vitiello kundër Italisë*, § 37, Gjykata gjeti shkelje të drejtës në pronë si rrjedhojë e mosekzekutimit nga autoritetet të një vendimi gjyqësor për demolimin e një ndërtese abuzive.

188. Në kontekst të restitucionit të pronës, Gjykata urdhëroi Shtetin që të ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme për të siguruar zbatimin e vendimeve në favor të parashtruesve të kërkesave brenda një afati të caktuar kohor, përfshirë largimin e një kishe nga tokat e tyre (*Orlović dhe të tjerët kundër Bosnjë e Hercegovinës*, §§ 68-71; shih kapitullin për Restitucionin e pronave më poshtë).

189. Në rastin *De Luca kundër Italisë*, §§ 49-56, mosofrimi i mundësisë për parashtruesin e kërkesës që të iniciojë procedura përmbartimore kundër një autoriteti lokal në bazë të një aktgjykimi për kompensim të dëmeve u konsiderua si shkelje e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Prandaj, edhe paaftësia juridike e një autoriteti publik për t'i paguar borxhet e veta nuk e përjashton përgjegjësinë e Shtetit në bazë të Konventës.

190. Gjatë vlerësimit nëse një ndërmarrje duhet trajtuar si “organizatë qeveritare” statusi ligjor i ndërmarrjes sipas të drejtës vendore nuk është faktor vendimtar për përcaktimin e përgjegjësisë së Shtetit për veprat apo lëshimet e saj. Në fakt, ndërmarrja duhet të gëzojë pavarësi të mjaftueshme institucionale dhe operative nga Shteti për ta liruar këtë të fundit nga përgjegjësia sipas Konventës si rrjedhojë e veprave dhe lëshimeve të ndërmarrjes. Kritere kyçe që përdoren për të përcaktuar nëse Shteti ka qenë përgjegjës për borxhe të tilla janë: statusi juridik i ndërmarrjes (në bazë të ligjit publik apo privat); natyra e veprimtarisë së saj (funksion publik apo afarizëm komercial i rëndomtë); konteksti i veprimtarisë së saj (monopol apo biznes i rregulluar); pavarësia institucionale e saj (shkalla e pronësisë së Shtetit); dhe pavarësia operationale e saj (shkalla e mbikëqyrjes dhe kontrollit të Shtetit) (*Liseytsseva dhe Maslov kundër Rusisë*, §§ 186-188, dhe referencat e cituara aty) (për më tepër detaje, shih kapitullin për Ndërmarrjet shtetërore më poshtë).

191. Kur debitor është një subjekt privat, pozita ndryshon sepse Shteti si rregull i përgjithshëm nuk është drejtpërsëdrejti përgjegjës për borxhet e subjekteve private dhe obligimet e tij sipas Konventës kufizohen në sigurimin e asistencës së nevojshme për kreditorët në zbatimin e vendimeve gjyqësore përkatëse, për shembull përmes një shërbimi të përmbartuesve gjyqësorë apo procedurave të falimentimit (*Anokhin kundër Rusisë* (vendim); *Shestakov kundër Rusisë* (vendim); *Krivosogova kundër Rusisë* (vendim); *Kesyan kundër Rusisë*, § 80).

192. Rrjedhimisht, kur autoritet janë të obliguara të veprojnë në mënyrë që të përmbartojnë një aktgjykim dhe dështojnë në këtë, ky mosveprim mundet, në raste të caktuara, të konsiderohet përgjegjësi e Shtetit në bazë të Nenit 6 § 1 të Konventës dhe Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të saj (*Scollo kundër Italisë*, § 4; *Fuklev kundër Ukrainës*, § 84). Detyra e Gjykatës në raste të tilla është të ekzaminojë nëse masat e ndërmarrja nga autoritetet ishin adekuate dhe të mjaftueshme dhe nëse ato kanë vepruar në mënyrë të kujdesshme për t'i asistuar kreditorit në ekzekutimin e aktgjykimit (*Anokhin kundër Rusisë* (vendim); *Fuklev kundër Ukrainës*, § 84).

193. Më specifikisht, Shteti ka për obligim sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të ofrojë asistencën e domosdoshme për kreditorët në përmbartimin e vendimeve të nxjerra nga gjykata (*Kotov kundër Rusisë* [GC], § 90; *Fomenko dhe të tjerët* (vendim), § 171). Për shembull, në rastin *Fuklev kundër Ukrainës*, § 92, Gjykata vlerësoi se dështimi i përmbartuesve gjyqësorë që të veprojnë për mbi katër vite apo që të kontrollojnë në mënyrë efektive procedurat përmbartimore të falimentimit përbënte shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Në rastin *Fomenko dhe të tjerët* (vendim), §§ 181-195, në të cilin vonesat në përmbartim ishin deri në dymbëdhjetë vite të gjata, Gjykata konstatoi, marrë parasysh kompleksitetin e procedurave përmbartimore, numrin e paditësve, vlerën e gjithmbarshme të borxhit që duhej

kompensuar, qasjen e kompanisë debitorë dhe informatat në dispozicion lidhur me veprimtarinë e përmbaruesve gjyqësorë – se efekt i gjithmbarshëm i masave të shfrytëzuara nga këta të fundit ishte në pajtim me kërkesat që Shteti i imponohen edhe në bazë të Nenit 6 § 1 të Konventës edhe në bazë të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të saj. Në një rast ku legjislacioni kombëtar për falimentimin konsideronte kërkesat kreditore të punonjësve që ndërlidhen me punësimin brenda një afati prej një viti para hapjes së procedurave të falimentimit si kërkesa me prioritet, ndërsa ato që bien jashtë këtij afati njëvjeçar si kërkesa që nuk gëzojnë prioritet, Gjykata iu referua legjislacionit të ONP-së dhe konstatoi se ky rregullim ligjor ishte i rregullt (*Acar dhe të tjerët kundër Turqisë* (vendim), § 34).

194. Dështimi për të zbatuar një aktgjykim ndaj një debitori privat për shkak të situatës skamnore të debitorit nuk mund të konsiderohet si argument kundër Shtetit, përveç nëse autoritetet vendore kanë bërë ndonjë lëshim apo gabim, për shembull duke vonuar procedurat e përmbarimit (*Omasta kundër Sllovakisë* (vendim); *Vrtar kundër Kroacisë*, § 96).

195. Në anën tjetër, shkelje u konstatua në një rast ku autoritetet vendore kishin proceduar me shitjen e pronës së parashtruesit të kërkesës pasi ai e kishte paguar borxhin në tërësi, vetëm sa për të kthyer koston e procedurës përmbarimore (*Mindek kundër Kroacisë*, §§ 79-87) ose në një rast tjetër ku një shtëpi u shit gjatë procedurës së përmbarimit për një të tretën e vlerës së saj (*Ljaskaj kundër Kroacisë*, §§ 62-70). Ngjashëm, shitja e një shtëpie dhe largimi i dhunshëm i parashtruesit të kërkesës nga ajo në kontekst të implementimit të procedurave përmbarimore tatimore, në rastin kur tatimi i papaguar arrinte shumën e vetëm një pjese të vogël të vlerës së shtëpisë dhe në kontekst të mungesës së komunikimit mes autoriteteve të ndryshme tatimore të përfshira në pjesë të ndryshme të procedurës që kishte për qëllim ekzekutimin e urdhrat kundër parashtruesit të kërkesës u konstatua se përbëjnë shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (*Rousk kundër Suedisë*, §§ 119-127).

D. Marrëdhënia mes Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 dhe neneve tjera të Konventës

196. Çështjet që shfaqen lidhur me gëzimin e “pronave” mund të ndërlidhen edhe me nene tjera të Konventës.

1. Neni 2¹

197. Në rastin *Öneryıldız kundër Turqisë* [GC], §§ 136-137, në të cilin një eksplozim i gazit metan në një deponi rezultoi me rrëshqitje dheu që kaploi shtëpinë e parashtruesit të kërkesës dhe vrau nëntë anëtarë të familjes së ngushtë të tij, Gjykata nuk ka bërë diferencimin mes obligimeve pozitive të shteteve sipas Nenit 2 dhe Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 lidhur me përshtatshmërinë e masave preventive dhe korrigjuese.

2. Neni 3

198. Në rastin *Pančenko kundër Letonisë* (vendim), ku parashtruesja e kërkesës ishte ankuar për problemet socio-ekonomike të saj në përgjithësi, Gjykata kishte rikujtuar se Konventa nuk garanton të drejtat socio-ekonomike si të tilla. Megjithatë, nuk e ka përjashtuar mundësinë që kur kushtet e jetesës së parashtruesit të kërkesës arrijnë në një nivel minimal kjo mundë të konsiderohet trajtim në kundërshtim me Nenin 3.

199. Në rastin *Budina kundër Rusisë* (vendim), ku parashtruesja e kërkesës ankohej se pensioni i saj është tepër i ulët dhe nuk i mundëson mbijetesën, Gjykata nuk e përjashtoi mundësinë që Shteti të konsiderohet përgjegjës në kuptim të Nenit 3 sa i përket trajtimit të një parashtrueseje të kërkesës që varet plotësisht nga përkrahja e Shtetit dhe e cila hasi në indiferencë zyrtare nga shteti dhe u përball me një situatë të privimit dhe shkeljes së dinjitetit njerëzor të saj. Gjykata konsideroi se ankesa si e tillë nuk ishte në mospajtim *ratione materiae* me dispozitat e Konventës dhe ekzaminoi rrethanat ekonomike të

¹ Shih *Udhëzuesin për Nenin 2 (E drejta në jetë)*.

parashtrueses së kërkesës, përfshirë edhe shumën e pensionit të saj që paguhej nga Shteti, në tërësi, nën prizmin e Nenit 3, për të vërtetuar nëse situata e saj ishte e tillë që të përfshihej në ndalimin e trajtimit çnjerëzor. Gjykata konstatoi se nuk ka pasur situatë të tillë.

3. Neni 4²

200. Zgjedhja që iu dha një të burgosuri mes punës me pagesë apo pa pagesë me ulje të dënimit nuk përbënte shkelje të Nenit 4 të Konventës (*Floroiu kundër Rumanisë* (vendim), §§ 35-38). Puna e detyruar e kryer nga të burgosurit e cila nuk ndërlidhet me sistemin e pensionit në bazë të moshës konsiderohet si “punë e cila duhet të kryhet gjatë kohëzgjatjes së burgimit” brenda kuptimit të Nenit 4 § 3 (a) të Konventës (*Stummer kundër Austrisë* [GC], § 132).

201. Ngjashëm, puna pa pagesë e kryer nga një i burgosur mund të konsiderohet “punë e cila duhet të kryhet gjatë kohëzgjatjes së burgimit” (*Zhelyazkov kundër Bullgarisë*, § 36). Megjithatë, Gjykata nënvizoi zhvillimet e sjelljeve ndaj punës pa pagesë të të burgosurve në Rregullat e Burgjeve Evropiane të vitit 1987 dhe 2006, të cilat përcaktojnë që të ketë pagesë të barabartë për punën e të burgosurve, dispozitë kjo të cilës në vitin 2006 iu shtua edhe togfjalëshi “në të gjitha rastet”, për të trajtuar këtë trend në evoluim e sipër. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës kishte kryer punë pa pagesë para miratimit të Rregullave të vitit 2006 dhe për një periudhë të shkurtër kohore (*po aty*, § 36).

4. Neni 6³

202. Procedurat kombëtare lidhur me ndërhyrjen ndaj apo mbrojtjen e të drejtës në pronë shpesh nxisin çështje që ndërlidhen me paragrafin e parë të Nenit 6. Në fakt, e drejta në pronë është qartë e drejtë monetare dhe vendimet e Shtetit që kanë të bëjnë me shpronësimin apo rregullimin e shfrytëzimit të pronave private apo që në forma tjera prekin të drejtat financiare apo pronësore tjera shpesh janë trajtuar nën prizmin e të drejtës për gjykim të drejtë (*British-American Tobacco Company Ltd kundër Holandës*, § 67 – aplikimi për patentë; *Raimondo kundër Italisë*, § 43 – konfiskimi). Për më tepër, përmbartimi i vendimeve gjyqësore përbën pjesë integrale të “gjykimit” në kuptim të Nenit 6 (shih nënkaptullin mbi Procedurat përmbartimore më lartë).

203. Megjithatë, më së shpeshti në rastet në të cilat procedurat civile lidhur me të drejtat pronësore kanë zgjatur për periudha të stërzgjatura kohore për Gjykatën ky fakt mjafton për të konstatuar shkelje të Nenit 6 të Konventës. Në rastet kur parashtruesit e kërkesës pretendojnë se gjatësia e procedurave në vetë ka përbërë pengesë të vazhdueshme për ushtrimin e të drejtës në pronë, Gjykata ka konstatuar se nuk është e domosdoshme të ekzaminohet ankesa për gjatësi të procedurës nën prizmin e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (*Zanghi kundër Italisë*, § 23) ose nëse çështja është e parakohshme (*Beller kundër Polonisë*, § 74). Në kontekst të “qirasë sociale”, Gjykata ka konstatuar se duke dështuar për disa vite që të ndërmerren masat e nevojshme për të vepruar në pajtueshmëri me vendimin gjyqësor që urdhëron rivendosjen në banesë të parashtruesit të kërkesës, autoritetet frënge ia kanë mohuar parashtruesit të kërkesës zbatimin e efektshëm të Nenit 6 § 1 (*Tchokontio Hapi kundër Francës*, § 52).

204. Megjithatë, në rastet që kanë të bëjnë me procedurat e stërzgjatura, Gjykata ka konstatuar se zgjatja e tepër e tyre (*Kunić kundër Kroacisë*, § 67; *Machard kundër Francës*, § 15) ose masat tjera që i kontribuojnë vonesave (*Immobiliare Saffi kundër Italisë* [GC], § 59) gjithashtu kanë ndikim direkt në të drejtat e parashtruesve të kërkesave për gëzim paqësor të “pronave” të tyre. Në këtë të fundit, Gjykata gjithashtu konstatoi se kompania e parashtruesit të kërkesës ishte privuar nga e drejta e vet sipas Nenit 6 për të pasur shqyrtim gjyqësor të kontestit që kishte me qirambajtësin e vet (*po aty*, § 74).

205. Në rastet kur Gjykata konstaton shkelje të Nenit 6 në bazë të pamundësisë së qasjes në gjykata dhe parashtruesi i kërkesës ankohet lidhur me rezultatin substancial të rastit edhe sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, Gjykata zakonisht e konsideron se nuk mund të spekulohet mbi atë se cila do të ishte situata nëse parashtruesi i kërkesës do të kishte pasur qasje efektive në gjykatë. Prandaj nuk është e

² Shih *Udhëzuesin për Nenin 4 (Parandalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar)*.

³ Shih Udhëzuesit për Nenin 6 (E drejta për gjykim të drejtë): *Pjesa civile* dhe *Pjesa penale*.

domosdoshme që të gjykohet mbi pyetjen nëse parashtuesi i kërkesës ka pasur një pronë nën kuptimin e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 dhe, rrjedhimisht, mbi ankesën e bazuar në atë nen (*Kisha katolike Canea kundër Greqisë*, § 50; *Glod kundër Rumanisë*, § 46; *Albina kundër Rumanisë*, § 43; *Lungoci kundër Rumanisë*, § 48; *Yanakev kundër Bullgarisë*, § 82). Megjithatë, në rastin *Zehentner kundër Austrisë*, § 82, lidhur me shitjen gjyqësore të apartamentit të parashtuesit të kërkesës, Gjykata gjeti shkelje të Nenit 8 dhe Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, për shkak të masave joadekuate procedurale të mbrojtjes së parashtuesit të kërkesës i cili nuk kishte kapacitet gjyqësor dhe konstatoi se ka pasur shkelje tjetër të posaçme të Nenit 6.

206. Miratimi i një ligji të ri me efekt retroaktiv që rregullon gjendjen financiare përderisa procedurat lidhur me një interes pronësor të parashtuesit të kërkesës ende nuk kanë përfunduar, mund të përbëjë shkelje të Nenit 6 dhe Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, kur miratimi i ligjit nuk justifikohet me arsye të interesit të përgjithshëm dhe përbën barrë të shtuar mbi parashtuesin e kërkesës (*Caligiuri dhe të tjerët kundër Italisë*, § 33).

207. Kur një parashtues i kërkesës ankohet për mungesë të mundësisë për të zbatuar një vendim përfundimtar gjyqësor në favor të tij, nën shqyrtim bien obligimet e Shtetit edhe sipas Nenit 6 edhe sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Kur autoritetet janë të obliguara që të veprojnë në zbatimin e aktgjyqimeve dhe dështojnë që të bëjnë këtë, ky mosveprim mundet, në rrethana të caktuara, të konsiderohet përgjegjësi e Shtetit nën Nenin 6 dhe Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (*Fuklev kundër Ukrainës*, §§ 86 dhe 92-93; *Anokhin kundër Rusisë* (vendim); *Liseyitseva dhe Maslov kundër Rusisë*, § 183).

208. Anulimi i aktgjyqimeve detyruese dhe të zbatueshme gjyqësore që i akordojnë parashtuesit të kërkesës kompensim përmes revizionit mbikëqyrës, në mungesë të rrethanave të jashtëzakonshme bindëse, shkel parimin e plotfuqishmërisë së aktgjyqimeve dhe përbën shkelje të Nenit 6 § 1 dhe Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (*Davydov kundër Rusisë*, §§ 37-39). Megjithatë, parimi i “sigurisë juridike” nuk duhet të dekurajojë Shtetet nga korrigjimi i vendimeve të gabueshme gjatë administrimit të drejtësisë (*Lenskaya kundër Rusisë*, § 41). Rrethanat e jashtëzakonshme të tilla shfaqen vetëm kur procedurat fillestare kanë pasur aq shumë gabime serioze sa që të njëjtat konsiderohen fundamentalisht të padrejta, siç ndodhi në rastin kur pa faj të një pale të tretë që nuk ishte palë në procedurë, gjykata vendore nxori vendim me të cilin prekeshin direkt të drejtat e tij. Anulimi i vendimit përfundimtar në këto rrethana nuk përbënte shkelje të Konventës (*Protsenko kundër Rusisë*, §§ 30-34). Ngjashëm, anulimi i një aktgjykimi përfundimtar që kishte për qëllim korrigjimin e një dështimi në zbatimin e së drejtës në procedura penale (*Giuran kundër Rumanisë*, § 41) u konsiderua se përbën balancim të interesave të plotfuqishmërisë dhe drejtësisë, ose rasti kur parashtuesit të kërkesës iu akordua restitucioni i tërë pronës, përkundër faktit që disa persona kishin të drejtë mbi të (*Vikentijevik kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, § 70).

209. Çështje që kanë të bëjnë me shpenzimet e procedurave gjyqësore disa herë janë ekzaminuar nga Gjykata nën prizmin e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Rregulli “humbësi paguan” në kontekst të procedurave civile nuk mund të konsiderohet si i tillë të jetë në kundërshtim me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (*Klauz kundër Kroacisë*, §§ 82 dhe 84), duke qenë se qëllimi i tij është që të shmang procedurat gjyqësore të panevojshme dhe kostot paarsyeshme të larta të procedurave gjyqësore duke bërë që paditësit potencialë të mos ndërmarrin veprime të pabazuara pa bartur pasojat e tyre. Ky qëndrim nuk ndryshohet nga fakti që ato rregulla zbatohen edhe në procedura civile në të cilat Shteti është palë (*Cindrić dhe Bešlić kundër Kroacisë*, § 96). Në një rast ku parashtuesit e kërkesës kishin kërkuar kompensim për shpronësim dhe kishin fituar pjesërisht rastin, por në vendimin e marrë ishin vendosur shpenzime marramendëse të procedurës, Gjykata konstatoi se ka pasur shkelje të Konventës. Gjykata theksoi se as sjellja e parashtuesve të kërkesës e as veprimi procedural i iniciuar nuk mund të justifikojnë tarifa gjyqësore aq të larta sa që të rezultojnë në mungesë të plotë të kompensimit për shpronësim. Si rrjedhojë mbi parashtuesit e kërkesës vendoset një barrë e tepërt (*Perdigão kundër Portugalisë* [GC], § 78; in *Musa Tarhan kundër Turqisë*, § 86, ku parashtuesi i kërkesës urdhërohet që të paguajë shpenzimet gjyqësore të palës tjetër në një procedurë shpronësimi, me çka shumat e kompensimit zvogëlohet dukshëm, barra mbi parashtuesin e kërkesës gjithashtu u konstatua të jetë e tepërt). Refuzimi për të rimbursuar shpenzimet e akumuluar gjatë kundërshtimit të një padie të pasuksesshme civile të një

prokurori publik në favor të një pale të tretë, gjithashtu u konstatua se përbën shkelje të Nenit 6 të Konventës (*Stankiewicz kundër Polonisë*, §§ 65-76).

210. Nën anën penale të tij, Neni 6 është zbatuar në një rast kur u lëshua një urdhër për të demoluar një shtëpi e cila u ndërtua pa leje planifikuese, por e cila ishte toleruar nga autoritetet për tridhjetë vite me radhë. Në këtë rast të veçantë, masa e demolimit u konsiderua se përbën “ndëshkim” brenda kuptimit të Konventës (*Hamer kundër Belgjikës*, § 60).

5. Neni 7⁴

211. Konfiskimi i imponuar mbi parashtruesit e kërkesës për shkak të ndërtimit të jashtëligjshëm është konsideruar “ndëshkim” brenda kuptimit të Nenit 7 të Konventës, përkundër faktit se nuk është shqiptuar asnjë dënim penal për kompanitë parashtruese të kërkesës apo përfaqësuesit e tyre. Për këtë qëllim, Gjykata është bazuar në faktin se konfiskimi në fjalë ka qenë i lidhur me një “vepër penale” sipas dispozitave të përgjithshme ligjore; se paligjshmëria materiale e ndërtimit ka qenë e përcaktuar nga gjykata penale; se dënimi i përshkruar në ligjin italian ka pasur për qëllim shmangien nga shkeljet e mëtejme ligjore përmes ndëshkimit; se ligji e klasifikonte konfiskimin për ndërtim ilegal sei vepër penale; dhe, e fundit, se sanksioni ishte i rëndë për nga natyra (*Sud Fondi srl dhe të tjerët kundër Italisë* (vendim)). Kriteret e njëjta ishin aplikuar në rastin *G.I.E.M. S.R.L. dhe të tjerët kundër Italisë* (merita) [GC], §§ 212-234, në të cilin u konstatua se mund të aplikohet Neni 7.

212. Në rastin *Sud Fondi srl dhe të tjerët kundër Italisë*, gjykata vendore i liroi përfaqësuesit e kompanive parashtruese të kërkesës për shkak se ata e kishin bërë një gabim të paevitueshëm dhe të falshëm gjatë interpretimit të lejes planifikuese e cila u ishte lëshuar. Për qëllime të Nenit 7, korniza ligjore në fuqi nuk u mundësonte të akuzuarve të dinë kuptimin dhe fushëveprimin e ligjeve penale, që si e tillë ishte e mangët. Si rrjedhojë, konfiskimi i pronave që u urdhërua nga gjykata penale nuk kishte qenë e përshkruar me ligj për qëllime të Nenit 7 dhe përbënte ndëshkim arbitrar. Për të njëjtat arsye, konfiskimi shkelte edhe Neni 1 të Protokollit Nr. 1 (*Sud Fondi srl dhe të tjerët kundër Italisë*, §§ 111-118 dhe 136-142). Një konkluzë e ngjashme u nxor edhe në rastin ku prona dhe ndërtesat ishin konfiskuar edhe pse procedura penale ndaj pronarit ishte ndërprerë për shkak të parashkrimit (*Varvara kundër Italisë*, § 72).

213. Në rastin *G.I.E.M. S.R.L. dhe të tjerët kundër Italisë* (merita) [GC], konfiskimi u zbatua automatikisht mbi rastet e ndërtimit ilegal, siç përshkruhej në legjislacionin italian. Gjykata vlerësoi proporcionalitetin e ndërhyrjes, duke marrë parasysh një sërë faktorësh, përfshirë shkallën e fajësisë apo neglizhencës së shfaqur nga parashtruesit e kërkesës ose, së paku, marrëdhënien mes sjelljes së tyre dhe shkeljes në fjalë. Rëndësia e garancive procedurale gjithashtu u nënvizua në këtë rast, duke qenë se procedurat gjyqësore lidhur me të drejtën për gëzim paqësor të “pronave” duhej t’i ofronin individit një mundësi të arsyeshme për ta paraqitur rastin e tij ose saj para autoriteteve kompetente për t’i sfiduar efektivisht masat që ndërhyenin ndaj të drejtave të garantuara nga Neni 1 i Protokollit Nr. 1 (*po aty*, §§ 301-303).

6. Neni 8⁵

214. Një sërë rastesh lidhur me të drejtat banesore kishin të bënin njëkohësisht me Nenin 8 të Konventës dhe Nenin 1 të Protokollit Nr.1. Mund të ekzistojë një përzierje e koncepteve të “shtëpisë” dhe “pronës” sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, por ekzistenca e “shtëpisë” nuk varet nga ekzistenca e një të drejte apo interesi pronësor (*Surugiu kundër Rumanisë*, § 63). Një individ mund të ketë të drejta pronësore mbi një ndërtesë apo tokë të caktuar në kuptim të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, pa pasur kurrfarë lidhje me pronën dhe mbi prona të cilat nuk përbëjnë “shtëpi” të tij apo saj në kuptimin e Nenit 8 (*Khamidov kundër Rusisë*, § 128).

215. Ndërhyrja me të drejtën e parashtruesit të kërkesës për të banuar në shtëpinë e tij mund të shkaktojë shkelje të Nenit 8. Gjykata ka adaptuar një interpretim të gjerë të nocionit të shtëpisë (*Gillow*

⁴ Shih *Udhëzuesin për Nenin 7 (Nuk ka ndëshkim pa ligj)*.

⁵ Shih *Udhëzuesin për Nenin 8 (E drejta për respektim të jetës private dhe familjare)*.

kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 46; *Larkos kundër Qipros* [GC], §§ 30-32; *Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë* [GC], § 88). E njëjta mund të vlejë edhe sa i përket hapësirave afariste dhe zyrave të avokatëve (*Niemietz kundër Gjermanisë*, §§ 29-33).

216. Në rastin *Larkos kundër Qipros* [GC], §§ 30-32, Gjykata ekzaminoi ankesat e parashtruesit të kërkesës lidhur me anulimin e marrëveshjes së tij të qirasë të cilën e kishte lidhur me shtetin e Qipros, në kuptim të Nenit 8 në ndërlidhje me Nenin 14 të Konventës. Ajo konstatoi se parashtruesi i kërkesës, shërbyes civil marrëveshja e qirambajtjes së të cilit kishte shumë tipare të qirambajtjes tipike të një prone, ishte diskriminuar në krahasim me qirambajtësit privatë. Në kuptim të këtyre konkluzioneve, nuk ishte e domosdoshme të ekzaminohej ndaras ankesa në bazë të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

217. *Karner kundër Austrisë* është një rast i rëndësishëm për të drejtat banesore sipas Nenit 14 në bashkëlidhje me Nenin 8 të Konventës. Ai ka të bëjë me trashëgiminë e një qiraje në kontekst të një marrëdhënieje homoseksuale. Duke theksuar se dallimi në bazë të orientimit seksual kërkon arsyetim të seriozitetit të veçantë, Gjykata konstatoi se është dashur të vërtetohet se është e domosdoshme që qiftet homoseksuale të përjashtohen nga fushëveprimi i legjislacionit për tu arritur qëllimi i mbrojtjes së njësisë familjare tradicionale. Në këtë rast u gjetën shkelje të Konventës (*po aty*, §§ 38-42). Konkluzion i ngjashëm është nxjerrë edhe në rastin *Kozak kundër Polonisë*, §§ 98-99, në kuptim të bashkëjetesës me një partner të të njëjtës gjini (për të kuptuar evoluimin e praktikës gjyqësore, krahasojë me rastin *S. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Vendim i Komisionit, dhe shih “*Qirambajtja e pronave*”).

218. Në rastin *Rousk kundër Suedisë*, §§ 115-127, shitja gjyqësore e shtëpisë së parashtruesit të kërkesës me qëllim të sigurimit të mjeteve për pagesë të tatimit për Shtetin dhe nxjerrja me forcë nga prona që pasoi përbënin shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 dhe të Nenit 8 sepse interesat e pronarit nuk ishin mbrojtur në mënyrë adekuate. E në të kundërtën, në rastin *Vaskrsić kundër Sllovenisë*, § 87, në të cilin shtëpia e parashtruesit të kërkesës ishte shitur në ankand publik me qëllim të përmbartimit të një kërkesë fillestare me vlerë prej 124 euro përbënte shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës. Sa i përket kuptimit më të përgjithshëm të balancimit mes së drejtës për të respektuar shtëpinë e individit dhe shitjes së detyruar të një shtëpie për qëllime të mbulimit të borxheve, shih rastin *Vrzić kundër Kroacisë*, §§ 63-68.

219. Në rastin *Gladysheva kundër Rusisë*, § 93, Gjykata konstatoi shkelje të të njëjtave dispozita për shkak të dështimit të autoriteteve lokale për të vlerësuar proporcionalitetin e masave financiare në momentin e largimit me forcë të një blerësi *bona fide* nga banesa e blerë me mashtrim nga pronari paraparak. Ajo gjithashtu specifikoi se margjina e vlerësimit të Shtetit në raste të së drejtës banesore është më e ngushtë në kuptim të të drejtave të Nenit 8, krahasuar me atë që ofrohet në mbrojtje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, marrë parasysh rëndësinë që duhet t’i kushtohet Nenit 8 në kuptim të identitetit, vetëvendosjes, integritetit fizik dhe moral, mbajtjes së marrëdhënieve me tjerët dhe vendosjes së sigurt në komunitet për secilin individ (*Connors kundër Mbretërisë së Bashkuar*, §§ 81–84; *Orlić kundër Kroacisë*, §§ 6370). Vlerësim i individualizuar i proporcionalitetit gjithashtu kërkohet në raste kur rrezikohet humbja e shtëpisë së parashtruesit të kërkesës pa marrë parasysh nëse sipas ligjeve të vendit të drejtat banesore të tij ose saj kanë marrë fund (*Ćosić kundër Kroacisë*, §§ 21-23), si dhe në raste të humbjes së shtëpisë si rrjedhojë e një vendimi për ta demoluar atë për shkak se është ndërtuar me dije duke shkelur rregulloret e planifikimit hapësinor (*Ivanova dhe Cherkezov kundër Bullgarisë*, § 53).

220. Në rastin *Berger-Krall dhe të tjerët kundër Sllovenisë*, §§ 205-211 dhe 272-275, reformat banesore pas kalimit në ekonomi të tregut dhe privimi i parashtruesve të kërkesave nga të drejtat e qirambajtjes së mbrojtur janë konsideruar edhe nën prizmin e Nenit 8 edhe të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Gjykata vlerësoi se, edhe pse privimi nga të drejtat e qirambajtjes së mbrojtur përbënin ndërhyje me të drejtën e respektimit të shtëpisë, në këtë rast nuk ka pasur shkelje të Nenit 8 sepse veprimi ka qenë proporcional me qëllimet legjitime të mëtuara. Faktorët e njëjtë e kanë shtyrë Gjykatën të konkludojë se as Neni 1 i Protokollit Nr. 1 nuk është shkelur. Ngjashëm, në rastin *Sorić kundër Kroacisë* (vendim), Gjykata konstatoi se në bazë të reformave të banimit, pozita e parashtruesit të kërkesës si qiramarrës vazhdonte të mbrohej fuqishëm. Megjithatë, Neni 1 i Protokollit Nr.1 nuk garantonte të drejtën e blerjes së pronës, por vetëm të posedimit paqësor të pronës ekzistuese. Në rastin *Galović kundër Kroacisë* ((vendim), § 65), Gjykata gjithashtu hodhi poshtë kërkesën në bazë të Nenit 8 të parashtruar nga një ish-bartës i të drejtave

të mbrojtura të qiramarrjes që ishte larguar me forcë nga vendbanimi nga pronari pasi që i ishte vënë në dispozicion vendbanim tjetër.

221. Në të njëjtën frymë, në rastin *Zrilić kundër Kroacisë*, § 71, Gjykata kishte konstatuar se urdhri gjyqësor për ndarjen e shtëpisë të cilën parashtuesja e kërkesës e kishte në bashkëpronësi me ish-bashkëshortin e saj dhe shitjen gjyqësore të saj nuk përbënte shkelje të Nenit 8 dhe rrjedhimisht nuk kishte nevojë për verifikim të mëtejshëm për të vërtetuar se nuk ka shkelje as në kuptim të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

222. Në rastin *Cvijetić kundër Kroacisë*, § 51, në të cilin parashtuesi i kërkesës nuk kishte mundur ta largojë ish-bashkëshortin nga banesa e cila përbënte shtëpinë e saj, u konstatua shkelje e neneve 6 dhe 8 për shkak të gjatësisë së procedurave përmbartimore. Nuk kishte nevojë për ekzaminim të ndarë nën prizmin e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

223. Neni 1 i Protokollit Nr. 1 nuk garanton të drejtën e gëzimit të “pronave” në një mjedis të këndshëm (shih *Flamenbaum dhe të tjerët kundër Francës*, § 184, që kishte të bëjë me zgjatjen e pistës së aeroportit, edhe nën nenin 8). Për më tepër, duke qenë se parashtuesit e kërkesës nuk kishin vërtetuar nëse zgjatja e pistës kishte ndikuar në vlerën e pronës së tyre, e nëse po në çfarë mase, Gjykata konstatoi se nuk ka shkelje të të drejtave të mbrojtura me këtë dispozitë (*po aty*, §§ 188-190).

224. Në rastet kur Gjykata ka konstatuar shkelje të Nenit 8 në bazë të pengesave të shkaktuara gjatë natës nga një bar (*Udovičić kundër Kroacisë*, § 159), ose nga mungesa e përgjigjes efektive nga autoritetet ndaj ankesave për shqetësime të vazhdueshme në lagje (*Surugiu kundër Rumanisë*, §§ 67-69), ajo ka vendosur se nuk është e nevojshme nëse rasti ka përbërë shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

225. Gjithashtu, Neni 7 dhe Neni 1 i Protokollit Nr. 1 janë të zbatueshme në rastet që kanë të bëjnë me shkatërrimin e vendbanimit të individit. Në rastin *Selçuk dhe Asker kundër Turqisë*, § 77, Gjykata kishte parasysh edhe mënyrën e qëllimtë të shkatërrimit të shtëpive të parashtuesve të kërkesave nga forcat e sigurisë dhe konstatoi shkelje të Neneve 3, 8 dhe Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Për më shumë detaje, shih kapitullin mbi Qirambajtjen dhe kontrollin e qirasë më poshtë.

7. Neni 10

226. Në rastin *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, §§ 59 dhe 63, parashtuesi i kërkesës ankohej për konfiskimin e matricës dhe qindra kopjeve të Librit Shkollor të Vogël të Kuq, dhe shkatërrimit të mëpasshëm të tyre në bazë të aktgjykimit të nxjerrë nga gjykata vendore. Gjykata konstatoi se qëllimi i konfiskimit ishte “mbrojtja e moralit” sipas të kuptuarit të autoriteteve kompetente britanike dhe vlerësimit të tyre. Konfiskimi dhe shkatërrimi i Librit Shkollor e privuan parashtuesin e kërkesës nga pronësia mbi “prona” të caktuara. Megjithatë, këto masa ishin autorizuar nga paragrafi i dytë i Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, i interpretuar në frymën e parimeve të së drejtës që janë të përbashkëta tek Shtetet Anëtare, sipas të cilave mallrat të cilat janë vlerësuar si të paligjshme apo rrezikshme për interesin publik konfiskohen me qëllim të asgjësimit të tyre. Prandaj, nuk ka pasur shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 apo të Nenit 10 të Konventës.

227. Në rastin *Öztürk kundër Turqisë* [GC], § 76, Gjykata vlerësoi se konfiskimi dhe shkatërrimi i kopjeve të një libri të publikuar nga botuesi i parashtuesit të kërkesës përbënte vetëm një aspekt të dënimit të tij për shpërndarje të propagandës separatiste (që duhej shqyrtuar sipas Nenit 10). Prandaj, nuk ishte i domosdoshëm shqyrtimi i konfiskimit ndaras sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

228. Në rastin *Ashby Donald dhe të tjerët kundër Francës*, § 40, Gjykata konstatoi se kur kemi të bëjmë me ndërhyrje me të drejtën për liri të shprehjes, Shtetet gëzojnë marginë më të gjerë të vlerësimit nëse masa financiare ka për qëllim mbrojtjen të drejtave tjera të Konventës, siç është e drejta e gëzimit paqësor të pronës, në këtë rast të një të drejte autoriale (*Neij dhe Sunde Kolmisoppi kundër Suedisë* (vendim)).

8. Neni 11⁶

229. Në rastin *Chassagnou dhe të tjerët kundër Francës* [GC], §§ 85 dhe 117, lidhur me anëtarësinë automatike të parashtruesve të kërkesës, pronarëve të tokave me sipërfaqe më të vogla se 20 hektarë që po kundërshtonin gjahun e shoqatave komunale dhe ndërkomunale të gjuetarëve dhe bartjen e të drejtave të gjuetisë tek këto shoqata, Gjykata konstatoi shkelje edhe të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 edhe të Nenit 11 të Konventës.

9. Neni 13

230. Për tu zbatuar Neni 13 i Konventës, parashtruesit e kërkesës duhet të kenë një kërkesë të “argumentueshme”. Në frymën afirmative ata duhet të kenë mjete juridike efektive dhe praktike në mënyrë që zgjidhin kërkesat e tyre dhe nëse kjo është e rrugës të marrin kompensim për humbjet e tyre.

231. Në rastin *Iatridis kundër Greqisë* [GC], § 65, që kishte të bëjë me dështimin e autoriteteve për t’ia kthyer kinemanë parashtruesit të kërkesës, Gjykata konstatoi se dallonte natyra e interesave të mbrojtur nga Neni 13 i Konventës me ato të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 duke qenë se i pari ofron mbrojtje procedurale “të drejtën për mjet juridik efektiv” ndërsa i fundit është ndihmës i qëllimit më të gjerë të sigurimit të respektimit të së drejtës për gëzim paqësor të pronave. Në këtë rast u konstatuan shkelje të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 dhe të Nenit 13.

232. Ngjashëm, në rastin *Öneryıldız kundër Turqisë* [GC], §§ 156-157, Gjykata konstatoi se ka shkelje të Nenit 13 të Konventës në kuptim të parashtrësës në lidhje me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1, lidhur me efektivitetin e procedurave administrative për kompensimin e shkatërrimit të mallrave shtëpiake si rezultat i eksplodimit të gazit metan në një deponi. Në anën tjetër, në rastin *Budayeva dhe të tjerët kundër Rusisë*, §§ 196-198, ku dëmi ishte shkaktuar në masë të gjerë si rezultat i një katastrofe natyrore, nuk u gjet shkelje e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 dhe Nenit 13 në bashkëlidhje me atë nen, duke marrë parasysh se parashtruesit e kërkesës kishin pasur mundësinë e parashtrimit të kërkesës për dëme dhe e njëjta ishte ekzaminuar nga gjykatat kompetente ndërsa Shteti kishte realizuar masa përkrahëse përmes një skeme të përgjithshme të përkrahjes për rastet emergjente.

233. Nën kornizën e restitucionit të pronave në dobi të ish-pronarëve në rastin *Driza kundër Shqipërisë*, §§ 115-120, u konstatua shkelje e Nenit 13 në bashkëlidhje me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1, për shkak të dështimit për të krijuar një skemë adekuate të restitucionit, në veçanti në kuptim të organeve dhe procedurës.

234. Edhe në rastin *Chiragov dhe të tjerët kundër Armenisë* [GC], §§ 213-215, dhe *Sargsyan kundër Azerbajxhanit* [GC], §§ 269-274, mungesa e një mjeti juridik në dispozicion për të kërkuar shqyrtim të ankesave të parashtruesve të kërkesës lidhur me Konventën për rastin që kishte të bëjë me humbjen e shtëpive dhe pronave të tyre gjatë konfliktit mes Armenisë dhe Azerbajxhanit në Nagorno-Karabakh dhe sigurimi i prospektit për sukses gjithashtu përbënte shkelje të nenit 13 të Konventës.

10. Neni 14⁷

235. Ndalimi i diskriminimit nën Nenin 14 mund të kërkohej në lidhje me një nga të drejtat tjera substanciale të mbrojtura me Konventë.

236. Në rastet që kanë të bëjnë me ankesa nën Nenin 14 në ndërlidhje me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1, ku parashtruesve të kërkesave u janë mohuar pronat (në tërësi apo pjesërisht) apo një pasuri e caktuar si rrjedhojë e diskriminimit nga i cili mbron Neni 14, testi relevant është të vlerësohet baza e diskriminimit të cilën e pretendon parashtruesi i kërkesës dhe nëse ai ose ajo do të kishte të drejtën sipas të drejtës vendore mbi pasurinë në fjalë në mungesë të diskriminimit (*Fabris kundër Francës* [GC], § 52).

⁶ Shih *Udhëzuesin për Nenin 11 (Liria e tubimit dhe organizimit)*.

⁷ Shih *Udhëzuesin për Nenin 14 (Ndalimi i diskriminimit)*.

237. Edhe pse fushëveprimi i autorizimeve të Shtetit sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 në disa instanca mund të jetë i gjerë, këto autorizime nuk mund të ushtrohen në mënyrë diskriminuese.

238. Diskriminimi i fëmijëve jolegjitim ishte temë trajtimi në rastin revolucionar *Marckx kundër Belgjikës*, § 65. Gjykata vendosi se parashtuesja e kërkesës, si nënë e pamartuar, u diskriminua në kuptim të disponimit të papenguar të pronës në krahasim me një nënë të martuar. Nuk u konstatua shkelje e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 si e tillë sa i përket nënës, ndërsa i njëjti nen u konsiderua si i pazbatueshëm në rastin e vajzës.

239. Ngjashëm, në rastin *Mazurek kundër Francës*, § 54, një ligj që zvogëlonte masën e trashëgimisë së pagueshme për një fëmijë nga një lidhje jashtëmartesore u konstatua se diskriminon në mënyrë të pajustificueshme fëmijët e tillë në ushtrimin e të drejtave pronësore të tyre, edhe pse “mbrojtja e familjes tradicionale” u konsiderua si qëllim legjitim i ndjekur nga Shteti (*Fabris kundër Francës* [GC], §§ 68-72; sa i përket të drejtës së trashëgimit shih edhe, *Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], § 65, për motra bashkëjetuese; sa i përket rritjes së pensioneve për jobanuesit, *Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], § 90; dhe sa i përket të drejtave për pension të bashkëshortit mbijetues për një të vejë që vinte nga një martesë fetare, *Şerife Yiğit kundër Turqisë* [GC], § 86).

240. Dallimi në trajtim i vuajtur nga parashtuesi i kërkesës, si përfitues i një testamenti të hartuar në pajtim me Kodin Civil nga një testamentlënës i fesë myslimane krahasuar me një përfitues nga një testament i nxjerrë në pajtim me Kodin Civil nga një testamentlënës jo i fesë myslimane, nuk kishte kurrfarë justifikimi objektiv dhe të arsyeshëm (*Molla Sali kundër Greqisë* [GC], § 161).

241. E kundërta e kësaj, në rastin *Stummer kundër Austrisë* [GC], §§ 132-136, refuzimi për të marrë parasysh punën e kryer në burg në kalkulimin e të drejtave pensionale nuk përbënte shkelje të Nenit 14 në ndërlidhje me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (shih më lartë kapitullin për Nenin 4).

242. Në rastin *Chabauty kundër Francës* [GC], § 47, mosofrimi i mundësisë së njëjtë për pronarët e parcelave të vogla sikur për pronarët e parcelave të mëdha për të larguar tokat nga kontrolli i shoqatës së gjuetarëve përveç bazës etike nuk ka përmbajtur ndonjë shkelje të Nenit 14 në ndërlidhje me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (krahaso me *Chassagnou dhe të tjerët kundër Francës* [GC], § 95).

243. Rasti *Guberina kundër Kroacisë* kishte të bëjë me refuzimin e lehtësirave tatimore për blerjen e një shtëpie pas shitjes së banesës, me qëllim të akomodimit të nevojave të një fëmije me paaftësi të rëndë mbi bazën e asaj që banesa e cila është shitur ka plotësuar nevojat e familjes së saj, duke qenë mjaftueshëm i madh dhe i pajisur me infrastrukturën e nevojshme si energji elektrike, ngrohje, etj. Autoritetet tatimore nuk kanë marrë fare në konsideratë thirrjet e familjes që kujdesej për një fëmijë me paaftësi të rëndë në një banesë pa ashensor. Parashtuesja e kërkesës ankohej se mënyra e aplikimit të legjislacionit tatimor në situatën e familjes së saj përbënte diskriminim, marrë parasysh paaftësinë e fëmijës së saj. Shkelja u konstatua në thelb për shkak të dështimit të autoriteteve për të marrë parasysh kontekstin më të gjerë dhe obligimet që ndërlidhen me aftësitë e kufizuara, që ka rezultuar me aplikimin e një qasjeje tejet kufizuese dhe mekanike ndaj interpretimit të legjislacionit tatimor, në dëm të situatës konkrete të kësaj familjeje (*po aty*, § 98).

244. Rasti *J.D. dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, §§ 97 dhe 101-105, kishte të bëjë me ankesën e parashtuesve të kërkesës, të dy banorë në shtëpi të adaptuara, se rregullat e reja për beneficione banesore në sektorin e banimit social (i njohur me termin “tatimi për dhomë të fjetjes”) i diskriminonte ata për shkak të situatave të tyre të veçanta: parashtuesi i parë kujdesej për vajzën me aftësi të kufizuara ndërsa parashtuesi i dytë ishte viktime e dhunës në familje i vendosur në vendbanim si pjesë e “Skemës Strehuese”. Masa në fjalë rezultoi me zvogëlim të subvencionit për qira nëse banorët kishin më shumë dhoma të fjetjes se sa që kishin të drejtë t’i kenë, me qëllim të nxitjes së kalimit të tyre në shtëpi më të vogla. Gjykata theksoi se jashtë kontekstit të masave tranzitore që kishin për qëllim korrigjimin e pabarazive historike, marrë parasysh nevojën për të parandaluar diskriminimin e personave me aftësi të kufizuara dhe stimuluar pjesëmarrjen dhe integrimin e tyre të plotë në shoqëri, margjina e vlerësimit që Shtetet gëzojnë në përcaktimin e trajtimit të ndryshëm ligjor për persona me aftësi të kufizuara ngushtohet në masë të konsiderueshme. Ajo vlerësoi se në rastet kur diskriminimi i pretenduar ushtrohej në bazë të paaftësisë dhe gjinisë dhe nuk rezulton nga një masë tranzitore e realizuar në mirëbesim me

qëllim të korigjimit të ndonjë pabarazie, arsyet që mund të justifikojnë masën financiare duhet të jenë vërtetë shumë me peshë. Gjykata konkludoi se pagesat e bëra nën skemën e Pagesave Diskrecionale për Banim (DHP), të cilat mund të mbulojnë pamundësitë në pagim të qirasë, ia bëjnë të qartë se dallimi në trajtim në rastin e parashtruesit të parë është i justifikuar. Megjithatë, në rastin e parashtruesit të dytë nuk ishte kështu: ajo ishte pjesë e një skeme tjetër që kishte për qëllim t'u mundësojë viktimave të dhunës në familje që të qëndrojnë nëpër shtëpitë e tyre dhe pagesat nën DHP nuk und ta zgjidhin konfliktin mes këtij qëllimi dhe qëllimit të 'tatimit në dhomë të fjetjes' që kishte për synim ta nxitë atë ta ndërrojë vendbanimin.

245. Në rastin *Andrejeva kundër Letonisë* [GC], § 88, ku dallimi ishte bërë në bazë të kombësisë, u konstatua shkelje e Nenit 14 në bashkëlidhje me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1, për shkak se gjykatat letoneze refuzonin t'ia ndanin parashtrueses së kërkesës pensionin e stazhit të fituar me punësim në ish-Bashkimin Sovjetik para vitit 1991 për shkak se ajo nuk kishte kombësi letoneze.

246. Në rastin *Fábián kundër Hungarisë* [GC], Gjykata vlerësoi se kishte dallime substanciale ligjore dhe faktike mes punësimit në sektorin publik dhe atë privat për arsye institucionale dhe funksionale, siç janë burimi i pagave, fakti që ligjet vendore i trajtojnë si punësime të ndryshme, se profesioni i parashtruesit të kërkesës në sektorin publik vështirë mund të krahasohej me çfarëdo profesioni në sektorin privat, dhe se i mbetej Shtetit si punëdhënës i tij të përcaktojë kushtet e punësimit dhe si menaxher i fondit pensional kushtet e pagesës së pensioneve (*po aty*, §§ 131-132; *Panfile kundër Rumanisë* (vendim), § 28). Në një tjetër rast, Gjykata kishte konstatuar se dallimi në trajtim të pensionistëve të kategorive të ndryshme brenda sektorit publik ishte i justifikuar (*Gellérthegeyi dhe të tjerët kundër Hungarisë* (vendim), §§ 34-40).

III. Çështjet specifike

A. Qirambajtësit dhe kontrolli i qirasë

247. Konventa dhe protokollet saj nuk garantojnë të drejtën e akomodimit dhe banimit dhe shumë raste lidhur me të drejtat e banimit janë ekzaminuar nën Nenin 8 të Konventës që rregullon mbrojtjen e të drejtës së parashtruesve të kërkesave për jetë private dhe familjare (shih nënkapitullin mbi Nenin 8 më sipër). Në Nenin 1 të Protokollit Nr. 1, organet e Konventës kanë trajtuar një numër të madh të rasteve lidhur me baraspeshimin mes të drejtave të pronarëve dhe atyre të qirambajtësve sipas ligjeve kombëtare, garancitë për gjykim të drejtë në relacionet mes pronarëve dhe qirambajtësve dhe garancitë e këtyre të fundit për moslargim të detyruar, mosdiskriminim, etj.

248. Rasti i parë i balancimit mes të drejtave pronësore të pronarëve dhe atyre të qirambajtësve është rasti *James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*. Ky rast kishte të bëjë me të drejtat e qirambajtësve sipas kontratave të qirasë për periudhë mbi njëzetvjeçare për të fituar pronësi të plotë mbi pronat, pas miratimit të Ligjit të Reformës së Qirave. Parashtruesit e kërkesave ishin emëruar si përfitues të një trashëgimie substanciale të lënë me testament nga një anëtar i aristokracisë. Qirambajtësit e disa prej pronave të cekura ushtruan të drejtat e tyre të blerjes sipas Ligjit të Reformës së Qirave, duke ua privuar trashëgimtarëve interesin pronësor të tyre. Këta të fundit u ankuan dhe thanë se transferi i detyruar i pronave dhe vlera e kompensimit të cilën ata e kanë pranuar për këtë qëllim i shkelnin të drejtat e tyre.

249. Gjykata e konsideroi të natyrshme që margjina e vlerësimit në dispozicion të legjislaturës në zbatimin e politikave sociale dhe ekonomike duhet të jetë e gjerë, dhe se do ta respektojë gjykimin e legjislaturës lidhur me atë se çka është "në interes publik" përveç nëse aktgjykimi është dukshëm pa bazë të arsyeshme (*James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 46). Ajo konstatoi se zbutja e padrejtësive sociale në fushën e banimit përbënte qëllim legjitim të Ligjit për Reformën e Qirave, që binte brenda marginës së vlerësimit të legjislaturës. Sa i përket proporcionalitetit të masave të zbatuara nga Shteti, Gjykata konstatoi se sigurimi i të drejtës së blerjes së pronave për qirambajtësit në këto rrethana nuk ishte as e paarsyeshme as joproporcionale, pasi që ligji e kufizonte këtë të drejtë vetëm për pronat

me vlerë më të ulët të cilat sipas ligjvënësve përbënin rastet më të rënda që duhet ndihmuar (*po aty*, § 70; për Nenin 14 të Konventës, § 77).

250. Ngjashëm, në rastin *Mellacher dhe të tjerët kundër Austrisë*, pronarët ose ata që kanë pasur interesa pasurorë në disa ndërtesa të banesave kolektive u ankuan se me vendosja e uljeve ligjore të qirasë sipas Ligjit të Qirave shkelte Nenin 1 të Protokollit Nr. 1. Gjatë vlerësimit të legjislacionit të sfiduar, Gjykata ia njohu legjislaturës margjinën e gjerë të vlerësimit edhe në identifikimin e problemit që përbënte brengë publike edhe në përcaktimin e masave të nevojshme për t'i zbatuar politikat sociale dhe ekonomike që ishin miratuar për ta adresuar problemin, që në këtë rast ishin të ndërlidhura me të drejtat banesore. Gjykata vlerësoi se ishte e arsyeshme për ligjvënësit austriakë të konstatojnë se drejtësia sociale kërkon uljen e qirave fillestare dhe se ulja e qirave të bëhet përmes ligjit dhe se ky veprim nuk ka vënë domosdoshmërisht barrë joproporcionale mbi pronarët (*po aty*, § 57). Për më tepër, në kontekst të kontrollit të qirave, por kur objekti i qirasë ishte një godinë e shfrytëzuar nga një bend muzikor, Gjykata vlerësoi se roli kulturor dhe social i klubit ishte në interes publik; megjithatë, shkalla e rëndësisë ishte dukshëm më e ulët se sa në rastet tjera prandaj nuk justifikonte ulje aq të ulët në krahasim me vlerën në tregun e lirë (*Bradshaw dhe të tjerët kundër Maltës*, § 58).

251. Në anën tjetër, në një rast rishtas, *Lindheim dhe të tjerët kundër Norvegjisë*, ndryshimet e Ligjit për Qiranë e Tokave u jepnin qiramarrësve të tokave të shfrytëzuara për shtëpi të përhershme ose të pushimeve të drejtën e zgjatjes së qirave të tyre në kushte të njëjta me kontratat paraprake për një periudhë të pakufizuar kohore. Qiramarrësit kërkuan që pronarët e tyre t'ua zgjasin kontratat e qirasë nën të njëjtat kushte, pa rritje të qirasë. Gjykata konstatoi se qëllimi i mëtuar nga legjislacioni, do të thotë të mbrojtë interesat e qirambajtësve që nuk kishin mjete financiare, ishte legjitim pasi që me largimin e masave të kufizimit të qirasë në vitin 2002 substancialisht ishin prekur shumë qirambajtës të papërgatitur të cilëve u ishte rritur drastikisht qiraja për tokat në shfrytëzim. Megjithatë, sa i përket proporcionalitetit të masës, Gjykata konstatoi se për shkak të imponimit të zgjatjes së afatit për kontratat e qirasë për periudhë të pacaktuar pa u dhënë pronarëve mundësi të rritjes së qirave, vlera e tokave nuk do të jetë relevante sipas vlerësimit të nivelit të qirave për to. Për më tepër, vetëm qiramarrësit kishin mundësinë e ndërprerjes së marrëdhënies së qiramarrjes dhe ishin të lirë t'ia bartin kontratat e qiramarrjes palëve të treta, dhe çdo ndryshim i pronësisë së të drejtave të qirambajtjes nuk do ta ndryshonte nivelin e qirasë së paguar, pasi që kontrolli i nivelit të qirasë do të mbestë në fuqi për afat të pacaktuar. Këta faktorë efektivisht i privonin pronarët nga çfarëdo gëzimi i pronave të tyre, përfshirë mundësinë e disponimit me to sipas vlerave të tregut. Si pasojë, Gjykata konstatoi se barra financiare dhe sociale është vënë vetëm mbi supet e qiradhënësve dhe se legjislacioni shkelte të drejtat e pronarëve për të mbrojtur pronën e tyre (*po aty*, §§ 128-134).

252. Në rastin *Edwards kundër Maltës*, Gjykata kishte konstatuar shkelje për shkak të kufizimeve të vëna mbi gëzimin e të drejtave pronësore të parashtruesit të kërkesës. Banesa shumëkatëshe e tij dhe fusha ngjitur por merreshin nga Qeveria për të siguruar banim për persona të pastrehë. Pronari u ankua se është privuar nga prona e tij për pothuajse 30 vite dhe se qiraja që kishte marrë në kompensim ishte tejet e ulët në krahasim me normat e tregut. Gjykata vlerësoi se marrja e pronës nga Shteti përbënte një marrëdhënie jovullnetare mes pronarit dhe qirambajtësit i cili nuk kishte kurrfarë ndikimi mbi përzgjedhjen e qirambajtësit apo mbi kushtet e qirasë. Për më tepër, niveli i qirasë së fiksuar si kompensim nuk ishte i mjaftueshëm për përmbushur interesin legjitim të pronarit që është nxjerrja e fitimit nga prona Prandaj, marrja e pronës kishte imponuar një barrë joproporcionale dhe të rëndë mbi pronarin i cili u detyruar që të bartë barrën e kostos sociale dhe financiare për ofrimin e banimit për të tjerët (*po aty*, § 78).

253. Në rastin *Immobiliare Saffi kundër Italisë* ([GC], § 56), dhe shumë raste tjera të mëposhme, Gjykata kishte konstatuar shkelje të nenit 1 të Protokollit Nr. 1 për shkak të pritjeve tejet të gjata për largimin e detyruar e qirambajtësve (nën Nenin 6 të Konventës, *Edoardo Palumbo kundër Italisë*, §§ 45-46). Në një rast të ngjashëm që kishte të bëjë me mungesën e garancive përkatëse për gjykim të drejtë, *Amato Gauci kundër Maltës*, § 63, në të cilin pronari nuk mund ta kthente shtëpinë në posedim pas skadimit të kontratës së qirasë dhe ishte i pakënaqur që nuk arrinte të marrë një qira adekuate nga ajo, Gjykata vlerësoi se kishte shkelje të Neni 1 të Protokollit Nr. 1.

254. Sa u përket garancive të qirambajtësve nga largimi me forcë, në rastin *Connors kundër Mbretërisë së Bashkuar*, §§ 81-84, në të cilin trajtohej mënyra cigane e jetesës, dhe *McCann kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 53, me të cilin Gjykata përcaktoi parimin e Nenit 8 të Konventës se çdo person në rrezik që të humbasë shtëpinë e vet duhet të ketë mundësinë që të kërkojë vlerësimin e proporcionalitetit të masës nga një tribunal i pavarur edhe nëse e drejta e banimit ka skaduar sipas ligjeve kombëtare. Në rastin *Connors kundër the Mbretërisë së Bashkuar*, § 100, nuk u konstatua se mund të ketë shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

255. Në rastin *Ivanova dhe Cherkezov kundër Bullgarisë*, autoritetet vendore kishin urdhëruar rrënimin e një shtëpie në të cilin parashtuesit e kërkesës, një çift i pamartuar më i vjetër, kishin jetuar për shumë vite, për shkak se e njëjta ishte ndërtuar pa leje të ndërtimit. Gjykata konstatoi se parashtuesit e kërkesës nuk kishin pasur në dispozicion procedurë që do t'u mundësonte rishikim të duhur të proporcionalitetit të rrënit të metuar të shtëpisë në të cilën kanë jetuar bazuar në rrethanat personale të tyre dhe se do të ishte në kundërshtim me Nenin 8 nëse rrënimi do të realizohej pa rishikim të tillë (*po aty*, §§ 61-62). Megjithatë, nuk u konstatua shkelje e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, duke qenë se shtëpia ka qenë e ndërtuar me dije pa leje dhe rrjedhimisht në shkelje flagrante të rregulloreve të vendit për ndërtimin (*po aty*, § 75).

256. Parimi i përgjithshëm i krijuar nga Komisioni në rastin *Durini kundër Italisë* se e drejta për të jetuar në një pronë që nuk është pronësi e parashtuesit të kërkesës nuk përbën “pronë” brenda kuptimit të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës, është ndjekur nga Gjykata në rastin *J.L.S. kundër Spanjës* (vendim), në të cilin parashtuesi i kërkesës, ushtar i rregullt, kishte marrë në shfrytëzim vendbanim ushtarak në Madrid, duke nënshkruar një formular të veçantë administrativ dhe jo një marrëveshje të qirasë, si dhe në disa raste tjera që kishin të bëjnë me transformimin dhe ndryshimin e kushteve nga shtetet socialiste në shtete me ekonomik të tregut (*Kozlovs kundër Letonisë* (vendim), *Kovalenok kundër Letonisë* (vendim); *H.F. kundër Sllovakisë* (vendim); *Bunjevack kundër Sllovenisë* (vendim)).

257. Në një sërë rastesh që përfshijnë mospërmbarimin e aktgjykimeve të formës së prerë të cilat u bartin prona të Shtetit ose të drejta pronësore parashtuesve të kërkesave, kryesisht kundër Rusisë, Gjykata ka rikujtuar se “kërkesa” mund të përbëjë “pronë” brenda kuptimit të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, nëse vërtetohet se janë të përmbarueshme. Gjykata ka vlerësuar se me marrjen e aktgjykimeve të përmbarueshme me të cilat parashtuesve të kërkesave u jepet e drejta e banimit, përcjellë me të ashtuquajturat “marrëveshje për banim social” apo forma tjera që vërtetohet në drejtën e tyre të banimit, palët kishin krijuar “pritje legjitime” se do ta fitojnë pasurinë në fjalë. Shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 janë konstatuar në rastet *Teteriny kundër Rusisë*, §§ 48-50; *Malinovskiy kundër Rusisë*, §§ 44-46; *Ilyushkin dhe të tjerët kundër Rusisë*, §§ 49 dhe 58, *Akimova kundër Azerbajxhanit*, §§ 40-41; *Gerasimov dhe të tjerët kundër Rusisë*, §§ 182-83; *Kukalo kundër Rusisë*, § 61; *Sypchenko kundër Rusisë*, § 45. Për më tepër, në rastin *Olaru dhe të tjerët kundër Moldavisë*, §§ 54-57, Gjykata vlerësoi se pamundësia e autoriteteve lokale publike që t'i përmbahen aktgjykimeve të formës së prerë që i urdhërojnë ato t'u sigurojnë banim social parashtuesve të kërkesës përbënte një problem sistematik.

258. Në rastin *Tchokontio Happi kundër Francës*, §§ 59-61, Gjykata bërë dallimin mes faktit në fjalë dhe rasteve të lartpërmendura *Teteriny kundër Rusisë* dhe *Olaru dhe të tjerët kundër Moldavisë*. Duke u bazuar në linjën e jurisprudencës (shih kapitullin mbi Zbatueshmërinë e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 – “pronat”) të krijuar në rastet *Durini kundër Italisë* (vendim) dhe *J.L.S. kundër Spanjës* (vendim), Gjykata konstatoi se vendimi përfundimtar nuk kërkonte nga autoritetet që të bartin pronësinë mbi banesën tek parashtuesi i kërkesës por që t'ia vë një në dispozicion. Megjithatë, nuk kishte asnjë obligim ligjor mbi autoritetet që ta shesin atë. Rrjedhimisht, parashtuesja e kërkesës nuk kishte pritje legjitime që të fitojë etë pasuri financiare dhe ankesa e saj në bazë të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 u refuzua si e pabazë nga këndvështrimi *ratione materiae* (edhe pse u konstatua shkelja e Nenit 6).

259. Për më tepër, në disa raste Gjykata ka trajtuar situata që rridhnin nga sistemi i “qirambajtjes speciale të mbrojtur” në ish-Jugosllavi i cili kishte disa tipare specifike në krahasim me qiramarrjen e rëndomtë. Shtetet që u krijuan nga Jugosllavia kishin miratuar zgjidhje të ndryshme ligjore përgjithësisht duke transformuar “qirambajtjen speciale të mbrojtur” në një shkallë tjetër të qirambajtjes së mbrojtur. Në rastin *Blečić kundër Kroacisë* [GC], § 92, dhe *Berger-Krall dhe të tjerët kundër Sllovenisë*, § 135, Gjykata

nuk e kishte konsideruar të domosdoshme të vendosë nëse “qirambajtja speciale e mbrojtur” përbënte “pronë” pasi që rastet u hodhën poshtë në baza tjera.

258. Në rastin *Gaćeša kundër Kroacisë* (vendim), Gjykata konstatoi se për shkak që Kroacia e kishte ndërprerë sistemin e qirambajtjes sociale të mbrojtur para ratifikimit të Konventës ajo nuk është detyruar të përkufizojë nëse qirambajtja e tillë mund të konsiderohet si “pronë” e mbrojtur nga Neni 1 i Protokollit Nr. 1. Në rastin *Mago dhe të tjerët kundër Bosnjë e Hercegovinës* Gjykata konstatoi se “qirambajtja speciale e mbrojtur” përbën “pronë” sepse në Bosnjë e Hercegovinë qirambajtësit e tillë si rregull kishin të drejtë të kthehen në banesat e tyre të paraluftës dhe më pas t’i blejnë ato me kushte të favorshme. Gjykata bërë dallimin mes këtij rasti dhe atij *Gaćeša kundër Kroacisë* (vendim) mbi bazën e faktit që në Kroaci qirambajtësit specialë të mbrojtur nuk kishin qenë në gjendje t’i blejnë banesat e tyre para ratifikimit të Konventës dhe Protokolleve të saj nga Kroacia.

259. Në rastin që më pas u shfrytëzua si standard *Hutten-Czapska kundër Polonisë* [GC], Gjykata për herë të parë trajtoi situatën nga ana tjetër e medaljes – ajo e të drejtave të pronarëve të shpronësuar nën regjimin e kaluar të cilëve pronat u ishin kthyer por ankoheshin për skemat e kontrollit të qirasë. Nga atëherë, Gjykata ka trajtuar edhe raste tjera të ngjashme, si *Bittó dhe të tjerët kundër Sllovakisë*, *Statileo kundër Kroacisë*, dhe *R & L, s.r.o. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*. Në përgjithësi, kontrolli i qirasë është miratuar nga Shtetet anëtare pas rënies së regjimit paraparak. Qirambajtësit e banesave në këto prona, të cilëve u janë njohur të drejtat e privileguara të qirambajtjes, u lejuan që të qëndrojnë në banesa pas rënies së regjimit të kaluar, ndërsa Shtetet e rregulluan lartësinë e qirasë, zakonisht nën çmimin e tregut. Në të gjitha rastet e sipërpërmendura Gjykata vlerësoi se pronarët janë detyruar të bartin barrë joproporcionale dhe konstatoi shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (për krahasim, në rrethana tjera ekonomike dhe sociale, shih rastet *James dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* dhe *Mellacher dhe të tjerët kundër Austrisë*).

260. Ngjashëm, në rastin *Radovici dhe Stănescu kundër Rumanisë*, pronarët e apartamenteve u ofruan kontrata të reja të qirasë banorëve të tyre, të cilët më parë kishin kontrata të qirasë me Shtetin. Banorët nuk pranuan të nënshkruajnë kontratat e qirasë të propozuara nga pronarët. Pronarët më pas kërkuar urdhra të largimit të detyruar nga pronat e tyre, të cilët dështuan për shkak se pronarët nuk iu përmbajtën formaliteteve ligjore. Pasojë tjetër e kësaj ishte zgjatja automatike e kontratave të qirasë. Në këtë rast u konstatua shkelje e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

B. Rastet e mirëqenies sociale

263. Komisioni dhe Gjykata kanë trajtuar një sërë rastesh lidhur me lloje të ndryshme të beneficioneve dhe sigurimeve sociale, përfshirë të drejtat për pension. Për të gjetur një rekapitullim të praktikës gjyqësore relevante, shihni rastet *Bélané Nagy kundër Hungarisë* [GC], §§ 80-89, *Yavaş dhe të tjerët kundër Turqisë*, §§ 39-43.

264. Sa u përket të drejtave pensionale, Neni 1 i Protokollit Nr. 1 nuk garanton asnjë drejtë të pensionit në një vlerë të caktuar (mes autoriteteve tjera *Skórkiewicz kundër Polonisë* (vendim); *Janković kundër Kroacisë* (vendim); *Kuna kundër Gjermanisë* (vendim); *Lenz kundër Gjermanisë* (vendim); *Blanco Callejas kundër Spanjës* (vendim); *Kjartan Ásmundsson kundër Islandës*, § 39; *Apostolakis kundër Greqisë*, § 36; *Wieczorek kundër Polonisë*, § 57; *Poulain kundër Francës* (vendim); *Maggio dhe të tjerët kundër Italisë*, § 55; *Valkov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, § 84). Ngjashëm, neni në fjalë garanton të drejtën e pensionit të moshës si të tillë (*Aunola kundër Finlandës* (vendim); *Da Silva Carvalho Rico kundër Portugalisë* (vendim), § 30).

265. Sa i përket obligimit për të qenë pjesë e një skeme të pensionit të moshës, në rastin *Ackermann dhe Fuhrmann kundër Gjermanisë* (vendim), Gjykata ka vlerësuar nëse kontributet e obligueshme vendosnin një barrë të tepërt mbi parashtruesit e kërkesës dhe e shpalli rastin të pabazuar. Ajo mori parasysh faktin që kontributet përbënin rreth 19 për qind të të hyrave bruto të tyre dhe paguheshin në vlera të barabarta mes parashtruesve të kërkesave dhe punëdhënësve.

266. Fakti që beneficionet e sigurimit social mund të zvogëlohen apo të mos vazhdojnë nuk ua përjashton atyre statusin e “pronës” në kuptim të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, së paku deri në momentin

e revokimit të tyre (*Moskal kundër Polonisë*, § 40; shih edhe kapitullin për Zbatueshmërinë e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 – “pronat”). Gjykata ka pranuar mundësinë e zbritjes së përfitimeve të sigurimit social në disa rrethana. Duke vendosur mbi proporcionalitetin e masave të tilla, Gjykata ka marrë parasysh faktorët në vijim: qëllimin e zbritjes; nëse autoritetet kanë mëtuar të kufizojnë ndonjë humbje që ndërlidhej me skemën e sigurimit social; se parashtruesit e kërkesës kishin vazhduar të marrin pensionet e moshës; se ata nuk ishin diskriminuar apo vënë në pozitë më të pavoritshme se sa pensionistët në skemën e rëndomtë; se masat nuk kishin pasur efekt retroaktiv; dhe se kohëzgjatja e shërbimit të parashtruesve të kërkesave ishte marrë parasysh gjatë kalkulimit të periudhave të kontributit të tyre (*Yavaş dhe të tjerët kundër Turqisë*, §§ 47-50). Fakti se një person ka hyrë në sistemin e sigurimit social të Shtetit dhe është bërë pjesë e tij, edhe pse në formë të detyruar, nuk nënkupton domosdoshmërisht se sistemi nuk mund të ndryshohet, qoftë në kuptim të kushteve që duhet plotësuar për pagesë apo proporcionit të këtij beneficioni ndaj pensionit (*Richardson kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim), § 17; *Carson dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], §§ 85-89).

267. Megjithatë, në rastet kur beneficionet zvogëlohen ose ndalen, kjo zakonisht përbën ndërhyrje me “prona” që kërkon justifikim në interes të përgjithshëm (*Kjartan Ásmundsson kundër Islandës*, §§ 39-40; *Rasmussen kundër Polonisë*, § 71; *Moskal kundër Polonisë*, §§ 51 dhe 64; *Grudić kundër Serbisë*, § 72; *Hoogendijk kundër Holandës* (vendim); *Valkov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, § 84; *Philippou kundër Qipros*, § 59).

268. Për Gjykatën, një konsideratë e rëndësishme është të shihet nëse të drejtat e parashtruesit të kërkesës për të përfituar nga skema e sigurime sociale janë shkelur asisoj që të ketë dëmtoar në esencë të drejtat pensionale të tij apo saj (*Domalewski kundër Polonisë* (vendim); *Kjartan Ásmundsson kundër Islandës*, § 39; *Wieczorek kundër Polonisë*, § 57; *Rasmussen kundër Polonisë*, § 75; *Valkov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, §§ 91 dhe 97; *Maggio dhe të tjerët kundër Italisë*, § 63; *Stefanetti dhe të tjerët kundër Italisë*, § 55). Sa i përket analizës së proporcionalitetit (*Da Silva Carvalho Rico kundër Portugalisë* (vendim), § 42), Gjykata ka vlerësuar në përgjithësi se privimi i plotë nga pensioni ka gjasa të përbëjë shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (*Stefanetti dhe të tjerët kundër Italisë*, § 59; *Apostolakis kundër Greqisë*, § 41) dhe se, në anën e kundërt, imponimi i një uljeje të cilën e konsideron të jetë e arsyeshme dhe proporcionale jo domosdoshmërisht përbën shkelje (*Da Silva Carvalho Rico kundër Portugalisë* (vendim), § 42; *Arras dhe të tjerët kundër Italisë*, § 82; *Poulain kundër Francës* (vendim); *Philippou kundër Qipros*, § 68; *Bélané Nagy kundër Hungarisë* [GC], § 117).

269. Megjithatë, testi i balancit të drejtë në kontekst të sigurimeve sociale që kryhet nga Gjykata nuk bazohet vetëm në vlerën apo përqindjen e humbjes së pësuar në abstrakt. Gjykata ekzaminon të gjitha elementet relevante të sfondit specifik të rastit (*Bélané Nagy kundër Hungarisë* [GC], § 117 dhe *Stefanetti dhe të tjerët kundër Italisë*, § 59). Faktorët specifikë relevantë për vlerësimin e proporcionalitetit të një ndërhyrjeje në fushën e sigurimeve sociale përfshijnë ato të natyrës diskriminuese dhe të gjitha humbjet e të drejtave (*Kjartan Ásmundsson kundër Islandës*, § 43); çfarëdo arbitrariteti apo kushti (*Klein kundër Austrisë*, § 55); mirëbesimin e parashtruesit të kërkesës (*Moskal kundër Polonisë*, § 44; *Čakarević kundër Kroacisë*, §§ 60-65).

270. Rëndësia e masave mbrojtëse procedurale për vlerësimin e baraspeshës së drejtë në kontekst të të drejtave të sigurimit shoqëror ilustron faktin se shkelja e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 ishte konstatuar në një rast ku vendimi për të ndarë beneficione të sigurimit për parashtruesin e kërkesës ishte anuluar në bazë të rivlerësimit të dosjes të parashtruesit të kërkesës të paraqitur fillimisht (*Moskal kundër Polonisë*, § 56).

271. Në raste të pezullimit të beneficioneve, disponueshmëria e një periudhe tranzitore kur personat që e gëzojnë këtë drejtë mund t’i përshtaten skemës së re është një nga faktorët e proporcionalitetit që u shkon për shtati Shteteve të paditura (*Lakićević dhe të tjerët kundër Malit të Zi dhe Serbisë*, § 72; *Moskal kundër Polonisë*, § 74, në të cilat parashtruesi i kërkesës është përballur përnjëherë me humbje të gjithmbarshme të pensionit të ndarë për pension të parakohshëm, edhe pse përbënte të vetmin burim të të hyrave dhe parashtruesja kishte gjasa shumë të vogla për t’iu përshtatë ndryshimit).

272. Nëse vendimi për të pezulluar apo mosvazhduar beneficinet ka efekt prapaveprues, kjo do të trajtohet si faktor që merret parasysh gjatë vlerësimit të baraspeshës mes proporcionalitetit dhe ndërhyrjes si në rastet *Lakićević dhe të tjerët kundër Malit të Zi dhe Serbisë*, § 71; *Moskal kundër Polonisë*, § 69. Në një rast që përfshin rikalkulimin retrospektiv të një pensioni që veç i ishte ndarë parashtruesit të kërkesës, Gjykata tha se “interesi i mundshëm i Shtetit në sigurimin e një aplikimi uniform të Ligjit të Pensioneve nuk është dashur të sjell deri tek rikalkulimi retrospektiv i vendimit gjyqësor që veç ishte marrë në favor të parashtruesit të kërkesës. Rikalkulimi prapaveprues që kishte për efekt zvogëlimin e shumave të ndara për individin vendoste barrë të rëndë individuale mbi parashtruesin e kërkesës dhe nuk ishte në pajtim me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (*Bulgakova kundër Rusisë*, § 47). Obligimi për të kthyer prapa të gjitha shumat e pranuar para nxjerrjes së vendimit apo për të mos vazhduar apo zvogëluar pagesën e beneficioneve, në rast se të njëjtat nuk janë fituar me mashtrim, është tjetër faktor i rëndësishëm për vlerësimin e proporcionalitetit (*Iwaszkiewicz kundër Polonisë*, § 60, krahaso në kontrast me, *Chroust kundër Republikës Çeke* (vendim); *Moskal kundër Polonisë*, § 70). Në rastin *Romeva kundër Maqedonisë së Veriut*, §§ 78 dhe 88, parashtrueses së kërkesës i është marrë në mënyrë retroaktive pensioni të cilin e kishte pranuar për shtatë vite, me kërkesë që të paguhen prapa shumat e pranuar, duke u thirrur në një gabim të Fondit gjatë vlerësimit fillestar të plotësimit të kushteve për pension nga parashtruesja e kërkesës. Duke konstatuar shkelje, Gjykata kërkoi nga Qeveria që të përmbahet nga përmbarimi i çfarëdo shpagimi të tillë.

273. Kalimi i kohës mund të ketë rëndësi të veçantë në kuptim të ekzistimit juridik dhe karakterit të beneficioneve të sigurimit shoqëror. Kjo është e aplikueshme edhe tek amandamentimi i legjislacionit, që mund të miratohet si reagim ndaj ndryshimit të rrethanave shoqërore dhe ndryshimit të qëndrimeve mbi atë se cilat kategori të personave kanë nevojë për asistencë sociale, si dhe evoluim në situata individuale (*Wieczorek kundër Polonisë*, § 67).

274. Kur pagesa e pensionit është ndërprerë automatikisht, bazuar vetëm në shpalljen e parashtruesit të kërkesës fajtor në procedurë penale, dhe i njëjti është privuar në tërësi nga të drejtat e fituara, Gjykata ka konstatuar shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (*Apostolakis kundër Greqisë*, § 39). Në anën tjetër, zvogëlimi në masë prej 65% i beneficioneve për të njëjtën arsye është konsideruar se nuk përbën shkelje sepse parashtruesi kishte në dispozicion një procedurë gjyqësore trishkallëshe për ta sfiduar vendimin; të gjitha duke marrë parasysh rëndësinë e jashtëzakonshme të veprës së parashtruesit të kërkesës (*Banfield kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim); *Philippou kundër Qipros*, §§ 70, 71 dhe 74).

275. Çështja specifike e gëzimit të një pozite të privilegjuar vis-a-vis të drejtave të pensionit të gëzuara nga anëtarët e elitës komuniste, policisë politike apo forcave të armatosura në shtetet postkomuniste të Evropës është ekzaminuar nga Gjykata në disa raste (*Goretzky kundër Gjermanisë* (vendim); *Lessing dhe Reichelt kundër Gjermanisë* (vendim); *Schwengel kundër Gjermanisë* (vendim); *Domalewski kundër Polonisë* (vendim); *Janković kundër Kroacisë* (vendim)). Ulja e beneficioneve në bazë të rolit që pranuesit e tyre kishin luajtur në të kaluarën nën sistemin komunist në disa raste është konsideruar të jetë në pajtueshmëri me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1, në veçanti nëse masat e ankimuara nuk kanë ndikuar në esencën aktuale të të drejtave dhe uljet nuk kanë qenë më të mëdha se sa mesatarisht 25% deri 30%, ndërsa parashtruesit e kërkesës kishin vazhduar të marrin pensione mbi nivelin mesatar të Polonisë (*Cichopek dhe të tjerët kundër Polonisë* (vendim), §§ 152 dhe 156). Kur parashtruesit e kërkesës kishin humbur beneficinet e tyre të sigurimit shoqëror si rezultat i legjislacionit që kishte për qëllim dënimin e rolit politik të cilin shërbimet e sigurimit komunist e kishin luajtur në shtypjen e opozitës ndaj regjimit komunist, Gjykata i shpalli rastet e tilla të papranueshme, marrë parasysh faktin se beneficinet e sigurimit shoqëror nuk ishin prekur në mënyrë joproporcionale apo arbitrare (*Skórkiewicz kundër Polonisë* (vendim); *Styk kundër Polonisë*, Vendim i Komisionit; *Bienkowski kundër Polonisë*, Vendim i Komisionit). Në të tilla raste, është pranuar se masat kishin pasur qëllim legjitim, përkundër kohës së konsiderueshme që kishte kaluar prej rreth njëzet vitesh mes rënies së regjimit politik dhe miratimit të legjislacionit që i privonte personat më parë të privilegjuar nga e drejta të cilën e kishin fituar (*Cichopek dhe të tjerët kundër Polonisë* (vendim), § 118).

276. Për më tepër, beneficinet e bazuara në paaftësi të parashtruesve të kërkesave për të mbajtur punësim për shkak të shëndetit të ligë gjithashtu mund të revokohen apo ulen, edhe kur i janë paguar

personit për një periudhë më të gjatë kohore. Natyra e disa rrethanave shëndetësore është e tillë që bën që personat e prekur nga të përballen me situata të ndryshme në kuptim të aftësisë për punë, duke qenë se me kalimin e kohës ato mund të përmirësohen apo përkeqësohen. Është e lejueshme për Shtetet që të ndërmarrin masa për të rivlerësuar gjendjen mjekësore të personave që marrin pensione të invaliditetit me qëllim të ripërcaktimit nëse ata vazhdojnë të jenë të paaftë për punë, me kusht që rivlerësimi i tillë të jetë në pajtim me ligjin dhe të jetë i mbrojtur nga garanci të mjaftueshme procedurale. Në qoftë se e drejta për pension invaliditeti të mbahej edhe në situata kur pranuesit me kalimin e kohës nuk i plotësojnë kushtet ligjore, kjo do të përbënte pasurim të jashtëligjshëm. Aq më shumë, do të ishte e padrejtë ndaj personave që kontribuojnë në sistemin e sigurimit shoqëror, në veçanti atyre që u janë mohuar beneficionet për shkak se nuk i kanë plotësuar kushtet ligjore. Në terma të përgjithshëm, me këtë do të sanksionohej alokimi i padrejtë i fondeve publike, që nuk është në pajtim me qëllimet që mëton t'i arrijë shpërndarja e pensioneve të invaliditetit (*Wieczorek kundër Polonisë*, § 67; *Iwaszkiewicz kundër Polonisë*, § 51).

277. Sa u përket llojeve të ndryshme të beneficioneve sociale, në rastin *Krajnc kundër Sllovenisë*, §§ 49-51, në të cilin pagesa e ndarë për parashtruesin e kërkesës gjatë periudhës së pritjes ishte shumë më e ulët se sa pagesa e lejuar pas reformës legislative, Gjykata konstatoi se parashtruesi i kërkesës është gjetur në një situatë posaçërisht të pasigurt dhe se është dashur të bartë barrë joproporcionale të humbjes së një pjese të beneficioneve të invaliditetit. Në rastin *Fedulov kundër Rusisë*, §§ 76-79, lidhur me plotësimin e kushteve të një personi me aftësi të kufizuara për të përfituar medikamente pa pagesë Gjykata konstatoi se situata nuk ishte nxitur nga ndonjë ndryshim në legjislacion. Parashtruesi i kërkesës kishte plotësuar të gjitha kriteret për të përfituar beneficionet në fjalë, ndërsa gëzimi i papenguar i tyre ka qenë i rëndësishëm kritike për jetën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa refuzimi nga autoritetet e Shtetit i bazuar në mungesë të fondeve nuk mund të thuhet se është në pajtim me parimet e sundimit të së drejtës. Kjo konkluzë e bëri të panevojshëm ekzaminimin e proporcionalitetit.

278. Zbritjet e disa llojeve të sigurimit shoqëror dhe të pagave si rezultat i aplikimit të masave të ndryshme të kursimit janë konsideruar të jenë në pajtim me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1, ndërsa Gjykata duke marrë parasysh kontekstin e përgjithshëm të masave të ankimuara (krizën ekonomike) dhe fushëveprimin e tyre (normën e pandryshuar të pensionit, pagesat e zvogëluara për periudha deri në tri vite; do të thotë ndërhyrjen e kufizuar në kuptim kohor dhe fushëveprim (*Da Conceição Mateus dhe Santos Januário kundër Portugalisë* (vendim), §§ 28-29). Në një rast të ngjashëm që kishte të bëjë, mes tjerash, me uljen e pensioneve të justifikuar me ekzistimin e një krize të jashtëzakonshme ekonomike pa precedent në historinë e Greqisë, Gjykata konstatoi se proporcionaliteti i masave nuk është në kundërshtim me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (*Koufaki dhe Adedy kundër Greqisë* (vendim), §§ 46-49; (shih kapitullin mbi Masat kursyese).

279. Gjykata e ka pranuar dallimin që e bëjnë disa Shtete Kontraktuese sa u përket pensioneve të shërbyesve civilë dhe punonjësve të sektorit privat (*Matheis kundër Gjermanisë* (vendim), lidhur me pensionin e trashëgimtarit mbijetues); *Ackermann dhe Fuhrmann kundër Gjermanisë* (vendim); *Valkov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, § 117; *Panfile kundër Rumanisë* (vendim), § 28; dhe më rishtas, *Giavi kundër Greqisë*, § 52; *Fábián kundër Hungarisë [GC]*, §§ 131-132). Logjika prapa kësaj qasjeje duhet gjetur në dallimet strukturore mes dy sistemeve që justifikon rregullimet e ndryshme (*Matheis kundër Gjermanisë* (vendim)), dhe më në përgjithësi dallimet mes kategorive të ndryshme të personave të siguruar (*Carson dhe të tjerët kundër the United Kingdom* [GC], § 84) (shih edhe nënkaptullin mbi Nenin 14 dhe rastin *Fábián kundër Hungarisë [GC]*).

280. Vet fakti që legjislacioni i ri dhe më pak i favorshëm i privon personat që plotësojnë kushtet për një beneficion pensional, duke rikualifikuar kushtet që duhet plotësuar për pensionin në fjalë, nuk mjafton si i tillë për tu konstatuar shkelje. Rregulloret ligjore për pensionet mund të ndryshojnë dhe legjislatura nuk duhet privuar nga e drejta që të rregullojë edhe përmes dispozitave të reja retrospektive të drejtat pensionale që rrjedhin nga ligjet në fuqi (*Khoniakina kundër Gjeorgjisë*, §§ 74 dhe 75; dhe gjithashtu *Arras dhe të tjerët kundër Italisë*, § 42; *Sukhobokov kundër Rusisë*, § 26, lidhur me mospërmbarimin e një aktgjykimi të formës së prerë që i akordon pagesa retroaktive pensionale parashtruesit të kërkesës në bazë të Nenit 6; *Bakradze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë* (vendim), § 19).

281. Pritja e një personi të siguruar në skemën e sigurimit shëndetësor se kontrata e tij apo e sigurimit shëndetësor do të vazhdohet apo ripërtërihet nuk përbën pronë (*Ramaer dhe Van Villingen kundër Holandës* (vendim), § 81).

282. Kur kemi të bëjmë me zvogëlimin e shumave të pagueshme, parimet e aplikueshme në raste që ndërlihen me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 janë po aq relevante tek pagat sa janë edhe tek beneficionet sociale (*Savickas dhe të tjerët kundër Lituanisë* (vendim), § 91; *Stummer kundër Austrisë* [GC], § 82).

C. Rastet bankare

283. Neni 1 i Protokollit Nr. 1 është shfrytëzuar në disa raste që kishin të bëjnë me kërkesat e parashtruesve të kërkesave lidhur me vlerën e kursimeve të tyre apo paaftësinë për të rikthyer kursimet e tyre.

284. Llogaritë e kursimit mund të zhvlerësohen dukshëm si rezultat i inflacionit dhe reformave ekonomike. Në rastet që ndërlihen me uljen e vlerës së kursimeve të parashtruesve të kërkesës, duke ritheksuar se Neni 1 i Protokollit Nr. 1 nuk përfshin të drejtën për të blerë prona (*Grishchenko kundër Rusisë* (vendim)), Gjykata ka konstatuar se obligimi i përgjithshëm i Shteteve për ruajtjen e fuqisë blerëse të shumave të depozituara pranë institucioneve bankare apo financiare përmes indeksimit sistematik të kursimeve apo kompensimit për humbjet e shkaktuara nga inflacioni nuk mund të rrjedh nga ky nen (*Gayduk dhe të tjerët kundër Ukrainës* (vendim); *Appolonov kundër Rusisë* (vendim); *Todorov kundër Bullgarisë* (vendim); *Poltorachenko kundër Ukrainës*, § 38; *Zbaranskaya kundër Ukrainës* (vendim); *Sherstyuk kundër Ukrainës* (vendim); *Boyajyan kundër Armenisë*, § 54; *Ryabykh kundër Rusisë*, § 63; *Dolneanu kundër Moldavisë*, § 31). Ngjashëm, Konventa nuk imponon obligim mbi Shtetet sa i përket politikave të tyre ekonomike në trajtimin e efekteve të inflacionit dhe fenomeneve tjera ekonomike, apo kërkit të të korrigojnë situatat e tilla përmes legjislacionit apo vendimeve gjyqësore (*O.N. kundër Bullgarisë* (vendim)). Në rastet kur parashtruesit e kërkesës janë ankuar për shkak të procedurave të stërzgjatura gjyqësore dhe efektet e inflacionit përgjatë kësaj periudhe të stërzgjatur e kanë ulur dukshëm vlerën e kërkesës së tyre pasurore, Shteti nuk është konsideruar përgjegjës dhe ankesat e tilla janë shpallur të papranueshme (*Köksal kundër Turqisë* (vendim), § 38; *Grozeva kundër Bullgarisë* (vendim); *O.N. kundër Bullgarisë* (vendim)).

285. Në një rast që kishte të bëjë me uljen e vlerës së aksioneve të parashtruesit të kërkesës, marrë parasysh marginën e vlerësimit që e gëzojnë Shtetet Kontraktuese në këtë fushë, Gjykata ka vlerësuar se masat e ndërmarra nga Banka Kombëtare e Polonisë kanë pasur për qëllim mbrojtjen e interesave të konsumatorëve të bankës të cilët ia kanë besuar pasurinë bankës dhe shmangien e humbjeve të rënda financiare që falimentimi i bankës do t'i sillte konsumatorëve të saj (*Olczak kundër Polonisë* (vendim)).

286. Për më tepër, marrja nën administrim e një banke private nga autoritetet e Shtetit mund të konsiderohet si ndërhyrje me të drejtën në pronë të ish-aksionarëve të bankës (*Süzer dhe Eksen Holding A.Ş. kundër Turqisë*, §§ 143-144). I mbetet Gjykatës të vlerësojë nëse ndërhyrja e tillë i plotëson kushtet e ligjshmërisë, ndjekë një qëllim legjitim dhe është proporcionale me qëllimin e mëtuar. Kur vendimi për të marrë në administrim një bankë është marrë qartë si masë e kontrollit të sektorit bankar në vend, privimi i pronës duhet të konsiderohet si qëllim legjitim dhe paragrafi i dytë i Nenit 1 të Paragrafit Nr. 1 duhet të aplikohet (*Süzer dhe Eksen Holding A.Ş. kundër Turqisë*, §§ 146-147). Për të vlerësuar nëse ndërhyrja e tillë me të drejtën në pronë është proporcionale me qëllimin e mëtuar, i mbetet Gjykatës që të vlerësojë nëse është arritur baraspesha e drejtë mes kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe mbrojtjes së të drejtave themelore të individëve të prekur (*Cingilli Holding A.Ş. dhe Cingillioğlu kundër Turqisë*, §§ 49-51).

287. Sa u përket procedurave që kanë të bëjnë me revokimin e licencës bankare, Gjykata ka theksuar se çdo ndërhyrje me gëzimin paqësor të “pronave” duhet të përcillet me garanci procedurale që i ofrojnë individit ose subjektit të prekur një mundësi të arsyeshme për ta paraqitur rastin e vet për shqyrtim pranë autoriteteve përgjegjëse me qëllim të sfidimit efektiv të masave që ndërhyjnë me të drejtat e garantuara nga kjo dispozitë. Në vlerësimin nëse ky kusht është përmbushur duhet të kryhet një shqyrtim

gjithëpërfshirës i procedurave të zbatueshme gjyqësore dhe administrative (*Capital Bank AD kundër Bullgarisë*, § 134).

288. Ngrirja e një llogarie bankare zakonisht konsiderohet masë e kontrollit të shfrytëzimit të pronës (*Raimondo kundër Italisë*, § 27, sa i përket konfiskimit të përkohshëm të pasurisë me qëllim të konfiskimit të përhershëm në bazë të legjislacionit që rregullon fitimet nga veprimtaria kriminale; *Luordo kundër Italisë*, § 67; *Valentin kundër Danimarkës*, §§ 67-72, sa i përket heqjes së të drejtës së administrimit dhe disponimit me pronë personave të falimentuar; *Trajkovski kundër the ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* (vendim), sa i përket ngrirjes së llogarive bankare). Për shkak të paaftësisë së parashtruesit të kërkesës për të tërhequr kursimet për më shumë se njëzet vite dhe kompleksitetit të situatës, ngrirja e llogarive bankare është ekzaminuar edhe nën rregullin e përgjithshëm në rastin *Ališić dhe të tjerët kundër Bosnjë dhe Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë, Sllovenisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* [GC], § 99 (për më shumë detaje shih më poshtë).

289. Në rastin e hapjes së procedurave të falimentimit kundër një banke, ngrirja e llogarive bankare të menaxherëve mund të konsiderohet masë e ligjshme dhe që ndjekë një qëllim legjitim për tu siguruar se menaxherët e bankës e cila i nënshtrohet nuk do të zbrazin asetet e tyre për t'u paraprirë aktakuzave të mundshme penale apo padive civile lidhur me mënyrën se si e kanë menaxhuar bankën para falimentimit (*International Bank for Commerce dhe Development AD dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, § 123).

290. Stabiliteti i bankave dhe interesat e depozituesve dhe kreditorëve të tyre meritojnë mbrojtje të shtuar. Autoritetet kombëtare gëzojnë një marginë të gjerë të vlerësimit të mënyrës se si të trajtojnë çështjet e tilla (*Capital Bank AD kundër Bullgarisë*, § 136). Në rrethana normale, ngrirja e llogarive bankare të menaxherëve të bankës, për një periudhë të limituar prej gjashtë muajsh, mund të konsiderohet e pranueshme brenda marginës së vlerësimit dhe si masë proporcionale për qëllimin e mëtur (*International Bank for Commerce dhe Development AD dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, § 124).

291. Disa rase para Gjykatës kanë pasur të bëjnë me kursime të “vjetra” në deviza të depozituara në kohën e RSFJ-së të cilat janë ngrirë. Pas pavarësimit të gjitha shtetet trashëguese të RSFJ-së vendosën zgjidhje të ndryshme juridike për të rregulluar kursimet e garantuara më parë nga RSFJ (për të kuptuar rrethanat specifike në shtetet përkatëse të paditura shih *Ališić dhe të tjerët kundër Bosnjë dhe Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë, Sllovenisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* [GC], §§ 24-52). Në atë rast, kursimet e “vjetra” në deviza u bënë të padisponueshme për shkak të faktorëve si mungesa e fondeve në bankat relevante, imponimit të ngrirjes së llogarive dhe dështimit të autoriteteve nacionale për të ndërmarrë masa që u mundësojnë mbajtësve të depozitave disponimin me kursimet e tyre.

292. Gjykata ka vlerësuar se kërkesat që ndërlidhen me kursimet në deviza të depozituara në banka komerciale para shpërbërjes së RSFJ-së përbëjnë “prona” brenda kuptimit të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (*Suljagić kundër Bosnjë e Hercegovinës*, §§ 34-36), sikur edhe kërkesat kundër Federatës Ruse në kuptim të investimit të kursimeve në letra me vlerë të lëshuara nga ish-BRSS (*Yuriy Lobanov kundër Rusisë*, §§ 32-34) ose letra me vlerë dhe certifikata të lëshuara nga Banka e Kursimeve e BRSS-së (*Boyajyan kundër Armenisë*, § 57). Ngjashëm, letrat me vlerë që kanë vlerë ekonomike mund të konsiderohen si “prona” (*Jasinskij dhe të tjerët kundër Lituanisë*, Vendim i Komisionit).

293. Megjithatë, sa i përket kërkesave lidhur me ngrirjen e devizave të parashtruesve të kërkesave nga Letonia pranë Bankës së Veprimtarisë Ekonomike me Jashtë në kohën e BRSS-së, Gjykata i ka shpallur ankesat e parashtruesve të kërkesave të papranueshme sepse veprimet e Bankës nuk mund t'i atribuoheshin Letonisë e cila kurrë nuk ka shfaqur asnjë shenjë të pranimi apo njohjes së kërkesave të tilla (*Likvidējama p/s Selga dhe Vasiļevska kundër Letonisë* (vendim), §§ 94-113).

294. Në rastet kur masat legjislative kishin për qëllim pagesën e kursimeve të “vjetra” në deviza përmes bonove të thesarit, Gjykata, duke marrë parasysh nevojën për të baraspeshuar drejt mes interesit publik dhe të drejtës pronësore të parashtruesit të kërkesës dhe të gjitha palëve tjera në situatë të njëjtë, ka konsideruar se mjetet e përzgjedhura për arritjen e qëllimit legjitim ishin tërësisht të justifikuar (në veçanti rasti *Trajkovski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* (vendim)).

295. Cilatdo qofshin masat lidhur me pagesën e kursimeve “të vjetra” devizore të cilat Shteti ka vendosur t'i zbatojë, parimi i sundimit të ligjit dhe ligjshmërisë kërkon nga Palët Kontraktuese të

respektojnë dhe zbatojnë në mënyrë konsistente dhe të parashikueshme, ligjet të cilat i kanë miratuar. Implementimi i mangët i legjislacionit të Shtetit në rastin e kursimeve “të vjetra” devizore ka rezultuar me dështim të Shtetit për t’iu përmbajtur këtij obligimi (*Suljagić kundër Bosnjë e Hercegovinës*, § 57).

296. Gjatë vlerësimit nëse është arritur baraspesha e drejtë mes interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave për mbrojtje të të drejtave themelore të individit, Gjykata duhet të ekzaminojë në përgjithësi interesat e ndryshëm në këtë drejtim, duke marrë parasysh se Konventa ka për qëllim t’i mbrojë të drejtat që janë “praktike dhe efektive”. Në këtë kontekst, duhet theksuar se pasiguria, qoftë legjislative, administrative apo që rrjedh nga praktika e aplikuar nga autoritetet, është faktor që duhet të merret parasysh gjatë vlerësimit të sjelljes së Shtetit. Në fakt, kurdo që çështje trajtimi është interesi i përgjithshëm, është obligim i autoriteteve publike që të veprojnë me kohë dhe në mënyrë të duhur dhe konsistente. Përderisa disa vonesa mund të justifikohen në rrethana të jashtëzakonshme, Gjykata ka konstatuar në rastin e caktuar se parashtruesit e kërkesës janë detyruar të presin tepër gjatë. Autoritetet e Sllovenisë dhe Serbisë, pa marrë parasysh marginën e gjerë të vlerësimit që kanë në këtë fushë, nuk kanë arritur baraspeshën e duhur mes interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe të drejtave pronësore të parashtruesve të kërkesave. Shkelja e Nenit 1 të Protokollit 1 është konstatuar kundër këtyre dy shteteve (*Ališić dhe të tjerët kundër Bosnjë dhe Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë, Sllovenisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* [GC], §§ 108 dhe 124-125).

297. Vonesat përbëjnë një faktor të rëndësishëm në vlerësimin e arsyeshmërisë së një ndërhyrjeje me të drejtat pronësore. Përderisa disa vonesa mund të justifikohen me shfaqjen e rrethanave të jashtëzakonshme, në rastet tjera Gjykata ka konkluduar se ato nuk përbëjnë arsyet të mjaftueshme për dështimin e Shtetit që të kompensojë parashtruesit e kërkesës (*Ališić dhe të tjerët kundër Bosnjë dhe Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë, Sllovenisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* [GC], § 108).

298. Kufiri i marginës së vlerësimit të shteteve kur masat e miratuara nga autoritetet kombëtare kufizojnë në mënyrë substanciale të drejtën e parashtruesit të kërkesës për të disponuar me fonde dhe shuma për të kontrolluar shfrytëzimin e pronës. Për shembull, Gjykata ka konstatuar se masat legjislative ishin të pakënaqshme nëse kanë rezultuar në vonesa prej disa muajsh (*Suljagić kundër Bosnjë e Hercegovinës*, § 64).

299. Gjithashtu, pamundësia e sigurimit të ekzekutimit të një aktgjykimi përfundimtar në favor të parashtruesit të kërkesës përbën ndërhyrje me të drejtën e tij ose saj për gëzim paqësor të “pronës” në kontekst të kursimeve “të vjetra” devizore (*Jeličić kundër Bosnjë e Hercegovinës*, § 48).

D. Tatimimi

300. Tatimimi është në parim ndërhyrje me një të drejtë të garantuar nga paragrafi i parë i Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, pasi që e privon personin nga një pronë e caktuar, do të thotë nga një shumë e parave që duhet paguar (*Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], § 59; *Špaček, s.r.o., kundër Republikës Çeke*, § 39).

301. Ndërhyrja me qëllime të tatimit në përgjithësi justifikohet me paragrafin e dytë të këtij neni, që parashihet shprehimisht përjashtimin sa i përket pagesës së tatimeve dhe kontributeve tjera (*Gasus Dossier- und Fördertechnik GmbH kundër Holandës*, § 59).

302. Sidoqoftë, çështja shqyrtohet nga Gjykata pasi që aplikimi i saktë i Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 i nënshtrohet mbikëqyrjes së saj (*Orion-Břeclav, S.R.O. kundër Republikës Çeke* (vendim)). Detyrimi financiar që rrjedh nga grumbullimi i tatimeve mund të ndikojë negativisht në garancinë e pronësisë nëse e vendosë një barrë të shtuar mbi personin në fjalë apo ndërhyrje në thelb në pozitën financiare të tij (*Ferretti kundër Italisë*, Vendim i Komisionit; *Wasa Liv Ömsesidigt, Försäkringsbolaget Valands Pensionsstiftelse dhe një grup prej rreth 15,000 individësh kundër Suedisë*, Vendim i Komisionit; *Buffalo S.r.l. në proces të likuidimit kundër Italisë*, § 32).

303. Shtetit në përgjithësi i lejohet një marginë e gjerë e vlerësimit sipas Konventës kur kemi të bëjmë me masa të përgjithshme të strategjisë ekonomike apo sociale (*Wallishauser kundër Austrisë (Nr. 2)*, § 65), si dhe gjatë vendosjes së kornizës politike dhe implementimit të politikave tatimore (“*Bulves*” AD

kundër Bullgarisë, § 63; *Gasus Dossier- und Fördertechnik GmbH kundër Holandës*, § 60; *Stere dhe të tjerët kundër Rumanisë*, § 51). Gjykata respekton vlerësimin e legjislaturës në çështje të tilla përveç nëse veprimet e saj janë pa bazë të arsyeshme (*Gasus Dossier- und Fördertechnik GmbH kundër Holandës*, § 60).

304. Para së gjithash u mbetet autoriteteve kombëtare të vendosin llojin e tatimit apo kontributeve që duan t'i imponojnë. Vendimet në këtë fushë zakonisht ngërthejnë edhe vlerësimin e problemeve politike, ekonomike dhe sociale të cilat Konventa ia lë në kompetencë Shteteve anëtare si autoritete kombëtare të cilat janë më të afta për të vlerësuar problemet në fjalë (*Musa kundër Austrisë*, Vendim i Komisionit; *Baláž kundër Sllovakisë* (vendim); *Azienda Agricola Silverfunghi S.a.s. dhe të tjerët kundër Italisë*, § 103; *R.Sz. kundër Hungarisë*, §§ 38 dhe 46). Është gjithashtu kompetencë e legjislaturës vendore që të bëjë zgjedhjet e duhura lidhur me atë që duhet klasifikuar si e hyrë e tatueshme dhe cilat duhet të jenë mjetet e përmbartimit të detyrimeve tatimore (*Cacciato kundër Italisë* (vendim), § 25; *Guiso dhe Consiglio kundër Italisë* (vendim), § 44).

305. Vonesat në rimbursim të tatimeve të mbipaguara kanë rezultuar si shkelje (*Buffalo S.r.l. në likuidim kundër Italisë*, § 39, ndërsa Gjykata i ka konsideruar vonesat nga pesë deri në dhjetë vjet si të tilla që kanë ndikim serioz mbi gjendjen financiare të kompanisë parashtruese të kërkesës e cila nuk mund të kompensohej duke ia paguar interesin e thjeshtë mbi kryegjënë e detyruar, si shkaktare të pasigurisë për tatimpaguesin dhe si dëmtim shtesë për shkak të mungesës së mjeteve juridike për të korrigjuar situatën.

306. Ngjashëm, paaftësia për të siguruar rimbursim për pagesat e tepërta të tatimeve për të cilat autoritetet vendore e kanë pranuar se janë paguar duke shkelur të drejtën materiale të zbatueshme përbën shkelje të Konventës: sepse edhe mohimi i kërkesës së kompanisë parashtruese të kërkesës kundër Shtetit edhe mungesa e procedurave vendore që ofrojnë mjete juridike që sigurojnë mbrojtjen e të drejtës së kompanisë parashtruese të kërkesës për të gëzuar në paqe "pronat" e saj çrregullojnë barspeshën e drejtë (*S.A. Dangeville kundër Francës*, § 61).

307. Mospërputhja mes vlerës së pronës së marrë për qëllime të kalkulimit të kompensimit të shpronësimit dhe për qëllime të tatimit në trashëgimi ka rezultuar me konstatimin e shkeljes nga Gjykata si rrjedhojë e arbitraritetit (*Jokela kundër Finlandës*, § 65).

308. Fakti se legjislacioni tatimor ka karakter retrospektiv si i tillë nuk përbën shkelje (p.sh. ligji retroaktiv që bën që disa transaksione t'i nënshtrohen tatimit (*M.A. dhe 34 tjerë kundër Finlandës* (vendim))).

309. Masat përmbartimore në kontekst të procedurave tatimore të cilat nuk janë pezulluar automatikisht në momentin kur debitori ka parashtruar ankesë ndaj tyre janë konsideruar të pranueshme dhe që bien nën marginën e gjerë të vlerësimit që akordohet Shtetit, por të njëjtat duhet të përcillen me masa mbrojtëse procedurale për të siguruar se individët nuk vendosen në pozitë që ankesat e tyre të anashkalohen dhe ata të mos mund t'i mbrojnë interesat e tyre në mënyrë efektive. Një nga faktorët e rëndësishëm në këtë kontekst është që ekzistojë një shkallë e arsyeshme e komunikimit mes autoriteteve publike të përfshira, për të mundësuar mbrojtjen e të drejtave të tatimpaguesve (*Rousk kundër Suedisë*, § 124).

310. Fakti që normat tatimore janë të lartë, si i tillë, nuk përbën bazë për shkelje; Gjykata ekzaminon normën tatimore të parashtruesit të kërkesës (*R.Sz. kundër Hungarisë*, § 54). Tatimimi në norma konsiderueshëm më të larta se sa ato në fuqi në momentin e gjenerimit të të ardhurave mund të konsiderohet ndërhyrje e paarsyeshme mbi pritjet e mbrojtura me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (*M.A. dhe 34 tjerë kundër Finlandës* (vendim))).

311. Megjithatë, në një rast kur një shërbyes civil i shkarkuar ishte obliguar të paguajë tatim mbi pagesën e akorduar për shkëputje të marrëdhënies së punës me normë tatimore të gjithmbarshme prej 52%, Gjykata gjeti shkelje për arsyet në vijim: kjo normë e kishte tejkaluar konsiderueshëm normën e gjithmbarshme tatimore të aplikueshme për të ardhurat tjera; parashtruesi i kërkesës kishte vuajtur humbje substanciale të të ardhurave si rezultat i humbjes së punësimit; dhe tatimet ishin zbritur nga

pagesa drejtpërsëdrejti prej punëdhënësit pa kurrfarë vlerësimi paraprak dhe individual të situatës së parashtruesit të kërkesës dhe mbi të ardhura për aktivitete që kishin ndodhur para vitit material tatimor (*N.K.M. kundër Hungarisë*, §§ 66-74).

312. Po ashtu, në kontekst të procedurave tatimore, Gjykata i kushton shumë rëndësi disponueshmërisë së masave mbrojtëse procedurale në procedura relevante (krahaso me *Agosi kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 55). Baraspesha e drejtë u çrregullua në raste kur autoritetet kombëtare, në mungesë të çfarëdo indikacioni të përfshirjes së drejtpërdrejtë të një individi apo subjekti juridik në keqpërdorim të TVSH në zinxhirin e furnizimit, apo edhe të dijenisë për një veprimtari të tillë, megjithatë e penalizuan një pranues tërësisht legal të një furnizimi të tatueshëm me TVSH për veprimet apo veprimet e furnitorit mbi të cilin i pari nuk kishte kurrfarë kontrolli dhe në lidhje me të cilin ai nuk kishte kurrfarë mundësie të monitorimit apo sigurimit të pajtueshmërisë (*"Bulves" AD kundër Bullgarisë*, §§ 67-71).

E. Planifikimi hapësinor

313. Të drejtat e pronarëve në kuptim të çështjeve që ndërlidhen me planifikimin urban apo rajonal, në esencë janë evolutive. Politikat e planifikimit urban dhe rajonal janë, par excellence, sfera në të cilat Shteti intervenon veçanërisht përmes kontrollit të pronave në interes të përgjithshëm ose publik. Në rrethana të tilla, ku interesi i përgjithshëm është në plan të parë, Gjykata mbron qëndrimin se margjina e vlerësimit të Shtetit është më e gjerë se sa kur kemi të bëjmë thjeshtë me të drejta civile (*Gorraiz Lizarraga dhe të tjerët kundër Spanjës*, § 70; *Mellacher dhe të tjerët kundër Austrisë*, § 55; *Chapman kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], § 104).

314. Në bazë të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 fakti se një person ka në pronë një parcelë toke nuk ia bartë pronarit të saj të drejtën e ndërtimit mbi të. Është e mundshme që në bazë të kësaj dispozite të vendosen edhe kufizime tjera të ndërtimit.

315. Gjykata ka ekzaminuar një sërë rastesh që kanë të bëjnë me kufizime të imponuara mbi pronarët e tokave në kontekst të planifikimit hapësinor, nganjëherë edhe për shumë vite e radhë (*Skibiński kundër Polonisë*, § 98; *Skrzyński kundër Polonisë*, § 92; *Rosiński kundër Polonisë*, § 89; *Buczkiewicz kundër Polonisë*, § 77; *Pietrzak kundër Polonisë*, § 115; *Hakan Arı kundër Turqisë*, § 36; *Rossitto kundër Italisë*, § 37; *Maioli kundër Italisë*, § 52; *Hüseyin Kaplan kundër Turqisë*, § 38; *Ziya Çevik kundër Turqisë*, § 33). Në rastin *Jahn dhe të tjerët kundër Gjermanisë* [GC], §§ 100-105, i cili kishte të bëjë me rrethana të jashtëzakonshme në të cilin kufizimet e tilla edhe nëse imponohen në baza të përhershme dhe pa të drejtë kompensimi u konsideruan të jenë në pajtim me këtë dispozitë. Kërkesat u deklaruan të papranueshme në rastin e një ndalese absolute të ndërtimit, përcjellë me paaftësinë e kompensimit të kërkesës nga komuna, kur pronarët nuk kanë pasur as qëllim të manifestuar as nuk kanë dëshmuar se ndalesa i ka obliguar të ndërrojnë destinimin e pronës (*Scagliarini kundër Italisë* (vendim)); ose kur në mungesë të ndryshimit të destinimit parashtruesi i kërkesës ka pritur gjatë para se të aplikojë për leje ndërtimi (*Galtieri kundër Italisë* (vendim)). Në raste tjera, shkelle është konstatuar edhe në mungesë të një projekti ndërtimor konkret mbi bazën se legjislatura fillimisht ka miratuar ligje që parashohin të drejtën e kompensimit për shpronësim e më pas e ka shtyrë vazhdimisht hyrjen e tyre në fuqi (*Skibiński kundër Polonisë*, § 78).

316. Uzurpimi i paligjshëm i tokës private nga autoritetet publike me qëllim të implementimit të projekteve zhvillimore, duke krijuar një mekanizëm që i mundësonte autoriteteve të përfitojnë nga situata e paligjshme të cilën pronarit i është shfaqur një gjendje *fait accompli*, përbënte shkelle të drejtës për gëzim paqësor të "pronave" (*Belvedere Alberghiera S.r.l. kundër Italisë*, § 59).

317. Gjykata theksoi se vështirësitë në krijimin e një kornize ligjore gjithëpërfshirëse në fushën e planifikimit urban përbëjnë pjesë të procesit të tranzicionit nga rendi ligjor socialist dhe regjimi pronësor i tij në një rend të sundimit të ligjit dhe ekonomisë së tregut, një proces i cili sipas vetë natyrës së vet përshkohet me shumë vështirësi. Megjithatë, këto vështirësi dhe enormiteti i detyrave me të cilat ligjvënësit duhet të merren për të kryer të gjitha detyrat që i ngërthen tranzicioni nuk i lirojnë Shtetet

Anëtare nga obligimet që rrjedhin nga Konventa dhe Protokollet e saj (*Schirmer kundër Polonisë*, § 38; *Skibiński kundër Polonisë*, § 96).

F. Konfiskimi i pasurisë së fituar nga veprat penale

318. Në një sërë rastesh nën Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 janë ekzaminuar masat e ndryshme të ndërmarra me qëllim të luftimit të pasurimit të paligjshëm nga fitimet që rezultojnë nga veprat penale. Në raste të tilla, Shtetet kanë margjinë të gjerë të vlerësimit dhe përcaktimit të politikave për të luftuar krimin e organizuar, përfshirë konfiskimin e pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme (*Raimondo kundër Italisë*, § 30; *Riela dhe të tjerët kundër Italisë* (vendim); *Arcuri dhe të tjerët kundër Italisë* (vendim); *Gogitidze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*, § 108).

319. Varësisht nga korniza ligjore e Shteteve Anëtare, konfiskimi në fjalë mund të zhvillohet brenda procedurës penale ku zakonisht kushtëzohet nga shpallja fajtor ose jashtë procedurave penale me rastin e plotësimit të disa kushteve të caktuara. Një tjetër procedurë speciale është ajo ku prona e kryerësit të veprës ose personave tjerë konfiskohet bazuar në supozimin se rrjedh nga një vepër penale. Kjo zakonisht njihet me termin konfiskim i zgjeruar, dhe konsiderohet si formë ndihmëse dhe anësore e konfiskimit të rregullt. Për më tepër, Italia ka vënë në zbatim edhe masa të konfiskimit parandalues të karakterit administrativ, në veçanti për të luftuar krimin e organizuar. Gjithashtu, disa juridiksione, siç është ajo e Mbretërisë së Bashkuar, kanë edhe qasje civile ndaj konfiskimit: ky model i konfiskimit nuk është i bazuar në fajësinë e kryerësit të veprës por në origjinën e pronës.

320. Në rastin *Gogitidze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*, § 105, Gjykata vlerësoi se mund të thuhet që ka standarde të përbashkëta evropiane e madje edhe universale ligjore të cilat inkurajojnë para së gjithash konfiskimin e pronave të lidhura me vepra të rënda penale, siç janë korrupsioni, shpëlarja e parave, trafikimi i narkotikëve e të ngjashme, pa ekzistimin e dënimit penal paraprakisht. Së dyti, barra e të provuarit të origjinës së ligjshme të pronës që supozohet se është fituar në mënyrë të paligjshme mund të bartet edhe në mënyrë legjitime tek të palët e paditura në procedura të tilla jopenale të konfiskimit, përfshirë procedurat civile *in rem*. Së treti, masat e konfiskimit mund të aplikohen jo vetëm mbi fitimet e nxjerra direkt nga krimet, përfshirë të hyrat apo edhe beneficionet tjera të tërthorta, por edhe mbi pronën e fituar përmes konvertimit apo transformimit të fitimeve nga krimi me pasuri tjera potencialisht të ligjshme. Fundja, masat e konfiskimit mund të aplikohen jo vetëm mbi personat që dyshohen të kenë kryer krimet por edhe mbi palët e treta me të drejta pronësore pa arsyetim *bona fide* të cilët mund të kenë fshehur rolin e tyre në grumbullimin e pasurisë në fjalë.

321. Konfiskimi i pasurive që mund të jetë ose instrument i veprës penale ose fitim nga e njëjta nuk bie domosdoshmërisht nën prizmin e fjalisë së dytë të paragrafit të parë të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (*Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 63; *Agosi kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 51), edhe pse konfiskimi për nga natyra e privon personin nga pronësia.

322. Në rastet që lidheshin me konfiskimin e fitimeve nga veprat penale të cilat zhvilloheshin pas vërtetimit të fajësisë, Gjykata zakonisht e ka trajtuar konfiskimin si kontroll të shfrytëzimit të pronës (*Phillips kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 51; shih edhe *Welch kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 26, në bazë të Nenit 7 të Konventës; *Van Offeren kundër* Holandës (vendim), në bazë të nenit 6 të Konventës). Në realitet, paragrafi i dytë i Nenit 1 të Protokollit Nr. 1, mes tjerash, u mundëson Shteteve Kontraktuese të kontrollojnë pronën për të siguruar pagimin e ndëshkimeve. Kjo dispozitë duhet të interpretohet në frymën e parimit të përgjithshëm të përkufizuar në fjalinë e parë të paragrafit të parë i cili kërkon ekzistimin e një marrëdhënieje të arsyeshme të proporcionalitetit mes mjeteve të shfrytëzuara dhe qëllimit që mëtohet të arrihet (*Phillips kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 51; *Balsamo kundër San Marinos*, § 81).

323. E njëjta qasje është ndjekur edhe në situata kur masat e konfiskimit janë zhvilluar ndaras nga procedura penale për shkak se pasuria në fjalë është konsideruar si e fituar në mënyrë të jashtëligjshme ndërsa origjina e ligjshme e tyre nuk është dëshmuar ose ka qenë e shfrytëzuar si instrument i krimit

(*Raimondo kundër Italisë*, § 27; *Riela dhe të tjerët kundër Italisë* (vendim); *Sun kundër Rusisë*, § 25; *Arcuri dhe të tjerët kundër Italisë* (vendim); *C.M. kundër Francës* (vendim); *Air Canada kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 34; *Gogitidze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë*, §§ 94 dhe 97, lidhur me konfiskimin e aplikuar në procedurë civile; *Balsamo kundër San Marinos*, § 81, lidhur me procedurat e shpëlarjes së parasë).

324. Në disa raste Gjykata ka ekzaminuar procedurat e ndryshme për konfiskimin e pronave të lidhura me kryerjen e pretenduar të veprave të ndryshme serioze nga këndvështrimi i testit të proporcionalitetit në bazë të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Sa i përket pronës së supozuar të jetë fituar qoftë tërësisht apo pjesërisht nga fitime nga trafikimi i narkotikëve (*Webb kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim); *Butler kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim)) apo nga organizatat kriminale të përfshira në trafikim të narkotikëve (*Arcuri dhe të tjerët kundër Italisë* (vendim); *Morabito dhe të tjerët kundër Italisë* (vendim)) ose nga aktivitetet tjera joligjore mafioze (*Raimondo kundër Italisë*, § 30), Gjykata ka pranuar se masat e konfiskimit kanë qenë proporcionale dhe pse në mungesë të një dënimi që vërteton fajësinë e të pandehurit (*Balsamo kundër San Marino*, § 90).

325. Kur konfiskimi është shqiptuar pavarësisht nga çfarëdo pretendimi penal ndaj palëve të treta, Gjykata e ka pranuar se autoritetet mund të aplikojnë masa të konfiskimit jo vetëm ndaj personave direkt të akuzuar për veprat por edhe ndaj anëtarëve të familjeve të tyre dhe të afërmve të cilët supozohet se posedojnë dhe menaxhojnë prona të fituara në rrugë joligjore joformalisht në emër të kryerësve të supozuar të veprave penale, ose të cilët në forma tjera nuk gëzojnë status *bona fide* (*Raimondo kundër Italisë*, § 30; *Arcuri dhe të tjerët kundër Italisë* (vendim); *Morabito dhe të tjerët kundër Italisë* (vendim); *Butler kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim); *Webb kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim); *Saccoccia kundër Austrisë*, § 88; *Silickienė kundër Lituanisë*, § 65, ku masa e konfiskimit është shqiptuar mbi të vejën e një zyrtari publik të korruptuar; *Balsamo kundër San Marinos*, §§ 89 dhe 93, ku masa e konfiskimit është shqiptuar edhe mbi fëmijët në bazë të dosjes penale paraprake të babait të tyre).

326. Në raste të tilla, konfiskimi duhet të parandalojë shfrytëzimin e paligjshëm, në mënyrë të rrezikshme për shoqërinë, të “pasurive” origjina e ligjshme e së cilave nuk është konfirmuar. Gjykata ka theksuar vështirësitë e hasura nga autoritetet publike në luftën kundër krimit të organizuar. Konfiskimi, i cili ka për qëllim t’i bllokojë këto lëvizje të kapitalit të dyshimtë, është një armë efektive dhe e domosdoshme në këtë kontekst. Urdhri i konfiskimit të pronës së fituar përmes veprave penale është në funksion të interesit të përgjithshëm dhe mëton të zhbindë ata që kanë menduar të merren me veprimtari kriminale, por edhe garanton se krimi nuk ia vlen (*Denisova dhe Moiseyeva kundër Rusisë*, § 58; *Phillips kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 52; *Dassa Foundation dhe të tjerët kundër Lihtenshtajnit* (vendim), në bazë të Neneve 6 dhe 7).

327. Në rastet e procedurave të ndryshme të konfiskimit apo represionit fiskal ndaj pasurive për të cilat autoritetet publike supozojnë se janë fituar në mënyrë të paligjshme, Neni 6 i Konventës zakonisht nuk ua ndalon Shteteve bazimin në supozime (*Salabiaku kundër Francës*, § 28). Qasja e njëjtë është shfrytëzuar edhe në kontekst të ankesave lidhur me supozimin e bëra në këtë kontekst qoftë në bazë të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (*Cacucci dhe Sabatelli kundër Italisë* (vendim), § 43; *Yildirim kundër Italisë* (vendim); qoftë nën Nenin 6 (bartja e barrës së provës tek parashtruesi i kërkesës i cili është dashur ta dëshmojë se pasurinë e ka fituar në rrugë të ligjshme – *Grayson dhe Barnham kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 45; *Phillips kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 43; si dhe *Perre kundër Italisë* (vendim), lidhur me ekzaminimin e dëshmitarëve). Shfrytëzimi i supozimeve, nëse palës i është dhënë mundësia e vërtetimit të pasaktësisë së supozimeve, është në pajtim me parimin e prezumimit të pafajësisë. Në anën tjetër një shkelje e Nenit 6 § 2 ishte konstatuar në një rast kur urdhri i konfiskimit ishte dhënë për mallra përkundër faktit se pronari i tyre ishte shpallur i pafajshëm në procedurën penale për veprën penale nga e cila pretendohet se janë fituar mallrat në fjalë (*Geerings kundër Holandës*, §§ 43-51).

328. Gjykata gjithashtu e ka konsideruar legjitime që autoritetet vendore relevante të nxjerrin urdhra të konfiskimit në bazë të epërsisë së provave që sugjerojnë se të ardhurat e ligjshme të të paditurit nuk mund të kenë mjaftuar për të blerë pronën në fjalë. Kurdo që një urdhër konfiskimi lëshohet si rezultat i procedurës civile *in rem* që ka të bëjë me fitimet nga vepra të rënda penale, Gjykata nuk ka kërkuar që origjina joligjore e pronës të provohet “përtej dyshimit të bazuar” në procedura të tilla. Në vend të kësaj, të provuarit e balancit të probabilitetit apo probabiliteti i lartë i origjinës joligjore e kombinuar me

paaftësinë e pronarit që ta vërtetojë të kundërtën janë konsideruar të mjaftueshme për testin e proporcionalitetit të kryer nën prizmin e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (*Balsamo kundër San Marinos*, § 91).

329. Gjykata i ka kushtuar rëndësi të veçantë garancive të ndryshme procedurale në dispozicion gjatë procedurave të konfiskimit, siç janë ato të natyrës së konfrontimit të argumenteve (*Yildirim kundër Italisë* (vendim); *Perre kundër Italisë* (vendim)); zbulimi paraprak i rastit të prokurorisë (*Grayson dhe Barnham kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 45, për dëgjimin publik); mundësisë së palës që të sjellë prova dokumentare dhe verbale (*Butler kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim); *Perre kundër Italisë* (vendim)), mundësisë së përfaqësimit ligjor nga një avokat e angazhuar privatisht (*Butler kundër Mbretërisë së Bashkuar* (vendim); faktit që supozimin e karakterit penal të një pasurie mund ta kundërshtojë pala (*Geerings kundër Netherlands*, § 44); se gjyqtari ka autoritet diskrecional për të mos e zbatuar supozimin nëse ai/ajo konsideron se aplikimi i tij mund të shkaktojë padrejtësi (*Phillips kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 43); nëse është kryer vlerësimi individual i cilave pjesë të pronës duhet të konfiskohen në bazë të fakteve të rastit (*Rummi kundër Estonisë*, § 108; *Silickienė kundër Lituanisë*, § 68); në përgjithësi, nëse parashtuesi i kërkesës ka gëzuar mundësinë e arsyeshme për t'i paraqitur argumentet e veta para gjykatave vendore (*Veits kundër Estonisë*, §§ 72 dhe 74; *Jokela kundër Finlandës*, § 45; *Balsamo kundër San Marinos*, § 93); dhe konsideratës së duhur për procedurën e gjithmbarshme nën shqyrtim (*Denisova dhe Moiseyeva kundër Rusisë*, § 59).

G. Restitucioni i pronës

330. Pas ndryshimeve demokratike në Evropën Qendrore dhe Lindore, shumë qeveri miratuan legjislacion që garantonte restitucionin e pronave të shpronësuara pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, ose u morën me çështjen e restitucionit brenda kornizës ekzistuese ligjore.

331. Në kuptim të marrjes së pronës para ratifikimit të Konventës dhe Protokolleve të saj, organet e Konventës në mënyrë konsistente kanë konsideruar se privimi i pronësisë apo i ndonjë drejte tjetër *in rem* në parim është akt i çastit dhe nuk prodhon ndonjë situatë të vazhdueshme të “privimit të një drejte” (*Malhous kundër Republikës Çeke* (vendim) [GC]; *Preußische Treuhand GmbH & Co. KG a.A. kundër Polonisë* (vendim), § 57).

332. Për më tepër, Neni 1 i Protokollit Nr. 1 nuk mund të interpretohet si imponues i çfarëdo obligimi të përgjithshëm mbi Shtetet Kontraktuese për ta kthyer pronën e cila atyre u është bartur para ratifikimit të Konventës (*Jantner kundër Sllovakisë*, § 34).

333. Neni 1 i Protokollit Nr. 1 gjithashtu nuk imponon kurrfarë kufizimesh mbi lirinë e Shteteve Kontraktuese për të përkufizuar fushëveprimin e restitucionit të pronave dhe për të vendosur mbi kushtet në të cilat ato pajtohen se do t’ua kthejnë pronat ish pronarëve të tyre (*Maria Atanasu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, § 136). Veçanërisht është me rëndësi që të kuptohet se Shtetet kanë margjinë të gjerë të vlerësimit sa i përket përjashtimit të kategorive të caktuara të ish-pronarëve nga kjo e drejtë. Kur kategori të caktuara të pronarëve përjashtohen në këtë mënyrë, kërkesat e tyre për restitucion nuk mund të përbëjnë bazë për “pritje legjitime” që gëzon mbrojtje nga Neni 1 i Protokollit Nr. 1 (*Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke* (vendim) [GC], §§ 70-74; *Kopecký kundër Sllovakisë* [GC], § 35; *Smiljanić kundër Sllovenisë* (vendim), § 29).

334. Si rrjedhojë, shpresa e njohjes së një drejte pronësore që ka qenë e pamundur të ushtrohet nuk mund të konsiderohet “pronë” sipas kuptimit të dhënë në Nenin 1 të Protokollit Nr. 1, ngjashëm sikur edhe kërkesat e kushtëzuara të cilat skadojnë si rezultat i mosplotësimit të një kushti (*Malhous kundër Republikës Çeke* (vendim) [GC]; *Kopecký kundër Sllovakisë* [GC], § 35). Besimi se ligji që më parë ka qenë në fuqi do të ndryshojë në favor të parashtuesit të kërkesës nuk mund të konsiderohet formë e pritjes legjitime për qëllime të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Ka dallim mes shpresës së restitucionit, sado e kuptueshme që mund të jetë ajo shpresë, dhe një pritjeje legjitime e cila për nga natyra duhet të jetë më konkrete se sa vetëm shpresa dhe duhet të jetë e bazuar në një dispozitë ligjore ose akt juridik, çfarë është vendimi gjyqësor (*Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke* (vendim) [GC], § 73; *Von Maltzan dhe të tjerët kundër Gjermanisë* (vendim) [GC], § 112).

335. Në anën tjetër, pasi që një Shtet Kontraktues i cili ka ratifikuar Konventën dhe Protokollin 1 miraton legjislacion që garanton kthim të plotë apo të pjesshëm të pronës së konfiskuar nga regjimi i kaluar, ky legjislacion mund të konsiderohet se krijon një të drejtë të re të mbrojtur nga Neni 1 i Protokollit Nr. 1 për personat të cilët i plotësojnë kushtet përkatëse (*Maria Atanasiu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, § 136). E njëjta mund të aplikohet edhe në kuptim të aranzhimit të restitucionit ose kompensimit të caktuar me ligj para ratifikimit, nëse ligji i tillë ka vazhduar të mbetet në fuqi edhe pas ratifikimit të Protokollit Nr. 1 nga Shteti Kontraktues (*Von Maltzan dhe të tjerët kundër Gjermanisë* (vendim) [GC], § 74; *Kopecký kundër Sllovakisë* [GC], § 35; *Broniowski kundër Polonisë* [GC], § 125).

336. Prandaj, sa i përket përmbajtjes dhe fushëveprimit të kësaj të drejte, Gjykata ka vlerësuar se çështja duhet të vrojtohet nga perspektiva e asaj se cilat “prona” i ka pasur parashtruesi i kërkesës në datën e hyrjes në fuqi të Protokollit dhe, që është shumë e rëndësishme, në datën e paraqitjes së ankesës para institucioneve të Konventës (*Broniowski kundër Polonisë* [GC], §§ 125 dhe 132). Në këtë rast, të drejtat e parashtruesit të kërkesës mbi pronat e kompensueshme i ishin dhënë nga legjislacioni polak, i cili i jepte të drejta personave të riatdhesuar nga ana tjetër e Lumit Bug pas Luftës së Dytë Botërore, ose trashëgimtarëve të tyre dhe i cili mbeti në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të Protokollit Nr. 1 për Poloninë.

337. Sa i përket implementimit të reformave të ndërmarra, sundimi i ligjit që shërben si bazë e Konventës dhe parimi i ligjshmërisë i mishëruar në Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 kërkojnë nga Shtetet që të respektojnë dhe zbatojnë në mënyrë të parashikueshme dhe konsistente të gjitha ligjet që i kanë miratuar por edhe, si obligim i ndërlidhur me këtë detyrim, të sigurojnë kushte ligjore dhe praktike për implementimin e tyre (*Broniowski kundër Polonisë* [GC], § 184).

338. Në një sërë rastesh nga fusha e restitucionit të pronës bëhej fjalë për dështimin e autoriteteve vendore për të përmbaaruar vendimet përfundimtare gjyqësore (ose administrative). Një aktgjykim që vë mbi autoritetet obligimin për të dhënë kompensim, në tokë ose para, në pajtim me legjislacionin vendor që rregullon restitucionin e të drejtave pronësore, i ofron parashtruesit të kërkesës mjaftueshëm bazë për tu konsideruar si “pronë” brenda kuptimit të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (*Jasiūniene kundër Lituanisë*, § 44). Prandaj, konceptimi i “pritjes legjitime” është i zbatueshëm kurdo që ekziston një aktgjykim i formës së prerë në favor të parashtruesit të kërkesës (*Driza kundër Shqipërisë*, § 102).

339. Ngjashëm, në pilot aktgjykimin në rastin *Manushaqe Puto dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, §§ 110-118, Gjykata konsideroi se ka pasur shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 të Konventës për shkak të moszbatimit të një vendimi përfundimtar që i kishte akorduar parashtruesit të kërkesës kompensim në lidhje me restitucionin e pronës. Moszbatimi i vendimeve të formës së prerë, i përkrahur edhe nga mangësitë e sistemit rumun për restitucionin e pronës, përbënë shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 në rastin *Maria Atanasiu dhe të tjerët kundër Rumanisë*, si dhe në një procedurë të pilot aktgjykimit (*po aty*, §§ 215-218).

340. Rasti *Orlović dhe të tjerët kundër Bosnjë e Hercegovinës*, §§ 55, 57 dhe 61, kishte të bëjë me moszbatimin e vendimeve të autoriteteve vendore që i jepnin parashtruesve të kërkesës të drejtën e kthimit të plotë të tokës së tyre, përfshirë një pjesë të tokës në të cilën ishte ndërtuar një kishë pas dëbimit të tyre. Gjykata konstatoi shkelje dhe urdhëroi Shtetin që të ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme për të siguruar zbatim të vendimeve në favor të parashtruesve të kërkesës, përfshirë edhe largimin e kishës nga toka e tyre (*po aty*, §§ 68-71).

341. Sa i përket justifikimit që një Qeveri mund ta paraqesë për ndërhyrjen mbi të drejtat pronësore të parashtruesit të kërkesës, Gjykata a ritheksuar se mungesa e fondeve nuk mund të justifikojë dështimin në zbatimin e aktgjykimeve përfundimtare dhe obliguese ndaj Shtetit (*Driza kundër Shqipërisë*, § 108; *Prodan kundër Moldavisë*, § 61).

342. Vetëm në raste tejet të jashtëzakonshme, për shembull në kontekstin unik të bashkimit të Gjermanisë, Gjykata ka pranuar se mungesa e kompensimit nuk e ka çrregulluar baraspeshën e drejtë që duhet të arrihet mes interesit të përgjithshëm dhe mbrojtjes së të drejtave pronësore (*Jahn dhe të tjerët kundër Gjermanisë* [GC], § 117). Në përgjithësi, ajo që kërkohet në bazë të Nenit 1 të Protokollit nr. 1 është që shuma e kompensimit të dhënë për pronën e marrë nga Shteti të jetë “arsyeshëm e ndërlidhur” me vlerën e saj (*Broniowski kundër Polonisë* [GC], § 186).

343. Për më tepër, disa prej rasteve të shqyrtuara nga Gjykata kishin të bëjnë me dështimin për të respektuar efektin *res judicata* të një aktgjykimi përfundimtar që kishte rezultuar me anulimin e të drejtave pronësore të parashtresit të kërkesës pa të drejtë kompensimi. Në rrethana të tilla, Gjykata ka konsideruar se shkelja e parimit të sigurisë juridike rezulton me shkelje të kërkesës për ligjshmëri sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (*Parvanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, § 50; *Kehaya dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, § 76; *Chengelyan dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, §§ 49-50). Kushti i ligjshmërisë nënkupton jo vetëm pajtueshmëri me dispozitat relevante të ligjeve të vendit, por edhe pajtueshmëri me parimet e sundimit të ligjit. Rrjedhimisht, ai nënkupton se duhet të sigurohet mbrojtja nga veprimet arbitrare (*Parvanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, § 44).

344. Si rrjedhojë, vlerësimi i gjykatave vendore dhe dështimi i një gjykate vendore që të sqarojë përse po i ikën logjikës së aktgjykimit paraprak, privimi i “pronës” së një parashtresit të kërkesës nuk mund të jetë në pajtueshmëri me parimet e sundimit të ligjit apo i lirë nga arbitrariteti dhe rrjedhimisht nuk mund të plotësojë kushtet e ligjshmërisë sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 (*Parvanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, § 50). Ngjashëm, Gjykata theksoi se në bazë të Nenit 6, e posaçërisht në kontekstin specifik të restitucionit të pronave të nacionalizuara të Rumanisë, mungesa e koherencës legjislative në praktikën gjyqësore kundërtënës mbi interpretimin e disa aspekteve të legjislacionit të restitucionit kishte krijuar klimë të gjithmbarshme të mungesës së sigurisë juridike (*Tudor Tudor kundër Rumanisë*, § 27).

345. Aq më shumë, ekzistimi i dy dokumenteve pronësore mbi të njëjtën pronë dhe mungesa e kompensimit për pronarin që nuk është në gjendje të gëzojë “pronat” është konsideruar si shkelje e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 në shumë aktgjykime të Gjykatës (i pari prej së cilëve ishte *Străin dhe të tjerët kundër Rumanisë*, §§ 46-47).

346. Gjykata gjithashtu ka pasur mundësinë e ekzaminimit të situatës së pronarëve të cilët, pasi që kishin fituar pronësinë në mirëbesim, e kishin humbur pronën sepse të tjerë ishin njohur si pronarë ligjorë (*Toșcuț dhe të tjerët kundër Rumanisë*, § 33).

347. Specifikisht, shitja nga Shteti i pronës së një personi një personi të tretë që vepron në mirëbesim, edhe kur kjo i paraprin konfirmimit përfundimtar gjyqësor të pronësisë së personit tjetër, konsiderohet si privim i pronës. Një privim i tillë, kombinuar me mungesë të plotë të kompensimit, është në kundërshtim me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1 (*Vodă dhe Bob kundër Rumanisë*, § 23). Në rastin *Katz kundër Rumanisë*, §§ 30-36, Gjykata vlerësoi se shkelja e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 zbuloi një problem shumë të përhapur të shkaktuar nga legjislacioni i mangët për restitucionin e ndërtesave të nacionalizuara të cilat janë shitur nga Shteti tek palët e treta në mirëbesim, të cilin nuk arritën ta zgjidhnin as shumë amandementime të mëpasshme të tij. Gjykata e konsideroi këtë dështim të Shtetit për të vënë në vijë legjislacionin e vet si faktor rëndues por edhe si kërcënim për efektivitetin e Konventës në të ardhmen, sipas nenit 46 të saj. Kjo problematikë u shfaq edhe në rastet e mëpasshme si *Preda dhe të tjerët kundër Rumanisë*, §§ 146-148, dhe aktgjykimin përcjellës në *Maria Atanasiu dhe të tjerët kundër Rumanisë*.

348. Në rastin *Pincová dhe Pinc kundër Republikës Çeke* parashtresit e kërkesës ankoreshin për shkelje të së drejtave të tyre pronësore, duke dhënë se e kanë fituar pronësinë mbi shtëpinë në mirëbesim në vitin 1967, pa qenë në vetëdije se prona në fjalë më parë ishte konfiskuar dhe pa kurrfarë kontrolli mbi detajet e transaksionit apo çmimit të blerjes. Gjykata e konsideroi të domosdoshme që të sigurohet që korrigjimi i një dëmi të vjetër të mos krijojë dëme të reja joproporcionale. Në këtë drejtim, legjislacioni duhet të bëjë të mundshëm shqyrtimin e të gjitha rrethanave të posaçme të çdo rasti, në mënyrë që personat të cilët kanë fituar “pronat” a tyre në mirëbesim të mos detyrohen të bartin barrën e përgjegjësisë e cila bie mbi Shtetin që dikur i kishte konfiskuar “pronat” në fjalë (*po aty.*, § 58). Në atë rast u konstatua se ka shkelje të Konventës (sikur edhe në rastin *Zvolský dhe Zvolská kundër Republikës Çeke*, §§ 72-74). Proporcionaliteti i masave të cilat duke pasur për qëllim kompensimin e personave nga të cilët pronat janë marrë në mënyrë arbitrare nga regjimi komunist i kanë privuar individët tjerë nga pronat të cilat i kishin blerë nga Shteti u trajtua edhe në rastin *Velikovi dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, §§ 181 dhe 190.

349. Përveç kësaj, gjatësia e tepërt e procedurave të restitucionit është konsideruar si shkaktare e shkeljes së Nenit 6 në disa raste, për shembull në raste kundër Rumanisë, Sllovakisë dhe Sllovenisë (*Sirc*

kundër Sllovenisë, § 182). Në raste të tilla, Gjykata shpesh e konsideron të panevojshme që të vlerësohen ankesat e parashtruesit të kërkesës sipas Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Megjithatë, kur vonesat kanë ndodhur në procedura që janë zhvilluar pas njohjes së të drejtave pronësore të parashtruesit të kërkesës, Gjykata ka konstatuar edhe shkelje të ndarë të Nenit 1 të Protokollit Nr.1, duke theksuar situatën e pasigurisë në të cilën parashtruesit e kërkesës janë gjetur për veten dhe pronat e tyre (*Igariene dhe Petrauskiene kundër Lituanisë*, §§ 55 dhe 58; *Beinarovič dhe të tjerët kundër Lituanisë*, §§ 141 dhe 154). Në rastin *Kirilova dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, §§ 120-121, vonesat e theksuara ishin shfaqur në dorëzimin e banesave të ofruara si kompensim për shpronësimin e pronave të parashtruesve të kërkesës.

350. Për fund, në rastin *Vasilev dhe Doycheva kundër Bullgarisë*, §§ 45-53, që kishte të bëjë me restitucion të tokës bujqësore të nacionalizuar dhe trajtuar si tokë kolektive nën regjimin komunist, u konstatua shkelje e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1 dhe e Nenit 13 për shkak të mosveprimit të autoriteteve vendore në realizimin e formaliteteve të kërkuara.

H. Ndërmarrjet shtetërore

351. Gjatë vendimit nëse veprimet ose lëshimet e një kompanie mund t'i atribuohen sipas Konventës autoriteteve përkatëse apo Shtetit anëtar, Gjykata do të vlerësojë disa faktorë që listohen në rastin *Radio France dhe të tjerët kundër Francës* (vendim), § 26, në kontekst të Nenit 34 të Konventës. Gjykata duhet të shqyrtojë nëse ndërmarrjes ka gëzuar nivel të mjaftueshëm të pavarësisë institucionale dhe operacionale nga Shteti për ta liruar këtë të fundit nga përgjegjësitë që mund t'i bartë sipas Konventës për veprimet apo lëshimet e saj (*Mykhaylenko dhe të tjerët kundër Ukrainës*, § 44; *Shlepkina kundër Rusisë*, § 24; *Ljubljanska banka d.d. kundër Kroacisë* (vendim), §§ 51-55; *Liseytsseva dhe Maslov kundër Rusisë*, § 151; *Kuzhelev dhe të tjerët kundër Rusisë*, §§ 93-100 dhe 117). Teksti i nenit 34 nuk përmban asgjë që mund të sugjerojë që termi “organizatë joqeveritare” mund të interpretohet asisoj që të përjashtojë vetëm organizatat qeveritare të cilat konsiderohen pjesë e Shtetit të paditur (*Oda Ekonomike e Kroacisë kundër Serbisë* (vendim), § 38).

352. Testi i ashtuquajtur i “pavarësisë institucionale dhe operative” të cilit Gjykata i është referuar në shumë raste rrjedh direkt nga kriteret e përmbledhura në vendimin e *Radio France*. Për ta kryer atë, Gjykata shqyrton një sërë faktorësh, asnjë prej të cilëve nuk duket se janë determinues si të tillë, për të vlerësuar nëse një subjekt juridik, do të thotë një ndërmarrje shtetërore, duhet konsideruar “organizatë qeveritare” brenda kuptimit të dhënë në Nenin 34 të Konventës.

353. Kriteret kyçe për vendosjen nëse Shteti ka qenë vërtetë përgjegjës për borxhe të tilla janë: statusi juridik i ndërmarrjes (në bazë të drejtës publike apo private); natyra e veprimtarisë së saj (funksion publik apo afarizëm i rëndomtë komercial); konteksti i veprimtarisë së saj (monopol apo biznes i rregulluar); pavarësia institucionale e saj (niveli i pronësisë së Shtetit); dhe pavarësia operative e saj (në kontekst të mbikëqyrjes dhe kontrollit nga Shteti) (*Ališić dhe të tjerët kundër Bosnjë e Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë, Sllovenisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* [GC], § 114; *Fomenko dhe të tjerët* (vendim), § 172).

354. Gjatë përkufizimit të përgjegjësisë së Shtetit për borxhet e ndërmarrjeve shtetërore duket se merren parasysh edhe faktorë tjerë, siç janë roli që Shteti ka luajtur në kuptim të vështirësive në të cilat është gjetur ndërmarrja, do të thotë në situatë të falimentimit, ose nëse Shteti mund të supozohet se ka pranuar përgjegjësi për borxhet e ndërmarrjes, qoftë pjesërisht apo në tërësi (krahaso me *Liseytsseva dhe Maslov kundër Rusisë*, §§ 184-192).

355. Rrjedhimisht, kur janë prezentë elementë të tillë, natyra publike e ndërmarrjes debitoare mund të konfirmohet pa marrë parasysh klasifikimin formal të saj sipas ligjeve vendore. Andaj, kur ka bazë të mjaftueshme në rrethanat specifike të rastit të cilat e bëjnë të mundshëm konkludimin se Shteti është përgjegjës për borxhet e ndërmarrjes tek parashtruesit e kërkesës, Gjykata do të konkludojë se ankesa e parashtruesve të kërkesës është në kuptim *ratione personae* në përputhje me dispozitat e Konventës.

356. Kur Shteti është aksionar i shumicës së aksioneve në një ndërmarrje private, gjykata ka konstatuar se përkundër faktit se ndërmarrja në fjalë është entitet juridik i veçantë, ajo nuk ka gëzuar pavarësi të mjaftueshme operative nga Shteti nëse (i) asetet e saj janë kontrolluar dhe menaxhuar në masë të

theksuar nga Shteti; (ii) Shteti ka pasur dhe ka ushtruar autoritet dhe ka ndërmarrë masa për të përmirësuar situatën financiare të ndërmarrjes përmes mjeteve të ndryshme siç është anulimi qoftë edhe i përkohshëm i pagesave të këqija të cilat i janë ngarkuar nga gjykatat apo duke jetësuar investime në ndërmarrje; dhe (iii) Qeveria vetë ka pranuar një dozë të përgjegjësisë për borxhet e ndërmarrjes (*Khachatryan kundër Armenisë*, §§ 51-54).

357. Megjithatë, kur ndërmarrja e paditur me personalitet të ndarë juridik ka mundësi të mbajtjes në pronësi të aseteve të cilat janë tjera nga prona e aksionarëve dhe ka menaxhim të deleguar, Shteti, si të gjithë aksionarët tjerë, do të jetë përgjegjës vetëm për shumat e investuara në aksionet e ndërmarrjes (*Anokhin kundër Rusisë* (vendim)).

358. Kur kemi të bëjmë specifikisht me ndërmarrje nën regjim të pronësisë shoqërore, i cili ishte përdorur në masë të gjerë në RSFJ, Gjykata kishte konstatuar ato në përgjithësi nuk gëzojnë “pavarësi të mjaftueshme institucionale dhe operacionale nga Shteti” për ta liruar këtë të fundit nga përgjegjësitë që ka sipas Konventës (*R. Kaçapor dhe të tjerët kundër Serbisë*, § 98; *Mykhaylenky dhe të tjerët kundër Ukrainës*, § 44; *Zastava It Turs kundër Serbisë* (vendim), §§ 21-23).

359. Për më tepër, Gjykata ka konstatuar se parametrat e zhvilluar në lidhje me ndërmarrjet shtetërore që nuk janë institucione financiare mund të aplikohen edhe në raste që kanë të bëjnë me bankat shtetërore (*Ališić dhe të tjerët kundër Bosnjë e Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë, Sllovenisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* [GC], § 116). Në realitet, kriteret kyçe për vlerësimin nëse një Shtet duhet të konsiderohet përgjegjës për borxhe bankare janë të njëjta me ato që Gjykata i ka identifikuar në vendimin e *Radio France*.

360. Në rastin *Ališić dhe të tjerët kundër Bosnjë e Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë, Sllovenisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* [GC], § 114, Gjykata rikujtoi se Shteti mund të jetë përgjegjës për borxhet e një ndërmarrjeje shtetërore edhe nëse ajo ka pasur personalitet juridik të ndarë, në rast se e njëjta nuk ka gëzuar pavarësi të mjaftueshme institucionale dhe operacionale nga Shteti për ta liruar atë nga përgjegjësia në bazë të Konventës (*Mykhaylenky dhe të tjerët kundër Ukrainës*, §§ 43-46; *Cooperativa Agricola Slobozia-Hanesei kundër Moldavisë*, §§ 17-19; *Yershova kundër Rusisë*, §§ 54-63; *Kotov kundër Rusisë* [GC], §§ 92-107).

361. Përveç faktorëve të përmendur më sipër, Gjykata vlerësoi se edhe faktorët shtesë që janë zhvilluar në praktikën gjyqësore lidhur me ndërmarrjet jofinanciare mund të aplikohen në rastet që kanë të bëjnë me bankat shtetërore (*Ališić dhe të tjerët kundër Bosnjë e Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë, Sllovenisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* [GC], § 115). Rastet në fjalë kishin të bëjnë me përcaktimin nëse Shteti ishte direkt përgjegjës për vështirësitë financiare të ndërmarrjes, nëse kishte thithur fonde të ndërmarrjes në dëm të ndërmarrjes dhe palëve me interes të saj, nëse ka dështuar në mbajtjen e një distance me ndërmarrjen ose ka vepruar në format tjera duke keqpërdorur subjektin në fjalë (*Anokhin kundër Rusisë* (vendim); *Khachatryan kundër Armenisë*, §§ 51-55).

362. Në fund ia vlen të përmendet edhe përpjekja e Gjykatës për të qartësuar statusin ligjor të likuiduesve në rast falimentimi. Për të vlerësuar nëse një likuidues mund të konsiderohet se ka vepruar si agjent i Shtetit, Gjykata duhet të ekzaminojë kriteret të ndryshme siç janë: i) validimi i emërimit të likuiduesit (nëse ky validim ngërthen çfarëdo përgjegjësie të Shtetit për mënyrën se si likuiduesi i kryen detyrat e veta); ii) mbikëqyrja dhe llogaridhënia (nëse Shteti ka përgjegjësi për veprimet e likuiduesit, me ç'rast ai do të jetë përgjegjës para kreditorëve); iii) objektivat (natyra e detyrave të likuiduesit dhe interesat të cilëve u shërben, do të thotë, sipas Gjykatës vet fakti që shërbimet janë të dobishme në kuptim shoqëror nuk bëjnë që likuiduesi të konsiderohet zyrtar publik që vepron në interes publik); iv) autorizimet (nëse janë të kufizuara nën kontrollin operativ dhe menaxhues të pronës së ndërmarrjes në falimentim dhe nëse ka delegim formal të autorizimeve nga ndonjë autoritet qeveritar); dhe v) funksionet (nëse likuiduesit janë të përfshirë në procedurat përmbartimore dhe kanë autorizime detyruese) (në veçanti *Kotov kundër Rusisë* [GC], §§ 92-98 dhe 99-106), që kishte të bëjë me paaftësinë e parashtruesit të kërkesës që të rikuperojë dëmet nga likuiduesi i emëruar për të menaxhuar pronën e një banke të shpallur në falimentim nga gjykata).

363. Në këtë rast likuiduesi në kohën relevante kishte gëzuar pavarësi të konsiderueshme operative dhe institucionale dhe autoritete shtetërore nuk kishin pushtet dhe autorizim për t'i dhënë atij udhëzime e rrjedhimisht nuk mund të ndërhyjnë me procesin e likuidimit si të tillë, prandaj mund të konstatohej se likuiduesi nuk ka vepruar si agjent i Shtetit (*Kotov kundër Rusisë* [GC], § 107). Si pasojë, u vlerësua se Shteti i paditur nuk mund të konsiderohej përgjegjës për veprimet e gabueshme.

I. Masat kursyese

364. Gjykata ka shqyrtuar një sërë rastesh ku parashtruesit e kërkesave ishin ankuar lidhur me masat e ndryshme të kursimit që ishin ndërmarrë nga Palët Kontraktuese si reagim ndaj krizave financiare. Ato përfshinin zbritjen e shumave të përfituara nga sigurimi shoqëror dhe pagat, si dhe masa tatimore të cilat shpesh u konstatua se janë në pajtim me Nenin 1 të Protokollit Nr. 1. Gjykata mori parasysh se masat ishin marrë me qëllim të zbutjes së pasojave të krizës ekonomike, se autoritetet kishin pasur në mendje interesin publik, se masa e caktuar ka qenë pjesë e një programi shumë më të gjerë, se nuk kanë qenë për nga natyra joproporcionale dhe nuk kanë përbërë kërcënim për jetesën e parashtruesit të kërkesës dhe kanë qenë të përkohshme për nga natyra (*Mockienė kundër Lituanisë* (vendim), § 48; *Da Silva Carvalho Rico kundër Portugalisë* (vendim), § 46; *Savickas dhe të tjerët kundër Lituanisë* (vendim), §§ 92-94; *Da Conceição Mateus dhe Santos Januário kundër Portugalisë* (vendim), § 29; *Koufaki dhe Adedy kundër Greqisë* (vendim), §§ 37-49). Gjykata ua ka njohur Shteteve të drejtën e gjerë diskrecionale në miratimin e ligjeve në kontekst të ndryshimit të regjimit politik apo ekonomik (*Valkov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, § 96).

365. Disa prej masave të pranura nga Gjykata kanë rezultuar me zbritje të përkohshme të të hyrave për disa segmente të popullatës. Në vitin 2010, Rumania zbriti pagat në sektorin publik për 25% për gjashtë muaj me qëllim të balancimit të buxhetit të Shtetit (*Mihăieş dhe Senteş kundër Rumanisë* (vendim), § 8). Në vitin 2012, Portugalia i zbriti shtesat e Krishtlindjeve për disa kategori të pensionistëve të sektorit publik të cilët kishin pensione mujore më të larta se 600 euro dhe i pezulloi në tërësi për pensionistët që kishin pensione mujore më të larta se 1,100 euro, që në rastin e dy parashtruesve të kërkesës përbënin zbritje të pagesave të pensioneve që arrinte masën prej 11% (*Da Conceição Mateus dhe Santos Januário kundër Portugalisë* (vendim), § 6).

366. Masa tjera janë zhvilluar në formë të rritjes së përkohshme të tatimit në të ardhura personale. Në vitin 2013, Portugalia vendosi mbi pensionet e sektorit publik një barrë mujore të kontributit solidar prej 3.5% në pensionet deri në 1,800 euro dhe 16% për pensionet mbi këtë shumë, me çka parashtruesit të kërkesës para Gjykatës iu kishin zbritur të ardhurat pensionale për 4.6% (*Da Silva Carvalho Rico kundër Portugalisë* (vendim), § 8).

367. Masa tjera kanë rezultuar me ulje të përhershme ose gjysmë të përhershme të të ardhurave për disa segmente të popullatës. Në vitin 2010, Rumania ndërpreu disa regjime të pensioneve speciale që u ndaheshin kategorive të caktuara të punonjësve të pensionuara të sektorit publik, që rezultoi me zbritje të pensioneve të pesë parashtruesve të kërkesës në masë prej rreth 70% (shih rastin *Frimu dhe të tjerët kundër Rumanisë* (vendim), § 5).

368. Gjithashtu në vitin 2010, Greqia i zbriti pensionet e sektorit publik dhe pagat me efekt retroaktiv nga 12% deri në 30%, më pas atë vit i zbriti edhe për 8%, siç bëri dhe me shtesat për pushim dhe Krishtlindje për punonjësit e sektorit publik me të ardhura më të larta (*Koufaki and Adedy kundër Greqisë* (vendim), §§ 20 dhe 46).

369. Në një rast që kishte të bëjë me zbritjen e përkohshme të pagave të gjyqtarëve, Gjykata mori parasysh faktin se masat e ankmuara ishin pjesë e një programi të gjerë të masave kursyese që preknin pagat e tërë sektorit publik dhe se zbritja në fjalë kishte të bëjë me një rritje të akorduar dy vite më parë dhe se personat në fjalë ishin kompensuar përfundimisht për këtë zbritje (*Savickas dhe të tjerët kundër Lituanisë* (vendim), § 93).

370. Megjithatë, në një rast që kishte të bëjë me tatimim të pagesës përfundimtare për shkëputje të marrëdhënies së punës me normë tatimore prej 52%, Gjykata kishte konstatuar se mjetet e shfrytëzuara

nuk ishin në proporcion me qëllimin legjitim të mëtuar. Kjo ndodhi përkundër diskrecionit të gjerë që Shteti gëzon në çështje tatimore e edhe supozimit që masa i ka shërbyer interesave të buxhetit të Shtetit në një fazë të vështirësive ekonomike. Gjykata mori parasysh faktin se norma tatimore ishte konsiderueshëm më e lartë se sa norma e aplikuar për të gjitha llojet tjera të të ardhurave; se parashtruesja e kërkesës kishte vuajtur humbje substanciale të të ardhurave si rezultat i largimit të saj nga puna; dhe se tatimi ishte zbritur nga pagesa për shkëputje të marrëdhënies së punës drejtpërsëdrejti nga punëdhënësi pa kurrfarë vlerësimi individual të situatës së saj dhe ishte vendosur mbi të ardhura që kishin të bëjnë me veprimtarinë e realizuar në vitin para vitit tatimor në fjalë (*N.K.M. kundër Hungarisë*, §§ 66-74).

371. Në një tjetër rast që kishte të bëjë me vendosje të tatimit mbi të ardhura të larta, Gjykata konstatoi se në përgjithësi vendimet e marra nga Shtetet nuk kanë tejkaluar kufirin e diskrecionit që u lejohet autoriteteve në çështje tatimore dhe nuk e ka çrregulluar baraspeshën mes interesit të përgjithshëm dhe mbrojtjes së të drejtave individuale të kompanive. Gjykata theksoi se hapat e ndërmarrë nga Shteti kanë qenë po ashtu pjesë e qëllimit të vendit për t'i përmbushur obligimet e veta sipas rregullave buxhetore të Bashkimit Evropian (*P. Plaisier B.V. kundër Holandës* (vendim), §§ 77-97).

372. Gjithashtu, në një rast që kishte të bëjë me pjesëmarrjen e detyruar të parashtruesve të kërkesës në një përpjekje për të zvogëluar borxhin publik duke i këmbyer bonot e tyre për instrumente tjera të borxhit me vlerë më të ulët, Gjykata nuk gjeti shkelje të Nenit 1 të Protokollit Nr. 1. Ajo theksoi se ndërhyrja ka pasur për qëllim interesin publik të ruajtjes së stabilitetit ekonomik dhe ristrukturimit të borxhit kombëtar në kohë të një krize ekonomike serioze. Gjykata konstatoi se parashtruesit e kërkesës nuk kanë pësuar kurrfarë barre të posaçme apo të tepërt në kuptim të marginës së gjerë të vlerësimit që Shtetet kanë në këtë sferë dhe në kuptim të zbritjes së vlerës komerciale të bonove, të cilat veç ishin prekur nga dëmtimi i likuiditetit të Shtetit, i cili sidoqoftë me gjasë nuk do të mund t'i kryente obligimet e veta në bazë të klauzolave të bonove të vjetra. Gjykata gjithashtu mori parasysh faktin se klauzolat e veprimeve kolektive dhe ristrukturimi i borxhit publik përbënin një masë adekuate dhe të domosdoshme për zbritjen e borxhit publik dhe kursimin e Shtetit nga falimentimi, dhe se investimi në bono thesari nuk konsiderohet investim pa rrezik dhe se parashtruesit e kërkesës është dashur të jenë të vetëdijshëm për lëvizjet në tregun financiar dhe rrezikun e rënies së mundshme të vlerës së bonove të tyre (*Mamatat dhe të tjerët kundër Greqisë*, §§ 22 dhe 4851).

J. E drejta e Bashkimit Evropian

373. Rasti *Bosphorus Hava Yolları Turizm ve Ticaret Anonim Şirketi kundër Irlandës* [GC], §§ 155-156, kishte të bëjë me një fluturake të lëshuar me qira nga kompania parashtruese e kërkesës një kompanie jugosllave, e cila u sekuestrua në vitin 1993 nga autoritetet irlandeze në bazë të Rregullores së Komunitetit me të cilën miratoheshin sanksionet e OKB-së ndaj Republikës Federale të Jugosllavisë. Gjykata konstatoi se mbrojtja e të drejtave themelore nga e drejta e KE-së mund të konsiderohet të jetë, dhe të ketë qenë në momentin relevant, “ekuivalente” me atë që garantohet nga sistemi i Konventës (i ashtuquajtur “prezumim i parimit të mbrojtjes ekuivalente i Bosforit⁸”). Rrjedhimisht, u shfaq prezumimi që Irlanda nuk i kishte ikur kërkesave të Konventës gjatë zbatimit të obligimeve juridike ndërkombëtare që rridhnin nga anëtarësi a e saj në KE. Gjykata mori parasysh natyrën e ndërhyrjes, interesin e përgjithshëm që mëtonin sanksionet dhe aktgjykimin e GJED të cilit duhej t'i përmbahej Gjykata Supreme, gjë që edhe ndodhi. Ajo konstatoi qarët se nuk ka pasur mosfunksionim të mekanizmave të kontrollit gjatë respektimit të të drejtave të Konventës. Prandaj, nuk mund të thuhet se mbrojtja e të drejtave të Konventës të Bosphorus Airways ishte e mangët dhe nuk u konstatua shkelje e Nenit 1 të Protokollit Nr. 1.

374. Sa u përket kërkesave të kompensimit, në rastin *Avotiņš kundër Letonisë* [GC], §§ 104 dhe 109-111, lidhur me përmbartimin në Letoni të një aktgjykimi të nxjerrë në vitin 2004 në Qipro për shpagimin e borxhit në bazë të Nenit 6 të Konventës e për të cilin rast nuk u konstatua shkelje, Gjykata vlerësoi se

⁸. See the *Guide on Article 1 (Obligation to respect human rights)*.

mekanizmi i të drejtës të Bashkimit Evropian për respektimin e të drejtave themelore, në rast të shfrytëzimit dhe potencialit të plotë të tij, gjithashtu garanton mbrojtje të krahasueshme me atë që e ofron Konventa (që është kushti i dytë i prezumimit të Bosforit, ndërsa i pari është mungesa e çfarëdo margjine të manovrimit të autoriteteve vendore, siç theksohet në rastin *Michaud kundër Francës*, §§ 114-116).

375. Për më tepër, në rastin *Heracles S.A. General Cement Company kundër Greqisë* ((vendim) §§ 63-70), Gjykata konstatoi se aktgjykimi e gjykatës vendore, krahas vendimit të Komisionit Evropian, me të cilin urdhërohet pagesa e ndihmave shtetërore të përfituara jashtëligjshëm, së bashku me interesin e grumbulluar për 14 vite, nuk ishte joproporcional dhe i kishte shpallur të papranueshme kërkesat e paraqitura nën Nenin 1 të Protokollit Nr. 1.

